



ISBN 978-9928-210-23-4

ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve
nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave
për përballimin e emergjencave civile

NËNTOR
2022

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2022

STUDIM

Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile (Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave)

Drejtues i parë prof. asc. dr. dr. Xhavit SHALA

*Botim i miratuar nga Bordi i Qendrës Kërkimore Shkencore,
me vendim nr. 13/1, datë 13.9.2022*

© - **Akademia e Sigurisë, Tiranë.**

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Akademia e Sigurisë

Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile (Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave) : studim / Akademia e Sigurisë.

- Tiranë : Akademia e Sigurisë, 2022

155 f. ; 16.5x24 cm.

ISBN 978-9928-210-23-4

1.Fatkeqësi natyrore 2.Menaxhimi 3.Mbrojtja civile 4.Siguria

5.Studime 6.Shqipëri

504.4(496.5) (048.83)

NR **26**
NËNTOR
2022

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Prof. Asc. Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Zaho GOLEMI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Dr. Adnan XHOLI

Redaktor shkencor
Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike
MP Andi OSMANI

Realizimi teknik
Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në
komunitet në
kontekstin
e kërcënimeve
nga fenomenet
ekstreme
natyrore dhe
nevojave për
përballimin e
emergjencave
civile »



**AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE**

S T U D I M

**“SIGURIA NË KOMUNITET NË KONTEKSTIN E KËRCËNIMEVE NGA FENOMENET EKSTREME
NATYRORE DHE NEVOJAVE PËR PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE”
(GJETJET DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E POLITIKAVE)**

Studim i zhvilluar si pjesë e projektit të miratuar dhe të financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Informacionit (AKKSHI), në kuadër të thirrjes për aplikim për “Projektet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit (PKKZH) për periudhën 2021-2023”. Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi e autorit; opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AKKSHI-t.



Realizimi i këtij studimi është bërë në kuadër të projektit me të njëjtin emër, i cili u financua nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Botim i financuar nga UNDP Albania



Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	9
2. Objektivat e projektit kërkimor.....	13
3. Metodologjia.....	14
4. Kufizimet.....	15
5. Konceptet bazë teorike për sigurinë, komunitetin, fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile..	15
5.1. Koncepti mbi sigurinë. Kategoritë e saj. Siguria Kombëtare. Siguria njerëzore Rendi dhe Siguria publike.....	15
5.2. Kuptimi i termit “komunitet”.....	20
5.3. Siguria në komunitet ose siguria e komunitetit.....	21
5.4. Fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore si rrezik e kërcënim për sigurinë e komunitetit në Shqipëri.....	23
5.5. Menaxhimi i suksesshëm i emergjencave civile, një qasje proaktive në trajtimin e fatkeqësive natyrore.....	28
6. Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet.....	30
7. Perceptimet e qytetarëve për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive duke u bazuar në komunitet...35	
7.1. Të dhëna të përgjithshme për anketimin.....	35
7.2. Pyetjet dhe përgjigjet e të anketuarve në paraqitje tabelore e grafike si dhe gjetjet e analizuara..39	
7.2.1. Analizë krahasuese lidhur me perceptimin e nivelit të rrezikut për sigurinë nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë, në raport dhe me rreziqet e tjera.....	48
7.2.2. Analizë krahasuese lidhur me perceptimin se sa e ku duhet investuar për parandalimin/ menaxhimin të fatkeqësive natyrore/emergjencat civile.....	58
7.2.3. Analiza e gjetjeve lidhur me shkallën e përgatitjeve për menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.....	81
7.2.4. Analiza krahasuese e treguesve lidhur me perceptimin e të anketuarve për shkaqet, pasojat	

dhe masat për reduktimin e fatkeqësive natyrore/ emergjencave civile.....	92
7.2.5. Analiza krahasuese e treguesve lidhur me matjet e nivelit të njohurive për menaxhimin e rrezikut të katastrofave.....	99
7.2.6. Analiza krahasuese e treguesve lidhur me matjen e nivelin të shqetësimit në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore..	107
8. Gjetjet dhe përfundimet kryesore.....	128
9. Rekomandimet kryesore dhe politikat.....	133
10. Gjetjet dhe përfundimet e detajuara.....	134
11. Proгноza për të ardhmen.....	151
12. Bibliografi.....	152



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në
komunitet në
kontekstin
e kërcënimeve
nga fenomenet
ekstreme
natyrore dhe
nevojave për
përballimin e
emergjencave
civile »

1. Përmbledhje ekzekutive

Në Shqipëri, rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë së komunitetit nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore janë në nivele të larta. Në dekadën e fundit, çështja e sigurisë së komunitetit përballë fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile është shndërruar në një nga shtyllat e rëndësishme dhe jetike të sigurisë publike.

Shqipëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta natyrore, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek ato me origjinë hidrometeorologjike dhe gjeologjike, si tërmetet, përmbytjet, thatësitat, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e tokës. Në rang botëror Shqipëria renditet ndër vendet me pasoja të larta ekonomike nga fatkeqësitë. Rreth 86% e territorit ku gjenerohet afërsisht 88.5% e PBB-së, është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve.

Fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore përbëjnë rrezik dhe kërcënim jo vetëm për sigurinë e komunitetit, por dhe më gjerë, për sigurinë kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Fatkeqësitë natyrore paraqesin disa nga problemet më të vështira të sigurisë, sepse ato janë të paktën po aq destabilizuese sa konfliktet politike, ekonomike, etnike ose fetare të krijuara nga njeriu dhe vrasin më shumë njerëz në mesatare sesa konfliktet. Fatkeqësi të tilla shpesh krijojnë një numër të madh refugjatësh ose zhvendosje të popullsisë që kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme, me qëllim parandalimin e katastrofave të tjera edhe më të mëdha të tilla si uria, epidemitë ose kolapsi i plotë.

Koncepti i sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit është mjaft i ri për komunitetet akademike dhe jo vetëm. Komunitetet kanë të drejtën të kontribuojnë dhe të vendosin mbi sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Përgjegjësia për zhvillimin e sigurisë në komunitet i takon vetë komuniteteve. Të gjithë aktorët që operojnë në territor, jo vetëm policia,

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

duhet të jenë të interesuar për arritjen e sigurisë në komunitet.

Konceptet kryesore që ndërthuren me sigurinë në komunitet dhe mirëqenien janë rreziku, cenueshmëria dhe dëmi (dëmtimi). Në këndvështrimin e këtij punimi janë pikërisht rreziku, cenueshmëria (kërcënimi) dhe dëmi (dëmtimi) nga fatkeqësitë natyrore që ndikojnë në sigurinë në komunitet dhe mirëqenien e tyre. Nevojat për sigurinë dhe mirëqenien e një komuniteti plotësohen kur kushtet e rrezikut zbuten, cenueshmëria zvogëlohet dhe shfaqja e dëmit është zero.

Fenomenet ekstreme të natyrës, në këndvështrim të këtij punimi, janë fenomene natyrore që sjellin pasoja të rënda për njeriun, janë ato elemente në mjedisin fizik, të dëmshëm për njeriun dhe të shkaktuara nga forca të jashtëzakonshme, janë ato fenomene që kthehen në rreziqe natyrore, duke rrezikuar sigurinë e komunitetit. Këto rreziqe janë ato procese apo fenomene ekstreme natyrore që mund të shkaktojë humbje të jetëve, plagosje apo ndikime të tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, probleme sociale dhe ekonomike ose dëmtim mjedisor si dhe të tjera fatkeqësi apo katastrofa natyrore.

Vetë fatkeqësitë në këndvështrimin e këtij punimi dhe të legjislacionit shqiptar, janë ato kërcënime për sigurinë e komunitetit, pasojë e ndërprerjeve serioze të çfarëdolloj shkalle të funksionimit të një komuniteti ose shoqërie për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit përballues, duke çuar në humbje të mundshme njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore.

Qëllimi i këtij punimi është studimi, analizimi, vlerësimi dhe identifikimi i problematikave që lidhen me sigurinë e komunitetit në kuadër të fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile si dhe domosdoshmërinë e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet, me synimin për të përmirësuar në mënyrë progresive sigurinë publike dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj fatkeqësive, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave në këtë fushë.

Me qëllim forcimin e sigurisë në komunitet, ligjvënësit kanë pajisur strukturat e pushtetit vendor me kompetenca të rëndësishme në fushën e sigurisë publike, konkretisht me mbrojtjen civile dhe menaxhimin emergjencave, duke synuar një qasje proaktive dhe joreaktive në trajtimin e fatkeqësive natyrore. Por, sistemi i mbrojtjes civile ka qenë i pamjaftueshëm deri tani për të menaxhuar numrin në rritje të emergjencave dhe rehabilitimin e shpejtë të gjendjes së shkaktuar prej tyre.

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore është qëllimi ndërsa, strategjia kryesore për arritjen e këtij qëllimi, është që rritja e kapaciteteve dhe burimeve të grupeve më të cenueshme të komunitetit, për të reduktuar cenueshmërinë e tyre dhe për të shmangur ndodhjen e fatkeqësive në të ardhmen.

Përfshirja e komunitetit është thelbësore në menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive pasi askush nuk mund të kuptojë mundësitë dhe kufizimet më mirë se vetë komunitetet lokale, të cilët duhet të përfshihen në identifikimin dhe zgjidhjen e çështjet e cenueshmërisë nga fatkeqësitë. Askush nuk është më i interesuar të kuptojë çështjet lokale sesa komuniteti, mbijetesa dhe mirëqenia e të cilit është në rrezik.

Për këtë është e domosdoshme fillimi i zbatimit të praktikave më të mira të menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive duke u bazuar në komunitet, si një model në të cilin komunitetet në rrezik janë të angazhuar në mënyrë aktive në identifikimin, analizën, trajtimin, monitorimin dhe vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë me qëllim që të reduktojnë dobësitë dhe të rrisin kapacitetet e tyre. Kjo do të thotë që njerëzit të jenë në qendër të vendimmarrjes dhe zbatimit të aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut nga

fatkeqësitë.

Por, çfarë mendojnë qytetarët për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive duke u bazuar në komunitet dhe shkallën e përgatitjes së tyre për t'u përballur me këto fatkeqësi. Në funksion të këtij procesi, fillimisht është e nevojshme matja dhe vlerësimi i perceptimit të tyre për nivelin e rrezikut e të kërcënimit nga fenomenet ekstreme të natyrës, për nivelin e njohurive që ata kanë për këto fenomene, për përgjegjësitë tyre në situata të tilla, nevojën për edukimin dhe ndërgjegjësimin e tyre si dhe nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin që ata kanë për strukturat që menaxhojnë rrezikun nga fatkeqësitë natyrore. Këto matje të perceptimit të komunitetit janë siguruar nëpërmjet një anketimi të gjerë, të zhvilluar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë në 12 qarqe të vendit, gjatë muajit janar-mars 2022, realizuar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë¹. Gjetjet dhe përfundimet rreth këtyre perceptimeve do të prezantohen gjatë këtij punimi.

Në këtë punim janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore si ato cilësore, sasiorë, etj.

Në përfundim të punimit, nga analiza e të gjitha gjetjeve dhe përfundimeve, në zbatim dhe të objektivave të përcaktuara në fillim, provohet si e vërtetë hipoteza e ngritur se fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore perceptohen ndër rreziqet dhe kërcënimet kryesore për sigurinë në komunitet. Ky perceptim është në shpërpjesëtim me nivelin e njohurive që ata kanë për sigurinë e tyre në këtë fushë si dhe për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive.

Në përmbyllje jepen dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave, për të mundësuar rritjen e mëtejshme të parametrave të sigurisë publike në këtë fushë, të qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj fatkeqësive dhe domosdoshmërinë e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet.

Fjalëkyçe:

siguria në komunitet, menaxhim i rrezikut të fatkeqësive, fenomene ekstreme të natyrës, fatkeqësi natyrore, emergjencë civile, pandemi, tërmet, siguri kombëtare.

¹ Pyetësori për anketimin është hartuar grupi kërkuesve shkencor të Qendrës së Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë, të përbërë nga prof. asc. dr. Xhavit Shala, prof. asc. dr. Zaho Golemi, dr. Albert Hitoallaj, dr. (në proces) Anisa Hysesani, dr. (në proces) Gjon Vorfi dhe M.P. Andi Osmani. Të dhënat statistikore janë përpunuar nga dr. (në proces) Anisa Hysesani.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në
komunitet në
kontekstin
e kërcënimeve
nga fenomenet
ekstreme
natyrore dhe
nevojave për
përballimin e
emergjencave
civile »

2. Objektivat e studimit

Ky studim është hartuar në përfundim të projektit kërkimor me të njëjtën temë, i cili synonte këto objektiva:

- Studimi, analizimi, vlerësimi dhe identifikimi i problematikave që lidhen me sigurinë e komunitetit në kuadër të fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile si dhe domosdoshmërinë e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet, me synimin për të përmirësuar në mënyrë progresive sigurinë publike dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj fatkeqësive, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave në këtë fushë.

- Realizimin e kërkimeve dhe analizave të thelluara, si dhe hartimi i prognozave bazuar në këto kërkime dhe në anketimet e perceptimeve të vetë komunitetit për këtë çështje, si dhe hartimi i rekomandimeve për strukturat përkatëse, parë nga këndvështrimi i kërcënimeve të sigurisë së komunitetit nga këto fenomene ekstreme të natyrës.

- Realizimi i një anketimi me shtresa dhe kategori të ndryshme të popullsisë lidhur me perceptimet e tyre për kërcënimet e sigurisë nga fenomenet ekstreme të natyrës, me synim për hartimin e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e edukimit të komunitetit për përballimin e këtyre emergjencave. Gjithashtu, kjo do t'i shërbejë evidentimit të nevojave të komunitetit për masat përgatitore në kuadër të sigurisë publike, që duhen ndërmarrë nga institucionet përgjegjëse shtetërore.

- Ndërgjegjësimin publik për mirinformim dhe njohuri në lidhje me rreziqet nga fatkeqësitë natyrore, faktorët që mund të çojnë në fatkeqësi, por edhe për veprimet e mundshme, që mund të ndërmerren në mënyrë individuale e kolektive për të zvogëluar ekspozimin ndaj kërcënimit dhe rreziqeve nga fenomenet ekstreme të natyrës.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- Përforcimin dhe theksimin se emergjenca civile është një element i prekshëm, i vërtetë, i qenësishëm, i përvitshëm, i ndjeshëm i sigurisë publike e kombëtare, i çdo shteti për rrjedhojë edhe Shqipërisë, të ekspozuar ndaj fenomeneve kërcënuese të natyrës në të gjitha stinët.

- Nxitja e bashkëpunimit të segmenteve përgjegjëse të shtetit për sigurinë komunitare në rast emergjencash, si dhe bindja në bashkëpunimin e aktorëve ndërshtetërorë në vend, por edhe rajonalë e veçanërisht ata fqinjësor.

- Të shqyrtojë kuadrin ligjor procedural kombëtar dhe ndërkombëtar në praktikë dhe në teori, për sa i përket çështjeve të sigurisë në rast të ndodhisë së fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile dhe të propozojë ndryshimet/përmirësimet e mundshme.

- Nxitja e trajnimeve për profesionistët e fushës së sigurisë në raport me emergjencat civile, të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e përgatitjes së tyre teorike dhe praktike.

- Në studimin përfundimtar në përfundim të projektit do të përfshihen dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave publike, të cilat do të ndihmojnë vendimmarrësit dhe institucionet për një organizim, strukturim dhe planifikim më të mirë të punës në këtë fushë.

3. Metodologjia

Në këtë studim, në mënyrë që të sigurohej informacion sa më i plotë dhe i saktë, është përdorur metoda e gërshetuar e hulumtimit si dhe janë përdorur instrumentet kryesore kërkimore shkencore, cilësore e sasiore.

Në bazë të metodologjisë së zgjedhur, është përdorur metoda cilësore, duke ndjekur hulumtimin e literaturës në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj; grumbullim literature, strukturim të informacionit dhe analizë teksti; sintezë e literaturës me fokus ligjor, analitik, historik e psikosocial dhe jo vetëm; analizë rasti me fokus në sigurinë e komunitetit në kontekstin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, analizim praktikash dhe politikash kombëtare dhe ndërkombëtare për sa i përket sigurisë në komunitet, fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile.

Në bazë të metodologjisë së zgjedhur, është përdorur, gjithashtu, metoda sasiore, duke përdorur si instrument kërkimor pyetësorin e standardizuar. Është realizuar hartimi, shpërndarja, grumbullimi, analiza dhe interpretimi i të dhënave të siguruar prej tij. Është përdorur metoda induktive, ku të dhënat nga pyetësorët janë grumbulluar, analizuar e përmbledhur për të dhënë konkluzione rreth fatkeqësive natyrore dhe kërcënimeve prej tyre. Është realizuar analizë variabëlësh, analizë faktoriale dhe analizë me blloqe në fund, për të nxjerrë prototipa apo profile përmbledhëse rreth situatës së sigurisë së komunitetit të lidhur me fenomenet ekstreme të natyrës, emergjencave civile etj. Kjo pjesë e studimit u fokusua në një pyetësor me shënjestër kundrejt popullatës së marrë si kampion në 12 qarqet e Shqipërisë. Anketimi i përgatitur u shpërnda dhe u plotësua nëpërmjet platformës online «Google Form».

Në mënyrë që të sigurohej mbledhja e të dhënave sasiore si dhe përfaqësimi, është ndjekur metoda kërkimore deskriptive ndërseksionale, e cila ofron informacione në një moment të caktuar kohor rreth ekzistencës dhe ndikimit të politikave në raport me qëndrimet mbi situatën e sigurisë së komunitetit të lidhur me fenomenet ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile në Shqipëri. Kjo metodë hulumtuese është zgjedhur pasi ofron disa avantazhe në krahasim me metoda të tjera, për shembull:

- është e shpejtë për t'u zhvilluar;
- të gjithë variabëlët mblidhen në të njëjtën kohë;
- mund të masë disa rezultate njëherësh;
- mbizotërimi për të gjithë faktorët është i matshëm;
- është metodë e mirë për mbledhjen e të dhënave deskriptive;
- mund të përdoret për hulumtime të mëtejshme.

Të gjitha të dhënat e përfthuara nga përgjigjet e të anketuarve janë përpunuar dhe analizuar nëpërmjet softuerëve analitike të të dhënave, si SPSS-ja dhe MAXQDA-ja, nëpërmjet të cilave është realizuar përpunimi cilësor dhe sasior i të dhënave.

Nga pikëpamja teknike anketimi ka një shkallë të lartë standardizimi. Kjo do të thotë që pyetjet janë të standardizuara, të strukturuar, të renditura, të mbyllura dhe prodhojnë informacion të krahasueshëm, qoftë në analizën e anketimit, qoftë në analizën e kryqëzuar të informacioneve të tij. Këto ndikuan ndjeshëm në gjetjet interesante të këtij punimi si dhe në hartimin e rekomandimeve rreth objektivit të studimit

Të dhënat e mbledhura me anën e metodave të mësipërme janë përdorur gjerësisht në arsyetimet lidhur me interpretimin e rezultateve të anketimit.

4. Kufizimet

Ndonëse studimi ka mbushur një boshllëk të madh në trajtimin e sigurisë në komunitetin në kontekstin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, nuk pretendohet që ky studim të jetë i vetëm dhe plotësisht shterues në këtë fushë. Pavarësisht nga realizimi i suksesshëm i tij, u ndeshëm me një sërë sfidash dhe kufizimesh, të lidhura kryesisht me vështirësitë në gjetjen e materialeve për periudha të caktuara, vështirësitë gjatë anketimit, etj. Gjithsesi, studimi, si produkt i projektit kërkimor, është i nivelit makrostrategjik me gjetje, prognoza për të ardhmen dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën për mënyrën e trajtimit të sigurisë në komunitetin në kontekstin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Më pas, në bazë të këtij studimi, mund të realizohen studime të tjera të nivelit mikro, duke u përqendruar në sigurinë e komunitetit sipas tipologjive të fatkeqësive natyrore.

5. Konceptet bazë teorike për sigurinë, komunitetin, fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile.

5.1. Koncepti mbi sigurinë, kategoritë e saj, siguria kombëtare, siguria njerëzore, rendi dhe siguria publike

5.1.1. Koncepti mbi sigurinë

Ndonëse ka një ndjeshmëri të madhe të publikut ndaj sigurisë dhe ndonëse është një ndër termat më të përdorur në gjuhën e përditshme, akoma nuk ekziston një ujd mbi kuptimin e këtij koncepti. Por, nëse nuk mund ta emërtojmë sigurinë, si mund të shpresojmë ndonjëherë ta arrijmë atë². Për sigurinë ka shumë përkufizime. Studimet bashkëkohore të sigurisë kanë avancuar konceptimin e saj, duke zbuluar dhe përcaktuar shumë nga dimensionet që ajo ka, të panjohura më parë. Më shpesh siguria përcaktohet si një gjendje në të cilën nuk ekzistojnë rreziqet. I përafërt me këtë është edhe koncepti

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

² Ken Booth: Theory of World Security, Cambridge Studies in International Relations, p.99

në gjuhën shqipe i sigurisë. Ajo nënkupton “të qenit jashtë çdo rreziku dhe të papriture, gjendje pa ndonjë rrezik a të keqe të papritur³”. Por, përpjekjet për siguri shpesh shihen dhe si “përpjekje për mbijetesë”. Fjala “siguri” është një term që ka dimensione të ndryshme në psikologji, ekonomi, shëndetësi, në ruajtje të publikut, në mbrojtje dhe në çështje ushtarake, në qasjen e informacionit, në financa, etj.

Siguria mund të përcaktohet edhe si liri që pasqyron vlerat, si një “mungesë e kërcënimit ndaj vlerave të fituara”. Siguria paraqet lirinë e zgjedhjes së vlerave të cilat do të mbrohen në shoqëri. Siguria mund të matet. Siguria, sipas çdo kuptimi objektiv, mat mungesën e kërcënimeve ndaj vlerave të përftuara; kurse, sipas një kuptimi subjektiv, ajo mat mungesën e frikës nga sulmi ndaj këtyre vlerave⁴. Prandaj dhe siguria perceptohet si mbrojtje e vlerave përgjithësisht të pranuar në shoqëri të përkufizuara me të drejtën pozitive ose me normat morale.” Një komb konsiderohet i sigurt kur nuk ekziston asnjë rrezik që ta detyrojë atë të sakrifikojë vlerat e tij themelore nëse do donte të shmange luftën, dhe është i aftë, – nëse sfidohet, – në një luftë të tillë, t’i mbajë ato nëpërmjet fitores⁵.

Siguria është një koncept në dinamikë. Pavarësisht mungesës së konsensusit për konceptin mbi sigurinë, autorët që janë marrë me studimet në këtë fushë mund t’i ndajmë në dy grupime kryesore. Në grupimin e parë përfshihen autorët që mbështetin konceptin tradicionalist të sigurisë, ndërsa në grupimin e dytë ata të konceptit jo tradicionalist. Tradicionalistët, në përcaktimin e sigurisë, përqendrohen në terminologjinë ushtarake, si në periudhën e Luftës së Ftohtë, duke u fokusuar tek kërcënimet e jashtme ndaj shtetit. Termin e sigurisë ata e barazonin me dimensionin ushtarak të saj. Në këtë mënyrë, siguria nënkuptonte sigurinë nga lufta ose konflikti i dhunshëm. Ata anashkalojnë konfliktet brenda shtetërore si kërcënime për sigurinë. Për ta sigurua e shtetit është tërësia e rrethanave dhe kushteve faktike, gjendje e përgjithshme në të cilën gjendet shteti, gjendje e cila i ofron dhe garanton siguri nga rreziqet e jashtme, të cilat do të mund të kërcënonin interesat e tij jetësore, tërësinë e tij territoriale dhe, në fund, vetë ekzistencën e tij.

Ndërsa jotradicionalistët janë përpjekur për të zgjeruar dhe thelluar përkufizimin e sigurisë jo vetëm në çështjet ushtarake dhe jo vetëm në aktorët shtetërorë. Sipas tyre një përkufizim kryesisht ushtarak përjashton vlerësimet për kërcënime të tjera. Prandaj ata e zgjerojnë dhe thellojnë konceptin e sigurisë. Ata vlerësojnë se kërcënimet më të mëdha për mbijetesën e shtetit përveç ushtarake mund të jenë dhe mjedisore, sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, ata mbështesin ndërtimin e një përkufizimi i cili në qendër ka individin, shoqërinë dhe jo shtetin. Jo tradicionalistët konceptin e sigurisë shtetërore e kanë zhvilluar dhe transformuar më tej në atë të sigurisë kombëtare.

Në mes të viteve tetëdhjetë, në kulmin e debateve mes tradicionalistëve dhe jo tradicionalistëve u krijua ajo që njihet tashmë si Shkolla e Kopenhagës⁶. Ajo është një

³ Fjalori i gjuhës shqipe 1985

⁴ Wolfers, Arnold: National Security as an Ambiguous Symbol, in idem: Discord and Collaboration. Essays on International Politics (Baltimore: John Hopkins University Press, 1962), p. 150.

⁵ Walter Lippman, cituar në Barry Buzan, “People, States and Fear (Hemel Hempstead: Harvester Wheatsheaf, 1991), f. 16.

⁶ Kjo shkollë lindi në Institutin për Kërkimet e Konflikeve dhe të Paqes, në Kopenhagë dhe përfaqësohet nga shkruarit e Barry Buzan, Ole Waever, Jaap de Wilde, etj. Ajo ka të bëjë pjesërisht me zgjerimin e kërcënimeve dhe objekteve referuese, veçanërisht shoqërorë/identitarë dhe pjesërisht me përkushtimin e një vëmendjeje më të madhe në nivelin rajonal, por kryesisht me fokusimin mbi sigurizimin – proceset sociale nëpërmjet të cilave grupe individësh ndërtojnë një kërcënim – duke ofruar kështu një sfond konstruktivist për analizën e kërcënimeve materialiste të Studimeve Strategjike tradicionale

shkollë e mendimit akademik e cila i ka fillimet në vitin 1983, në botimin e teoricienit Barry Buzan “Populli, shtetet dhe frika: problemi i sigurisë kombëtare në marrëdhëniet ndërkombëtare”. Shkolla Kopenhagës thekson veçanërisht aspektet shoqërore të sigurisë.

Sipas kësaj shkolle përpjekjet për siguri shpesh shihen dhe si kërcënim për mbijetesë të një objekti referent. Çështja e mbijetesës domosdoshmërisht përfshin një pikë pa kthim në të cilën ajo do të jetë tepër vonë për të vepruar. Ajo, gjithashtu, mbështet edhe raportin siguri-mbijetese, i cili përfshihet në konceptim tradicional të sigurisë.

Teoria e Shkollës së Kopenhagës është e fokusuar në tre koncepte kryesore, të pa trajtuara më parë, të cilat janë: sigurizimi, sektorët apo fushat më të rëndësishme për sigurinë si dhe komplekset rajonale të sigurisë.

Konceptin e sigurisë e kanë trajtuar shumë më herët dhe filozofi anglez Tomas Hobbes⁷ nëpërmjet konceptit “të gjendjes natyrore të njeriut”, ai francez, Zhan Zhak Russoi⁸ nëpërmjet konceptin e tij të “kontratës shoqërore”; Xhon Lock⁹ i cili e zgjeroi më tepër konceptin e sigurisë, duke parë edhe shtetin si një burim rreziku për qytetarin si dhe Baron de Montesquieu¹⁰ i cili flet për sigurinë e qytetarit nga vetë sulmet e shtetit.

Siguria ka dhe dimensionin e saj psikologjik. Njerëzit reagojnë kundrejt objekteve apo aktorëve të tjerë, bazuar në kuptimin që këta objekte apo aktorë kanë për to. Qëndrimi i ndryshëm ndaj miqve dhe armiqve krijon dhe përjetime të ndryshme: armiqtë përjetohen si të rrezikshëm, ndërsa miqtë jo. E njëjta gjë vlen dhe për ndërveprimet midis shteteve. Fuqia amerikane përjetohej ndryshe gjatë kohës së regjimit diktatorial në Shqipëri dhe ndryshe sot.

Shpesh, siguria, ka një natyrë më tepër psikologjike, sesa konkrete. Ajo ka të bëjë me ndjenjën, sesa me të qenit vërtetë të sigurt. Frika, ankthi dhe ndjenja e pasigurisë, jo vetëm që përzihen me krijimin e sigurisë dhe të vetvetes, por janë pjesë integrale e tyre. Në këtë mënyrë, ndërlidhja midis identitetit, frikës dhe sigurisë është e pandashme. Mund të duket si paradoks, por pasiguria është kusht i domosdoshëm për sigurinë.

Procesi i konstruksionit të sigurisë dhe domosdoshmëria për një tjetër të rrezikshëm, shpesh shton rrezikun për paraqitjen e tjetrit të rrezikshëm, që nuk përputhet me

⁷ Tomas Hobbes (1588 – 1679) nëpërmjet konceptit “të gjendjes natyrore të njeriut” shpjegon se individit para shtetëror drejtohej vetëm nga instinktet e tij dhe kërkonte në çdo moment të jetës të mbijetojë në një ambient të egër dhe armiqësor. Ishte koha kur siguria përbente “mallin” më të rëndësishëm për individin. Në këtë pikë Hobbes flet për një luftë të gjithëve kundër secilit. Në një mjedis të tillë, vetëm më të fortët kanë siguri për të mbijetuar. Askush nuk e detyronte njeriun para shtetëror t’i përmbahet parimeve të caktuara, pra të bëjë apo të mos bëjë diçka të cilën ai nuk e dëshiron.

⁸ Zhan Zhak Rusoi (Jean-Jacques Rousseau, 1712-1778), mendimtar e shkrimtar i famshëm francez, nëpërmjet konceptin e tij të “kontratës shoqërore” shpjegon se individët nënshkruajnë një kontratë (sa imagjinare aq dhe reale) me shtetin, duke ia kaluar këtij të fundit përgjegjësinë për sigurinë dhe duke e bërë atë garantuesin e vetëm të sigurisë së tij. Në këtë mënyrë shteti i jepet në dorëzim nga qytetari monopoli i “dhunës”. Tashmë shteti është i vetmi aktor që ka të drejtë të ushtrojë dhunë brenda dhe jashtë kufijve të tij duke u bërë kështu garant i sigurisë. Duke bërë këtë, individët (tashmë nënshtetas) japin disa nga liritë e tyre të “gjendjes natyrore” në shkëmbim të sigurisë.

⁹ Xhon Lock (1632 – 1704, filozof anglez) e zgjeron më tepër konceptin e sigurisë, duke parë edhe shtetin si një burim rreziku për qytetarin. Shteti, sipas tij, mund të kthehet shumë shpejt në një diktaturë dhe në këtë mënyrë është e mundur që vetë shteti të kthehet në një rrezik për nënshtetasit e tij. Në të vërtetë, diktatura të ndryshme vërtetuan frikën e Lock-ut. Sipas Lock-ut shteti duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të mos kthehet vetë në një rrezik për shtetasit e tij të cilët ai në fakt duhej t’i mbrojtë. E vetmja mënyrë për të mbajtur shtetin nën kontroll është kufizimi i fuqisë së tij, gjë që e siguron ndarja e pushtetit e cila sipas tij është e një rëndësie jetike.

¹⁰ Sipas Baron de Montesquieu (Baron de Montesquieu, Charles-Louis de Secondat, 1689 – 1755) liria politike e qytetarëve qëndron në të qenit e tyre të sigurt ose të paktën në ndjenjën e sigurisë ndaj sulmeve të pushtetit. Pra, siguria për të cilën ai flet është mbi të gjitha siguria nga sulmet e vetë shtetit. Sipas tij kjo siguri ekziston vetëm në një shtet në të cilin prodhohen dhe zbatohen ligje që mbrojnë individin nga sulmet e vetë shtetit, nga qytetarë të tjerë si dhe nga shtete të tjera

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

realitetin. Kjo ushqen ndenjën e frikës, që i bën njerëzit të ndihen të pasigurt edhe për një rrezik që nuk ekziston.

Kur fushata e keqinformimit bëhet qëllim në vetvete, atëherë bëhet fjalë për tru shpëlarje për manipulimin e njerëzve, saqë botëkuptimi i tyre merr trajtat më marramendëse të pa arsytimit, të cilat lënë shteg për krijimin e paranojës dhe të ankthit.

5.1.2. Kategoritë e sigurisë

Studimet bashkëkohore të sigurisë kanë avancuar konceptimin e saj, duke zbuluar dhe përcaktuar shumë nga dimensionet që ajo ka, të panjohura më parë, duke përfshirë kategoritë si më poshtë.

5.1.2.1. Siguria kombëtare

Për shumë kohë, studimet mbi sigurinë janë marrë në mënyrë tradicionale vetëm me identifikimin e veprimeve kërcënuese për një shtet, përndryshe me sigurinë kombëtare që në të vërtetë i bie të ishte siguria shtetërore. Në kuptimin tradicional me siguri kombëtare kuptohet ruajtja e integritetit të shteteve sovraane me anë të forcave të armatosura, diplomacisë, shërbimeve inteligjente, etj. Siguria kombëtare, si koncept tradicional, ka në qendër mbrojtjen e shtetit (kombit) nga ndonjë sulm apo rrezik, i brendshëm ose i jashtëm. Siguria kombëtare mund të përkufizohet si aftësia për t'u përballur me agresionin e jashtëm dhe për t'i rezistuar atij¹¹.

Siguria kombëtare, në kushte të përgjithshme, mund të përkufizohet si gjendje e sigurisë së shtetit-komb, e cila përfshin: sigurinë e territorit kombëtar (duke e përfshirë edhe hapësirën ajrore dhe ujërat territorialë); mbrojtjen e jetës dhe pronësisë së popullsisë së vet; mbrojtjen e sovranitetit kombëtar dhe praktikimin e funksioneve themelore të shoqërisë (ekonomike, sociopolitike, kulturore, ekologjike, shoqërore etj.).

Sot, siguria kombëtare vlerësohet si një e mirë publike dhe personale, e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut në një shtet liberal-demokratik. Vetëm duke e perceptuar dhe përkufizuar në këtë mënyrë, siguria kombëtare, krahas dimensionit politiko-ushtarak, gjithashtu, përfshin edhe dimensionet më të gjera të lartpërmendura që kanë të bëjnë me sigurinë e individit, si dhe me grupet shoqërore në nivele të ndryshme të strukturës së tyre, përkatësisht në nivel rajonal, kombëtar, ndërkombëtar dhe mbikombëtar.

Objekti i saj është mbrojtja e jetës së qytetarëve, garantimi i integritetit territorial, i sovranitetit dhe i identitetit kombëtar, promovimi i të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të minoriteteve, mbrojtja dhe zhvillimi i institucioneve demokratike kushtetuese, kontributi për arkitekturën e re të sigurimit rajonal, si dhe mbështetja e detyrimeve dhe e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Koncepti i njohur deri më tani mbi sigurinë si çështje e mbrojtjes së kufijve apo e përgatitjes së mbrojtjes së vendit, është pasuruar me përfshirjen në të edhe të sigurisë njerëzore.

5.1.2.2. Siguri njerëzore (human security)

Sot, gjithmonë e më tepër, po flitet për "siguri njerëzore" (*human security*).

Ky koncept i ri i vë individët dhe bashkësitë e tyre si pikë kryesore referimi. Krijimi i një kulture të politikës globale, të bazuar në të drejtat për të gjithë, është kërkesë e

¹¹ Giacomo Luciani, "The economic content of security", Journal of Public Policy, 8/2 (1989), f. 151.

domosdoshme për përmirësimin e sigurisë njerëzore. Siguria njerëzore kërkon kuptimin e vërtetë të të drejtave të njeriut dhe emancipimin e tij. Emancipim në kuptimin e çlirimit të njerëzve (si individë dhe grupe) nga kufizimet fizike dhe njerëzore që i ndalojnë të realizojnë atë që do zgjidhnin të bënin në kushte lirie. Siguria dhe emancipimi janë dy anë të të njëjtës monedhë. Prandaj emancipimi, dhe jo fuqia apo rendi, është ai që prodhon sigurinë e vërtetë. Kështu, teorikisht, emancipimi është siguri¹².

Nëse për sigurinë kombëtare tradicionale, parësore ka qenë mbrojtja e shtetit, e kombit, në qendër të sigurisë njerëzore është individi, standardet e pranueshme të jetës, të shëndetit dhe të mirëqenies së tij ekonomike. Pra, siguria tradicionale ka në qendër shtetin, kurse siguria njerëzore individin, komunitetin. Nocioni “siguri njerëzore” sot ka dimensione të ndryshme si:

siguria ekonomike, e cila nënkupton garantimin e disa të ardhurave bazë për jetën e individit, duke u mbështetur në punën e tij (por në mungesë të saj dhe nga një sistemi asistence);

siguria ushqimore, e cila është e lidhur ngushtë me sigurinë ekonomike dhe nënkupton që të gjithë njerëzit të kenë mundësi ekonomike dhe fizike të ushqehen në mënyrë bazike;

siguria shëndetësore, e cila synon garantimin e një mbrojtjeje të pranueshme nga sëmundjet e ndryshme apo nga një jetë e pashëndetshme;

siguria mjedisore, e cila nënkupton mbrojtjen e njerëzve nga abuzimi dhe shkatërrimi i natyrës, nga ndotja e mjedisit, nga keqpërdorimi i tokës dhe i ujit, nga përdorimi i teknologjive të prapambetura, i makinave të vjetra, etj.;

siguria e individit, e cila ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve nga dhuna fizike e aktorëve individualë apo shtetërorë;

siguria e grupit, e cila lidhet më shumë me grupet pakicë (etnike, nacionale, fetare etj.), që mund të diskriminohen nga grupi shumicë;

siguria politike, e cila ka të bëjë kryesisht me kushtet politike në të cilat jeton një popull, nëse ai jeton apo jo në një shoqëri që i respekton tërësisht liritë dhe të drejtat themelore njerëzore.

5.1.2.3. Siguria dhe rendi publik

Termi “siguri publike” nënkupton sigurinë e jetës dhe të veprimtarisë së përditshme ekonomike - shoqërore të qytetarit dhe të komunitetit, çka është afërsisht ajo që kuptohet sot me nocionin “siguri njerëzore”.

Ndërsa me “rend publik” kuptojmë garantimin e rregullit social, mbi bazën e vlerave të përcaktuara nga Kushtetuta, garantimin e institucioneve dhe parandalimin e turbullirave, të cilat kërcënojnë ose rrezikojnë këtë rend.

Më thjesht, me “rend publik” do të kuptojmë edhe tërësinë e rregullave, të sanksionuara me ligj, për të ruajtur e mbrojtur qetësinë, rregullin dhe moralin në marrëdhëniet shoqërore e qytetare.

Në kuptimin e përgjithshëm, “siguri publike” dhe “rend publik” janë nocione që përfshijnë disa kategori, si sigurinë ekonomike, atë politike, të ushqimit, të jetës, të shëndetit, të pronës, të ambientit etj. Këta faktorë kanë lidhje e ndërvartësi me njëri-tjetrin. Mangësitë e mosrealizimit të njërit faktor, p.sh. të atij ekonomik, ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në faktorët e tjerë dhe në treguesit e rendit publik.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

¹² Ken Booth, “Security and emancipation”, Review of International Studies, 17/4 (1991), f. 319.

Në përfundim mund të konkludojmë se, të marra veç e veç dhe në aspektin teorik termat “siguri publike” dhe “rend publik” kanë kuptime të ndryshme, kurse në përdorimin e përditshëm ato janë të lidhura ngushtë midis tyre dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Për këtë arsye, shpesh përdoret një term i përbashkët “rend e siguri publike”.

5.2. Kuptimi i termit “komunitet”

Akoma edhe sot nuk ka një ujdë për përkufizimin e konceptit “komunitet”. Kjo sepse në kultura të ndryshme fjala komunitet merr kuptime të ndryshme. Dhe nëse mungon një ujdë ndërkombëtarë për këtë koncept, është e natyrshme që nuk mund të ketë ujdë për koncepte të tjera të lidhura me të si siguria në komunitet, policimi në komunitet etj. Gjithsesi, edhe kjo mungesë ujdë, ka një anë pozitive pasi e pasuron konceptin e komunitetit me prurje nga kultura të ndryshme.

Në këndvështrim të këtij punimi po i referohemi *Fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe* si dhe *Fjalorit të Oksfordit*.

Në *Fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe*¹³ kuptimin e parë të fjalës komunitet e njësion me atë të bashkësisë dhe konkretisht “Të pasurit diçka të përbashkët me një tjetër, prania e një tipari të përbashkët me një tjetër; lidhja e dy a më shumë gjërave sipas diçkaje të përbashkët. Bashkësi ekonomike. Bashkësi (lidhje) gjuhësore. Bashkësia e territorit. Bashkësi idesh (qëllimesh, interesash, pikëpamjesh). Bashkësi mendimi (veprimi)” si dhe “Grup njerëzish, që janë të lidhur e të bashkuar nga prejardhja, nga kushtet e jetesës, nga veçoritë kombëtare, nga interesa e qëllime të përbashkëta etj.; grup vendesh a popujsh, që lidhen nga kushte historike ose nga interesa të përbashkëta ekonomike, shoqërore e politike”.

Gjithashtu, *Fjalori i gjuhës shqipe* si kuptim të dytë për komunitetin e jep si një “Grup njerëzish që kanë të njëjtin besim e që drejtohen nga një organizatë fetare, e cila zakonisht njihet e përkrahet nga shteti (në vendet ku vepron feja)” si komunitet fetar, mysliman, katolik, bektashi etj, duke e ngushtuar kështu vetëm në profilin fetar. Fjalën komunitet e lidh gjithashtu në kuptimin e një komuniteti primitiv, si formë organizimi e shoqërisë pa klasa (bashkësi primitive).

Në *Fjalorin e Oksfordit* fjala komunitet¹⁴ përcaktohet si: 1. Të gjithë njerëzit që jetojnë në një zonë, vend, etj. kur flitet si grup, si për shembull komuniteti lokal, komuniteti ndërkombëtar etj; 2. Një grup njerëzish që ndajnë të njëjtën fe, racë, punë, etj. si për shembull komuniteti shqiptar në Një Jork, komuniteti inteligjencës, i biznesit, komuniteti gej, komuniteti mysliman etj; 3. ndjenja e ndarjes së gjërave dhe përkatësisë në një grup në vendin ku jetoni, si për shembull frymë komunitare, etj; 4. Një grup njerëzish që jetojnë së bashku dhe të gjithë në mënyrë të barabartë zotërojnë dhe ndajnë atë që kanë, si për shembull murgeshat jetojnë në një komunitet të mbyllur, etj;

Në kontekstin e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, komuniteti mund të përkufizohet si njerëz që jetojnë në një zonë gjeografike, të cilët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të zakonshme për shkak të vendndodhjes së tyre. Ata mund të kenë përvojë të përbashkët në reagimin ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive. Megjithatë, ata mund të kenë perceptime të ndryshme për dhe ekspozimin ndaj rrezikut.¹⁵

Një grup kërkuesish të tjerë shkencorë që merren me studimin e katastrofave

¹³ <http://www.fjalori.shkenca.org/>

¹⁴ <https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/english/community?q=community>

¹⁵ Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p.8.

natyrore (Dewald Van Niekerk, Livhuëani NemaKonde, Leandri Kruger, KylaH Genade) propozojnë katër elemente për komunitetin. Së pari, një komunitet duhet të ketë anëtarë. Anëtarësia krijon ndjenjën e përkatësisë. Së dyti, një komunitet duhet të jetë në gjendje të ndikojë. Kjo lidhet me aftësinë e grupit për të ndikuar tek individ, individ për të ndikuar në grup dhe aftësia e kolektivit për të ndikuar në mjedisin e tyre. Së treti, integrimi dhe përbashkja e nevojave janë çelësi për një komunitet. Prandaj, nevojat e anëtarëve do të plotësohen nga aplikimi i burimeve të disponueshme në grup për të adresuar këto nevoja. Së fundi, ata shpallin se një komunitet “ndanë lidhje emocionale”¹⁶.

Theksi është shumë më tepër në lidhjet midis njerëzve sesa në hapësirën fizike që ata zënë, duke e përshkruar komunitetin si një ndjenjë që kanë anëtarët e përkatësisë, një ndjenjë që anëtarët kanë rëndësi për njëri-tjetrin dhe për grupin, dhe një besim i përbashkët se nevojat e anëtarëve do të plotësohen përmes përkushtimit të tyre për të qenë së bashku, prandaj në këtë kuptim mund të themi që komuniteti përfshin aspekte, elementë dhe njerëz që i kapërcejnë kufijtë gjeografikë. Megjithatë, brenda fushës së reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, duhet të supozohet se vendndodhja fizike mbetet e rëndësishme. Vendndodhja fizike është e lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut dhe cenueshmërinë¹⁷, dhe, për këtë arsye, duhet vlerësuar si element i rëndësishëm për përkufizimin e “komunitetit”.

Pra, komuniteti është një term që ka një gamë të gjerë përdorimi, i cili përfshin: dimensionin gjeografik: të tilla si një grup të familjeve, një fshat i vogël ose një lagje në një qytet; Komuniteti mund të përcaktohet nga përvoja e përbashkët, si p.sh grupe të veçanta interesi, grupe etnike, grupe profesionale, grupe gjuhësore, grupe të veçanta të ekspozuara ndaj rrezikut, etj; Komuniteti mund të përcaktohet gjithashtu sipas sektorëve, siç janë fermerët, peshkatarët, sektori i biznesit, etj. Komuniteti mund të përdoret për t’iu referuar grupimeve që janë të dyja të prekura dhe mund të ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve dhe reduktimin e dobësive¹⁸.

Për qëllimin tonë të sigurisë së komunitetit në kuadër të menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive, një komunitet mund të merret si një grup që mund të ndajë një ose më shumë gjëra të përbashkëta, si p.sh. të jetuarit në të njëjtin mjedis, ekspozimi i ngjashëm ndaj rrezikut të fatkeqësive, ose që ka qenë të prekur nga një fatkeqësi si dhe mund të ndajnë probleme, shqetësime dhe shpresa të përbashkëta në lidhje me rreziqet e fatkeqësive¹⁹.

Në përfundim, në kontekstin e këtij punimi, mund të konkludojmë se elementet kryesor të konceptit komunitet janë të qenit një bashkësi njerëzish që jetojnë në një hapësirë gjeografike, që kanë elementë të kulturës dhe institucione të përbashkëta dhe bashkëveprojnë me aktorë e grupe të tjera brenda këtij territori si organizatat e shoqërisë civile, policinë dhe autoritetet lokale, të cilët janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të sigurisë dhe të tjera në atë zonë.

5.3. Siguria në komunitet ose siguria e komunitetit

Koncepti i sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit është mjaft i ri edhe për komunitetet

¹⁶ Dewald Van Niekerk, Livhuwani NemaKonde, Leandri Kruger and KylaH Genade: Community-based Disaster Risk Management, f.3

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p. 10.

¹⁹ Po aty, f.11.

akademike. Në fakt, deri më sot, janë bërë pak përpjekje për të përcaktuar konceptin, ndërkohë që është zhvilluar si një praktikë në këto dhjetë vitet e fundit. Megjithatë shumë iniciativa ose projekte që emërtohen si të tilla shpesh e trajtojnë atë si përpjekje për të shtuar mbështetjen dhe besimin e publikut tek policimi. Në përgjithësi, shumë pak autorë janë përpjekur për të përcaktuar konceptin. Një nga të rrallët është studiuesi kanadez Chad Nilson i cili e përcaktoi sigurinë në komunitet si “gjendja në të cilën arrihen nevojat e përbëra të sigurisë dhe mirëqenies kolektive të një komuniteti”²⁰. Në përpjekje për të specifikuar më tej këtë çështje, Ministria e Sigurisë në Komunitet dhe Shërbimeve Korrektuese në Kanada në vitin 2017 e përshkroi konceptin e sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit si “gjendjen ideale të një komuniteti të qëndrueshëm ku të gjithë janë të sigurt, kanë një ndjenjë përkatesie, mundësi për të marrë pjesë dhe ku individët dhe familjet janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre për arsim, kujdes shëndetësor, ushqim, strehim, të ardhura dhe shprehje sociale dhe kulturore”²¹, koncept ky i përafërt me sigurinë njerëzore dhe sigurinë publike të cilat i trajtuam më parë.

Siç shihet, në një farë mase, koncepti i sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit përfaqëson një bashkim të dy fushave të veçanta: “siguria e komunitetit” dhe “mirëqenia”, duke kombinuar kështu elementet shumëdimensionale të mirëqenies me një kuptim më të gjerë të sigurisë së komunitetit, ashtu sikurse kombinohet siguria me emancipimin, si dy anë të së njëjtës monedhë, ku emancipimi, dhe jo fuqia apo rendi, është ai që prodhon sigurinë e vërtetë²².

Siguria e komunitetit duhet kuptuar edhe një situatë në të cilën njerëzit, individualisht dhe kolektivisht, janë mjaftueshëm të lirë nga një sërë rreziqesh reale dhe të perceptuara që përqendrohen në krimin dhe sjelljet e pahijshme të lidhura me to; janë mjaftueshëm të aftë për të përballuar ato rreziqe që ata megjithatë përjetojnë; ose kur nuk mund t’i përballojnë pa ndihmë, janë mjaftueshëm të mbrojtur nga pasojat e këtyre rreziqeve, saqë mund të bëjnë ende një jetë normale kulturore, sociale dhe ekonomike, të zbatojnë aftësitë e tyre dhe të gëzojnë mirëqenie dhe marrjen e shërbimeve adekuatë²³.

Por, siguria e komunitetit jo rrallë shihet pak më ngushtë duke kuptuar thjesht si një metodë policimi, me qëllim që të sigurojë reduktime të qëndrueshme të krimit dhe frikës nga krimi në komunitetet lokale. Në Angli, në mesin e viteve 1990, ishte pranuar tashmë se krimi dhe çrregullimi nuk mund të trajtoheshin vetëm nga policia, por ishte e nevojshme që autoritetet lokale të punojnë së bashku me policinë në hartimin e strategjive për të ndikuar dhe reduktuar krimin dhe çrregullimin.

Në vitin 1998, qeveria angleze nxori *Crime and Disorder Act* të vitit 1998²⁴. Në këtë dokument u përcaktuan kërkesat ligjore për autoritetet lokale, policinë, partnerët dhe agjencitë e tjera kyçe që të punojnë së bashku për të trajtuar krimin dhe çrregullimin në zonën e tyre. Kështu u krijuan ekipet e sigurisë në komunitet. Ekipi i sigurisë në komunitet fokusohet në çështjet e krimit, çrregullimit dhe sjelljes antisociale dhe punon me departamentet e tjera të këshillit të bashkisë, si dhe agjencitë/organizatat lokale dhe Partneritetin e Sigurisë në Komunitet për t’u përpjekur t’i adresojnë çështjet duke

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

²⁰ Chad Nilson: Community safety and well-being: Concept practice, and alignment, *Journal of community safety & well-being*, Journal of CSWB. 2018 Dec;3(3), p. 97.

²¹ Po aty.

²² Emancipim në kuptimin e çlirimit të njerëzve (si individë dhe grupe) nga kufizimet fizike dhe njerëzore që i ndalojnë të realizojnë atë që do zgjidhnin të bënin në kushte lirie. Kësisoj, teorikisht, emancipimi është siguri. Për më tepër shih: Ken Booth, “Security and emancipation”, *Review of International Studies*, 17/4 (1991), f. 319.

²³ <https://www.lawinsider.com/dictionary/community-safety>

²⁴ Për më tepër shih *Crime and Disorder Act 1998*

zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje efektive.²⁵

Një veçori tjetër e sigurisë në komunitet është fokusi nga poshtë lart në krijimin dhe stabilizimin e sigurisë. Ajo nuk ka të bëjë me krijimin e sigurisë në nivel kombëtar, nga lart poshtë, nëpërmjet legjislacionit apo mjeteve të tjera. Ajo fokusohet kryesisht në zgjidhjet afatshkurtra dhe afatgjata për problemet e sigurisë në komunitete të veçanta. Sipas Chad Nilson²⁶ Konceptet kryesore që ndërthuren me sigurinë në komunitet dhe mirëqenien janë rreziku²⁷, cenueshmëria²⁸ dhe dëmi (dëmtimi)²⁹. Në këndvështrimin e këtij punimi janë pikërisht rreziku, cenueshmëria (kërcënimi) dhe dëmi (dëmtimi) nga fatkeqësitë natyrore që ndikojnë në sigurinë në komunitet dhe mirëqenien e tyre. Nevojat për sigurinë dhe mirëqenien e një komuniteti plotësohen kur kushtet e rrezikut zbuten, cenueshmëria zvogëlohet dhe shfaqja e dëmit është zero.

Komunitetet kanë të drejtën të kontribuojnë dhe të vendosin mbi sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Përgjegjësia për zhvillimin e sigurisë në komunitet i takon vetë komuniteteve. Të gjithë aktorët që operojnë në atë territor, jo vetëm policia, duhet të jenë të interesuar për arritjen e sigurisë në komunitet.

Për këtë është e domosdoshme kontakti dhe komunikimi zyrtar dhe jo-zyrtar midis policisë dhe publikut, ku përfshihen grupet e interesit të komunitetit, shoqëritë e shërbimeve dhe përfaqësuesit e komunitetit lokal; marrja e masave të përbashkëta me qëllim që të identifikohen problemet dhe prioritetet e sigurisë në komunitet; marrëveshjet për partneritete lokale midis policisë, institucioneve të tjera dhe vetë komunitetit për t'i trajtuar këto probleme; një reagim i përbashkët efikas si dhe parandalimi ose reduktimi i shkaqeve dhe pasojave të problemeve.

Në përfundim mund të konkludojmë se: sigurinë në komunitet apo sigurinë e komunitetit mund ta përcaktojmë si gjendja në të cilën arrihen nevojat e përbëra të sigurisë dhe mirëqenies kolektive të një komuniteti. Në një farë mënyre është funksionalizimi i sigurisë njerëzore apo sigurisë dhe rendit publik në nivelin e një komuniteti lokal.

Konceptet kryesore që ndërthuren me sigurinë në komunitet dhe mirëqenien janë rreziku, cenueshmëria dhe dëmi (dëmtimi). Nevojat për sigurinë dhe mirëqenien e një komuniteti plotësohen kur kushtet e rrezikut zbuten, cenueshmëria zvogëlohet dhe shfaqja e dëmit është zero.

5.4. Fenomenet ekstreme të natyrës / fatkeqësitë natyrore si rezik e kërcënim për sigurinë e komunitetit në Shqipëri.

5.4.1. Kuptimi mbi fenomenet ekstreme të natyrës / fatkeqësitë natyrore

Fenomenet natyrore janë dukuri që zhvillohen sipas rregullave apo ligjeve të natyrës. Ato nuk janë të krijuara nga njeriu dhe shumica e tyre janë relativisht të padëmshme për të. Fenomenet apo dukuritë e natyrës mund të sjellin rreziqe që janë pjesë e jetës. Por këto

²⁵ <https://www.northampton.gov.uk/info/200258/community-safety/1390/what-is-community-safety>

²⁶ Chad Nilson: Community safety and well-being: Concept practice, and alignment, Journal of community safety & well-being, Journal of CSWB. 2018 Dec;3(3), p.98.

²⁷ Rreziku është një gjendje, e karakterizuar nga paqëndrueshmëria në siguri dhe mirëqenie, që mund të ekzistojë në formë unitare ose të përbërë, e cila kontribuon në cenueshmërinë e individëve, familjeve dhe komuniteteve.

²⁸ Cenueshmëria përfaqëson një probabilitet të shtuar – të rritur nga rrethanat e situatës, personale dhe/ose sistematike – që të ndodhë dëmi për shkak të rritjeve akute, niveleve të larta ose kushteve kronike të rrezikut.

²⁹ Dëmtimi është çdo lëndim ose dëm fizik, seksual, psikologjik, emocional ose ekonomik - qoftë i qëllimshëm apo i paqëllimshëm - që ndikon në sigurinë dhe mirëqenien e individëve, familjeve ose komuniteteve.

dukuri kthehen në fatkeqësi vetëm atëherë kur preket jeta dhe mjetet e jetesës së njerëzve³⁰.

Fenomenet ekstreme të natyrës, në këndvështrim të këtij punimi, janë fenomene natyrore që sjellin pasoja të rënda për njeriun, janë ato elemente në mjedisin fizik, të dëmshëm për njeriun dhe të shkaktuara nga forca të jashtëzakonshme për të, janë ato fenomene që kthehen në rreziqe natyrore. Këto rreziqe janë procese apo fenomene ekstreme natyrore që mund të shkaktojnë humbje të jetëve, plagosje apo impakte të tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, probleme sociale dhe ekonomike ose dëmtim mjedisor si dhe të tjera fatkeqësi apo katastrofa natyrore³¹.

Vetë fatkeqësitë në këndvështrimin e këtij punimi dhe të legjislacionit shqiptar, janë ndërprerja serioze e çfarëdolloj shkalle të funksionimit të një komuniteti ose shoqërie për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit përballues, duke çuar në humbje të mundshme njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisor³².

Ndërsa, fatkeqësi natyrore janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tej zgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin³³.

Me qëllim parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose të fatkeqësive të tjera nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, vendoset gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Shqipëria është e ekspozuar përballë fatkeqësive me burim natyror, me origjinë njerëzore dhe nga ngjarje të mundshme ekologjike³⁴. Fatkeqësitë me burim natyror mund të jenë me origjinë:

- gjeologjike (tërmetet, rënie shkëmbinjsh, rrëshqitje toke);
- hidrologjike (përmbytjet, vërshimet e lumenjve e përrenjve)
- atmosferike (stuhi dëbore, ere, thatësira);
- biofizike (zjarre pyjesh, pandemi);
- ortekë bore.

Fatkeqësitë me origjinë njerëzore mund të jenë:

- përmbytjet nga çarjet e digave;
- ngjarje rrezikuese me burim teknologjinë.

Fatkeqësitë natyrore sjellin situata të emergjencave civile. Këto janë situata të papritura, me pasoja negative për komunitetin dhe që cenojnë sigurinë e tij, të cilat shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin³⁵.

Në përfundim mund të konkludojmë se fenomenet natyrore janë dukuri të zakonshme. Fenomenet ekstreme të natyrës, në këndvështrim të këtij punimi, janë fenomene natyrore që shkaktojnë fatkeqësi natyrore, duke krijuar situata të

³⁰ Xhavit Shala: Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë mes realitetit dhe perceptimit, f. 4-5. Tiranë, maj 2021.

³¹ Po aty.

³² Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Neni 3/8

³³ Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Neni 3/9

³⁴ Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri, UNDP, Tiranë, Tetor 2002, f. 19

³⁵ Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Neni 3/6.

emergjencave civile me pasoja të rënda për njeriun dhe sigurinë e komunitetit.

5.4.2. Fatkeqësitë natyrore si rrezik e kërcënim për sigurinë e komunitetit dhe jo vetëm.

Në Shqipëri, kërcënimi i sigurisë së komunitetit nga fatkeqësitë natyrore është i madh. Shqipëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta natyrore, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek ato me origjinë hidrometeorologjike dhe gjeologjike, si tërmetet, përmbytjet, thatësitat, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e tokës³⁶.

Fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore përbëjnë rrezik dhe kërcënim jo vetëm për sigurinë e komunitetit por dhe më gjerë, për sigurinë kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Fatkeqësitë natyrore paraqesin disa nga problemet më të vështira të sigurisë³⁷, sepse ato janë të paktën po aq destabilizuese sa konfliktet politike, ekonomike, etnike ose fetare të krijuara nga njeriu dhe vrasin më shumë njerëz në mesatare sesa konfliktet. Fatkeqësi të tilla shpesh krijojnë një numër të madh refugjatësh ose zhvendosje të popullsisë që kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme, me qëllim parandalimin e katastrofave të tjera edhe më të mëdha të tilla si uria, epidemitë ose kolapsi i plotë³⁸.

Siguria sot është “shërbimi apo malli më i çmuar në treg”. Ajo është një fjalë me domethënie dhe simbolikë të fortë. Kur një problem identifikohet si çështje sigurie, ai mund të sigurizohet, duke monopolizuar kështu edhe zgjidhjen e tij nga shteti. Fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore kërcënojnë sigurinë mjedisore, si pjesë e sigurisë kombëtare. Siguria mjedisore ka qenë një prej çështjeve të reja më të rëndësishme të sigurisë e cila ka ndihmuar në zgjerimin e kuptimit të këtij koncepti pas Luftës së Ftohtë. Siguria mjedisore, gjithashtu, është një komponent i rëndësishëm i sigurisë njerëzore dhe pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare. Në këtë mënyrë, fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore përbëjnë një kërcënim permanent për sigurinë mjedisore e indirekt edhe për sigurinë kombëtare dhe atë ndërkombëtare³⁹.

Fatkeqësitë natyrore gjithashtu mund të nxisin flukset migratore ndërkufitare, të cilat ndonëse ndryshojnë nga kërcënimet e jashtme tradicionale, sepse janë të pakontrolluara, mbeten përsëri potencialisht si kërcënim jo armiqësor për sigurinë kombëtare të një vendi.

Edhe fatkeqësitë natyrore në formën e një pandemie përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare e ndërkombëtare. Për shembull, një grip pandemik, siç është Covid 19, ka vrrarë me qindra e mijëra qytetarë të një vendit apo miliona në rang botëror si dhe ka shkaktuar humbje të mëdha ekonomike, në nivele kombëtare e ndërkombëtare.

Fenomenet ekstreme të natyrës janë rrezik e kërcënim edhe për sigurinë e njerëzore, në të gjithë komponentët e saj përbërës, sidomos sigurinë individuale e atë shëndetësore. Ato kufizojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut. Në rang botëror Shqipëria renditet ndër vendet me pasoja të larta ekonomike nga fatkeqësitë. Rreth 86% e territorit ku gjenerohet afërsisht 88,5% e PBB-së, është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve⁴⁰.

Nga viti 1852 deri në vitin 2013 në Shqipëri kanë ndodhur rreth 4000 raste

³⁶ Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, Tiranë, 2018. f. 1.

³⁷ Mandel, R. (2002), Security and Natural Disasters. Journal of Conflict Studies, 22(2), Retrieved from <https://journals.lib.unb.ca/index.php/JCS/article/view/396>.

³⁸ Ted Constantine, Intelligence Support to Humanitarian-Disaster Relief Operations (Washington, DC: Central Intelligence Agency Center for the Study of Intelligence, December 1995), p. 3- 4.

³⁹ Xhavit Shala: Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë mes realitetit dhe perceptimit, f. 6. Tiranë, Maj 2021.

⁴⁰ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2014, f. 21.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

fatkeqësish. Përmbytjet (38 për qind) vlerësohen si shkaktare të humbjeve më të mëdha ekonomike gjatë periudhës 1990-2014, të ndjekura nga përmbytjet e shpejta (33 për qind) dhe rrëshqitjet e tokës (7 për qind)⁴¹.

Gjatë dekadave të shkuara, Shqipëria është goditur mesatarisht nga një fatkeqësi natyrore madhore në vit. Në 30 vjet, midis 1980 dhe 2010, janë regjistruar 23 fatkeqësi të tilla. Prej tyre nëntë fatkeqësi kanë qenë përmbytje, katër tërmete dhe tre goditje nga temperatura ekstreme. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të këtyre fatkeqësive 163 njerëz humbën jetën ndërsa rreth 4 milionë u prekën në një masë apo në një tjetër⁴².

Në Shqipëri, gjatë vitit 2003, me mbështetjen e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, u realizua për herë të parë vlerësimi i rreziqeve të mundshme në nivel kombëtar. Kjo u materializua në studimin me titull “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”⁴³.

Kërcënimet e rreziqeve nga përmbytjet në Shqipëri është i lartë, ku mesatarisht ndodh një ngjarje e tillë çdo gjashtë vjet. Gjatë 33 viteve të fundit, humbjet ekonomike të shkaktuara nga përmbytjet vlerësohen në 2,3 miliardë USD⁴⁴.

Në analizën që i bëhet mjedisit të brendshëm, në Strategjinë tonë të Sigurisë Kombëtare, dokumenti kryesor strategjik i Shqipërisë, vlerësohet se “vendi ynë është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve me origjinë natyrore të karakterit gjeologjik, hidrologjik, atmosferik dhe biofizike, si dhe atyre me origjinë njerëzore, teknologjike dhe industriale”⁴⁵.

Gjithashtu, vlerësohet se edhe ndryshimi i klimës përbën “një dukuri globale, që ndikon negativisht në ekuilibrat natyrorë të RSH. Për shkak të klimës vendi mund të përballë me fenomene të skajshme më të shpeshta si temperatura të larta, thatësira të zgjatura dhe përmbytje të mëdha. Kjo mund ta ballafaqojë vendin me rrezikun nga fatkeqësitë hidrologjike, gjeologjike dhe biofizike, që prekin zonat e banuara dhe ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në ekonominë kombëtare”⁴⁶, duke u kthyer kështu në rrezik e kërcënim për sigurinë kombëtare të vendit.

Sipas një analize të FAO-s (Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara) të vitit 2018, Shqipërinë nuk e konsideronte “një çështje me rëndësi menaxhimin e rrezikut nga thatësitat dhe për këtë arsye analiza e vetme që kryhet për rrezikun nga thatësitat kryhet nga akademikët dhe në kuadër të projekteve të kërkimit dhe zhvillimit”⁴⁷.

Gjithashtu vlerësimi i rrezikut nuk është zhvilluar nga aspekti operacional. Ka një agjenci kombëtare siç është AKMC-ja, e cila është organ koordinues dhe nuk ka kapacitet të vërtetë teknik për të kryer vlerësime aktuale të rrezikut. Gjithashtu, dhe ministritë e linjës nuk kanë kapacitete për të prodhuar harta të përditësuara të rrezikut dhe të dhënat mbi ekspozimin dhe cenueshmërinë janë të pakta.

Në Shqipëri, edhe sjellja e popullsisë shpesh ka kontribuar në rritjen e efekteve të fatkeqësive në vend. Kjo evidentohet qartë me urbanizimin e pakontrolluar e kaotik të ndodhur në dy dekadat e fundit. Një tjetër sfidë është dominimi i “mentalitetit të komandimit”, në vend të mentalitetit të iniciativës, hapjes, koordinimit dhe kooperimit.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

⁴¹ Po aty, f. 2.

⁴² Foto Duro, Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri, IDM, f. 2.

⁴³ “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”, Program i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Tiranë, Tetor 2003.

⁴⁴ Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, Tiranë, 2018. f. 1.

⁴⁵ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2014, f. 21.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, Tiranë, 2018. f. 39.

Gjithashtu, mungon një kulturë solide vullnetarizmi. Të gjitha këto tipare kulturore janë shpjeguar kryesisht me ndikimin për një kohë të gjatë të “qasjes së shtetit të centralizuar”⁴⁸.

Vlerësimi i rrezikut potencial nga fatkeqësitë natyrore kryhet përmes analizës sasiore e cilësore të natyrës dhe të rrethanave të tjera për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera. Procesi i kryerjes së vlerësimit të rrezikut bazohet në një shqyrtim dhe analizim të gjithë karakteristikave të tilla si vendndodhja, intensiteti, frekuenca, probabiliteti dhe potenciali i ndikimeve fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, ndjeshmërisë dhe ekspozimit. Vlerësimi i rrezikut është themeli për hartimin e planeve të emergjencës⁴⁹.

Vlerësimi i rrezikut është sasia e pritshme e dëmit që përcakton nivelin e efekteve negative mbi jetesën e një popullsie ose pronat e saj pas ekspozimit ndaj një dukurie të mundshme rreziku. Përbërësit kryesorë të vlerësimit të një rreziku përfshijnë identifikimin e dukurisë së mundshme të rrezikut dhe një analizë që u përgjigjet këtyre pyetjeve: Cilat janë dukuritë e mundshme të rrezikut që mund të cenojnë një komunitet?

Çfarë mund të ndodhë si rezultat i këtyre dukurive? Sa të ngjarë ka të ndodhë secili nga rreziqet e mundshme? Nëse ngjarjet ndodhin, cilat do të jenë rezultatet dhe humbjet⁵⁰?

Përveç këtyre problemeve, në Shqipëri ekziston një mangësi e madhe konceptore; konkretisht, nocioni i referohet vlerësimit të rrezikut vetëm si hartëzim i rrezikut, në vend që të përfshijë analiza të qarta të skenarëve të shumëfishtë të fatkeqësive dhe nivelin e ekspozimit të njerëzve dhe të pasurive të tyre ndaj secilit skenar⁵¹. Kjo do të thotë se duhet të ndryshojë mendësia dhe qasja ndaj vlerësimit dhe kuptimit të rrezikut. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut në Shqipëri duhet të ndërtohet nga themelet, duke filluar me një kuadër ligjor dhe institucional me kompetenca, detyra dhe përgjegjësi të qarta, së bashku me sigurimin e financimeve për burimet e duhura njerëzore dhe për të dhënat, mjetet dhe kapacitetet e duhura teknike.

Mos përditësimi për një kohë të gjatë i *Planit kombëtar të emergjencave civile*, mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut dhe mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut si dhe mos menaxhimi i fazës transitorë të reformimit që po kalon AKMC, kanë sjellë një situatë me risk të lartë në drejtim të funksionimit dhe koordinimit të të gjitha strukturave të emergjencave civile në vend⁵².

Përveç ngjarjeve të mundshme të fatkeqësive natyrore, karakteristike për territorin shqiptar është dhe shtimi i prekshmërisë së bashkësisë (komunitetit), një faktor më vete kjo me rëndësi për potencialin e përgjithshëm të rreziqeve e fatkeqësive në vendin tonë, për shkak të shtimit të popullsisë dhe shpërnguljes në zona urbanë të pasigurta, degradimi i burimeve natyrore, mungesa e masave të rrepta për kontrollin e mjedisit, aftësia e dobët institucionale dhe niveli i ulët i burimeve për tu përballur me kërkesat e fatkeqësive masive si dhe pjesëmarrja e pa mjaftueshme e bashkësive vendore në menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe emergjencat etj.⁵³

⁴⁸ Foto Duro, Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri, IDM, f. 2

⁴⁹ Udhëzues për bashkitë “Për menaxhimin e emergjencave civile”. Botim i përgatitur nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Fondacionit Hanns-Seidel, Shqipëri, Tiranë 2018, f. 22.

⁵⁰ Po aty, f. 31.

⁵¹ Foto Duro, Menaxhimi i emergjencave civile në Shqipëri, IDM, f. 6.

⁵² Raport Përfundimtar Auditimi mbi auditimin e “Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit” në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Tiranë 2020, f. 6.

⁵³ “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”, Program i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Tiranë, Tetor 2003, f. 19.

Analiza e ngjarjeve të veçanta dhe vlerësimet sasiore të rreziqeve kanë identifikuar se kërcënimet më të mëdha nga një fatkeqësi e vetme në Shqipëri janë nga tërmetet e rënda si dhe përmytjet e mëdha nga lumenjtë e Ultësirës Perëndimore duke shtuar këtu dhe pandemitë. Shfaqja e pandemisë me Covid-19 si rrezik i ri dhe sistemik, imponon gjithashtu nevojën për zhvillim të mëtejshëm, në mënyrë që të sigurojë parandalim dhe gatishmëri për trajtimin e krizave dhe fatkeqësive komplekse që shkaktojnë pasoja të mëdha.

Në përfundim mund të konkludojmë se fenomenet ekstreme të natyrës përbëjnë rrezik e kërcënim jo vetëm për sigurinë e komunitetit, por dhe më gjërë për sigurinë kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Shqipëria vlerësohet e rrezikuar nga tërmetet, përmytjet, zjarret, pandemitë, digat, reshjet e borës si dhe rreziqet teknologjike. Rreth 86% e territorit ku gjenerohet afërsisht 88,5% e PBB-së, është e ekspozuar ndaj dy ose më shumë rreziqeve. Në Shqipëri është evidentuar aftësia e dobët institucionale dhe niveli i ulët i burimeve për t'u përballur me kërkesat e fatkeqësive masive si dhe pjesëmarrja e pa mjaftueshme e bashkësive vendore në menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe emergjencat.

5.5. Menaxhimi i suksesshëm i emergjencave civile, një qasje proaktive në trajtimin e fatkeqësive natyrore.

Në këndvështrim të këtij punimi dhe sipas legjislacionit shqiptar, emergjencat civile janë situata të papritura me pasoja negative për komunitetin dhe që cenojnë sigurinë e tij, të cilat shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore dhe jo vetëm, fatkeqësi që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin⁵⁴.

Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ka përcaktuar se *Strategjia kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë* është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë⁵⁵, strategji e cila miratohet nga qeveria dhe mund të rishikohet në çdo 5 vjet.

Gjithashtu edhe njësitë e vetëqeverisjes miratojnë, minimalisht çdo pesë vjet, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë si dhe planet vendore për emergjencat civile.

Me qëllim forcimin e sigurisë në komunitet, ligjvënësit kanë pajisur strukturat e pushtetit vendor me kompetenca të rëndësishme në fushën e sigurisë publike. Kështu në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, të vitit 2015, në nenin 29, me nën titullin “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e disa funksioneve në fushën e sigurisë së komunitetit dhe konkretisht të këtyre funksioneve si⁵⁶:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe

⁵⁴ Ligj nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 3/6.

⁵⁵ Po aty, neni 10.

⁵⁶ Ligji për vetëqeverisjen vendore, nr. 139/2015, neni 29.

ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjve të vetë-qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore⁵⁷. Vetë mbrojtja civile është tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit⁵⁸. Pra bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e funksionimit të mbrojtjes civile, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në nivele vendore, elementët kryesor të gatishmërisë për përballimin dhe menaxhimin e emergjencave janë hartimi, miratimi dhe testimi i planit të menaxhimit të emergjencave⁵⁹; ngritja dhe funksionimi në vazhdimësi i strukturave bashkiake për përballimin e emergjencave⁶⁰; kryerjen e vlerësimit të rrezikut nga kërcënimet e mundshme të komunitetit; kryerja e trajnimeve të menaxhimit të emergjencave civile, hartimi i programeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit për komunitetin si dhe menaxhimi dhe vendimmarrja gjatë një situatë emergjente⁶¹. Menaxhimi i emergjencave përbëhet nga katër faza të ndryshme, por që ndërthuren pashmangshmërisht me njëra-tjetrën. Këto faza janë parandalimi/lehtësimi, përgatitja/mbrojtja, përgjigja/veprimi dhe rikthimi në gjendjen normale (riaftësimi)⁶². Vetë menaxhimi i emergjencave , sht , organizimi dhe menaxhimi i burimeve dhe përgjegjësi për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti të gatishmërisë, të përgjigjes dhe të hapave fillestarë të rimëkëmbjes⁶³.

Faza e parë e parandalimit⁶⁴/lehtësimi⁶⁵ ka të bëjë me identifikimin e rrezikut potencial në zona të caktuara, përgatitjen dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese të këtij rreziku të identifikuar. Këto masa do të shërbejnë për të zvogëluar ose eliminuar rrezikun dhe ndikimin e mundshëm në sigurinë e komunitetit⁶⁶. Faza e dytë, përgatitja/mbrojtja lidhen me trajnimin cilësor dhe sasior jo vetëm të strukturave përkatëse të bashkisë, por dhe të këshillit apo strukturave të tjera. Gjithashtu, në këtë fazë kryhet dhe identifikimi i burimeve të nevojshme dhe mënyrat si do të përdoren këto burime⁶⁷.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Ligj nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Neni 3/23

⁵⁹ Po aty, neni 3/35: "Plani për emergjencën civile" është plani për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësie tjetër, i hartuar në bazë të vlerësimit të risqeve dhe të gjetjeve të ekspertëve.

⁶⁰ Struktura e emergjencave civile në bashki është struktura kryesore që kordinon trajnimet dhe të gjitha aktivitetet në kuadër të menaxhimit të emergjencave duke punuar së bashku me struktura të tjera bashkiake; me agjencitë vullnetare si dhe duke koordinuar me strukturat rajonale dhe qendrore për të siguruar udhëzimet dhe ekspertizën e kërkuar për bashkinë.

⁶¹ Udhëzues për bashkitë "Për menaxhimin e emergjencave civile". Botim i përgatitur nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Fondacionit Hanns-Seidel, Shqipëri, Tiranë 2018, f.20.

⁶² Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), Miratuar me VKM nr. 835, dt. 3 Dhjetor 2004, f.21, 29,36, 52.

⁶³ Ligj nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Neni 3/25.

⁶⁴ Parandalimi përkufizohet, si tërësia e masave për shmangien e situatave të emergjencave civile që mund të prekin jetën, pasurinë dhe trashëgiminë kulturore.

⁶⁵ Lehtësimi përkufizohet, si tërësia e masave për zvogëlimin e prekshmërive sociale, ekonomike dhe mjedisore ndaj dukurive të mundshme të rrezikut, që mund të vijnë nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të aktivitetit njerëzor.

⁶⁶ Udhëzues për bashkitë "Për menaxhimin e emergjencave civile" ..., f.18-19:Vlerësimi i rrezikut potencial kryhet përmes analizës sasore e cilësore të natyrës dhe të rrethanave të tjera për ndodhinë e prishme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

⁶⁷ Në këtë fazë, përgatiten masat mbrojtëse që janë masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Faza e tretë, përgjigja/përballimi përfshin tërësinë e veprimeve të bashkisë, subjekteve të tjera publike e private dhe të komunitetit për të përballuar një rrezik aktual apo një situatë prezentë të emergjencës civile vendore⁶⁸.

Faza e katërt, rikthimi në gjendjen normale (riaftësimi), përfshin përpjekjet e komunitetit dhe banorëve për t'u kthyer në normalitet. Me riaftësim do të kuptojmë masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme në rajonin (territorin) e prekur nga fatkeqësia.

Për menaxhimin me sukses të emergjencave civile është mjaft i rëndësishëm krijimi i shumë lidhjeve të drejtpërdrejta midis aktiviteteve të strukturave dhe institucioneve pjesëmarrëse, si në etapat e një faze, ashtu dhe gjatë katër fazave të ciklit të emergjencave. Për arritjen e këtij qëllimi, çështjet e parandalimit dhe të lehtësimit nuk janë të lidhura vetëm me përgatitjen dhe mbrojtjen, përgjigjen e menjëhershme ndaj situatave të emergjencave civile, por edhe me çështjet kyç të fazës së rikthimit në gjendjen normale⁶⁹.

Faza e rikthimit në gjendjen normale është një mundësi për të riparë dhe për të vlerësuar shkaqet dhe mënyrat e reagimit ndaj një situatë emergjence. Kjo është periudha më e mirë për të ndërmarrë aktivitete lehtësimi, paralelisht me aktivitetet e rehabilitimit dhe të rindërtimit dhe shpesh është koha kur disponohen burimet e nevojshme për të investuar në masat parandaluese dhe lehtësuese, gjë e cila nuk do të mund të bëhej gjatë kohës së emergjencës⁷⁰.

Vetëm duke i vlerësuar e trajtuar në mënyrë të ndërthurur aktivitetet e të gjitha fazave e ciklit të emergjencave do të arrijmë të kemi një qasje proaktive, një menaxhim të suksesshëm të fatkeqësive natyrore dhe komunitete më të sigurta e të mbrojtura nga rreziku i tyre.

Në përfundim mund të konkludojmë se me qëllim forcimin e sigurisë në komunitet, ligjvënësit kanë pajisur strukturat e pushtetit vendor me kompetenca të rëndësishme në fushën e sigurisë publike, konkretisht me mbrojtjen civile dhe menaxhimin emergjence, duke synuar një qasje proaktive dhe joreaktive në trajtimin e fatkeqësive natyrore. Është përgjegjësi e këtyre strukturave hartimi, miratimi dhe testimi e planit të menaxhimit të emergjencave; ngritja dhe funksionimi në vazhdimësi i strukturave vendore për përballimin e emergjencave; kryerja e vlerësimit të rrezikut nga kërcënimet e mundshme të komunitetit; kryerja e trajnimeve të menaxhimit të emergjencave civile, hartimi i programeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit për komunitetin si dhe menaxhimi dhe vendimmarrja gjatë një situatë emergjente.

6. Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet

Siguria e komunitetit është e lidhur me menaxhimin sa më të mirë të emergjencave dhe përfshirja e komunitetit në këtë menaxhim ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë së tij. Masat parandaluese ndaj fatkeqësive natyrore janë më efektive kur ato përfshijnë pjesëmarrje në të gjitha nivelet, nga komuniteti lokal e deri qeverinë qendrore

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

⁶⁸ Operacionet e ndërmarrja në këtë fazë janë veprimet e forcave dhe të mjeteve, për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.

⁶⁹ Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), Miratuar me VKM nr. 835, dt. 3 Dhjetor 2004, f.21.

⁷⁰ Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), Miratuar me VKM nr. 835, dt. 3 dhjetor 2004, f. 21.

⁷⁰ Po aty.

e në nivele rajonale e ndërkombëtare.

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore është qëllimi ndërsa strategjia kryesore për arritjen e këtij qëllimi është që rritja e kapaciteteve dhe burimeve të grupeve më të cenueshme⁷¹ të komunitetit, për të reduktuar cenueshmërinë e tyre dhe për të shmangur ndodhjen e fatkeqësive në të ardhmen.

Përfshirja e komunitetit është thelbësore në këtë proces pasi askush nuk mund të kuptojë mundësitë dhe kufizimet lokale më mirë se vetë komunitetet lokale të cilët duhet të përfshihen në identifikimin dhe zgjidhjen e çështjet e cenueshmërisë nga fatkeqësitë. Askush nuk është më i interesuar të kuptojë çështjet lokale sesa komuniteti, mbijetesa dhe mirëqenia e të cilit është në rrezik. Prandaj, informacioni duhet të gjenerohet në një mënyrë dhe gjuhë që kuptohet nga komuniteti. Ka prova në rritje për të treguar se menaxhimi i shumicës së fatkeqësive nga lart-poshtë nuk arrijnë të adresojnë specifikat e nevojave lokale të komuniteteve të pafuqishme, injorojnë potencialin e burimet dhe kapacitetet lokale, dhe në disa raste mund edhe rrisin cenueshmërinë e njerëzve. Për këtë, vetë njerëzit e cenueshëm duhet të përfshihen në planifikimin dhe zbatimin e masave për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë së bashku me subjektet lokale, krahinore dhe kombëtare përmes partneritetit⁷².

Menaxhimi i fatkeqësive është një çështje urgjente për të gjithë ne dhe duhet të realizohet me një bazë sa më gjithëpërfshirëse. Kjo kërkon që komunitetet në rrezik të angazhohen në të gjitha fazat e menaxhimit të fatkeqësive nga parandalimi, zbutja, gatishmëria, përgjigja dhe rikuperim⁷³.

Pas vitit 1980 ka ndryshuar fokusi në mbrojtjen civile dhe menaxhimin e fatkeqësive duke përfshirë sa më shumë komunitet në këtë proces, sepse ata janë më të prekurit në këtë mes. Për këtë komunitetet duhet të bëhen më rezistues ndaj fatkeqësive natyrore dhe kjo arrihet, ndërmjet të tjerave, edhe me rritjen e nivelit të njohurive të tyre për trajtimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore.

Menaxhimi i emergjencave duke u bazuar në komunitet mund të përkufizohet si procese gjithëpërfshirës, aktiv dhe në pronësi të drejtuar nga komuniteti që synojnë adresimin e nxitësve të krijimit të rrezikut nga fatkeqësitë; zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë; dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë shoqërore, brenda kontekstit të njohurive dhe mençurisë lokale dhe vendase. Kjo nënkupton përfshirjen e drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme të komuniteteve në rrezik në procesin e vendimmarrjes për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Ai supozon se njohuritë lokale dhe vendase janë të ngjashme me njohuritë shkencore dhe duhet të respektohen⁷⁴. Në qendër të këtij koncepti është fakti se duhet të gjenden zgjidhje relevante në nivel lokal dhe se këto zgjidhje të jenë pjesë e procesit të zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit.

Në rast fatkeqësish, njerëzit në nivel komuniteti kanë më shumë për të humbur sepse janë ata të goditur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë, qofshin ato të mëdha apo të vogla. Ata janë të parët që bëhen të ndjeshëm ndaj efekteve të ngjarjeve të tilla të rrezikshme. Nga ana tjetër, ata kanë më shumë për të fituar nëse mund të zvogëlojnë

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

⁷¹ "Cenueshmëri" janë, kushtet e përcaktuara nga faktorë apo procese fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, të cilat rrisin ndjeshmërinë e një individi, komuniteti, pasurie apo rrjeti shërbimesh ndaj impakteve të rreziqeve.

⁷² Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p. 12.

⁷³ Bishnu Pandey and Kenji Okazaki: Community Based Disaster Management: Empowering Communities to Cope with Disaster Risks, United Nations Centre for Regional Development, Japan. f. 1.

⁷⁴ Dewald Van Niekerk, Livhuwani Nemakonde, Leandri Kruger and Kyla Genade: Community-based Disaster Risk Management, f. 5.

ndikimin e fatkeqësive në komunitetin e tyre. Ky koncept lindi idenë e menaxhimit të fatkeqësive të bazuara në komunitet, ku komunitetet vihen në ballë⁷⁵. Një element kritik i menaxhimi i qëndrueshëm i fatkeqësive është pjesëmarrja e komuniteteve në këto aktivitete. Më së shumti elementet e përbashkëta të përfshirjes së komunitetit janë partneriteti, pjesëmarrja, fuqizimi dhe pronësi nga banorët vendas. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve të bazuara në komunitet, njerëzit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë së bashku me grupin e zyrtarëve qeveritarë dhe ekspertëve si palë të drejtpërdrejta të interesit të këtyre aktiviteteve. Fatkeqësitë ndihen në nivel komuniteti edhe pse mund të godasin një ose disa bashkësi njëherësh. Duke qenë në ballë, komunitetet duhet të kenë aftësi për t'iu përgjigjur vetë kërcënimeve. Është kjo arsyeja që komunitetet duhet të jenë të përfshirë në menaxhimin e rreziqeve që mund të kërcënojnë mirëqenien e tyre⁷⁶.

Menaxhimi i rrezikut të fatkeqësive i bazuar në komunitet është procesi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në të cilin komunitetet në rrezik janë të angazhuar në mënyrë aktive në identifikimin, analizën, trajtimin, monitorimin dhe vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë me qëllim reduktimin e dobësive dhe rritjen e kapaciteteve të tyre. Kjo do të thotë se njerëzit janë në qendër të vendimmarrjes dhe zbatimit të aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë⁷⁷. Gjithashtu, në rast të një fatkeqësie, komunitetet lokale mbeten linja e parë e mbrojtjes, ose reaguesit e parë ndaj një incidenti. Kërkimet kanë treguar se nismat për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë nga lart-poshtë shpesh dështojnë të adresojë nevojat e komuniteteve të pafuqishme dhe në rrezik. Për këtë është e nevojshme fuqizimi i komuniteteve në rrezik përmes pronësisë në identifikimin dhe adresimin e rreziqeve dhe dobësive të tyre, bazuar në elementet⁷⁸ e mëposhtëm:

ekzistenca e një komiteti lokal apo organizate për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive; harta e rrezikut, cënueshmërisë dhe kapacitetet/burimet e komunitetit; një plan për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në komunitet; trajnim për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe sistemet e mësimi të komunitetit; simulime dhe ushtrime të rregullta të komunitetit; sistemi(et) e paralajmërimit të hershëm; një fond për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Procesi i menaxhimi të emergjencave duke u bazuar në komunitet duhet të çojë në përmirësime progresive në sigurinë publike dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj fatkeqësive. Ky proces, sipas autorëve Imelda Abarquez dhe Zubair Murshed, përbëhet nga shtatë faza⁷⁹ dhe konkretisht:

Faza e parë: përzgjedhja e komunitetit. Kjo fazë synon identifikimin dhe përzgjedhjen e komuniteteve vulnerabël. Për ta bërë këtë, vlerësohen një grup kriteresh të përzgjedhura⁸⁰, të cilat ndryshojnë sipas komuniteteve.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

⁷⁵ Bishnu Pandey and Kenji Okazaki: Community Based Disaster Management: Empowering Communities to Cope with Disaster Risks, United Nations Centre for Regional Development, Japan. f. 4.

⁷⁶ Bishnu Pandey and Kenji Okazaki: Community Based Disaster Management: Empowering Communities to Cope with Disaster Risks, United Nations Centre for Regional Development, Japan. f. 2-3.

⁷⁷ Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p.9.

⁷⁸ Dewald Van Niekerk, Livhuwani Nemakonde, Leandri Kruger and Kylah Genade: Community-based Disaster Risk Management, f.6.

⁷⁹ Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p.16-17.

⁸⁰ Kriteresh të përzgjedhura: ashpërsia e cënueshmërisë së komunitetit; gatishmërinë e komunitetit për t'u angazhuar në këtë proces; disponueshmëria dhe aksesueshmëria e komunitetit; numri i njerëzve që do të përfitojnë nga procesi; prioriteti i qeverive për dobësitë socio-ekonomike dhe fizike; disponueshmëria e burimeve; dhe një buxhet për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Këto kriteret do të ndryshojnë për çdo komunitet të caktuar. Studiuesit mund të marrin vendime bazuar në këto kriteret të dhëna dhe nëpërmjet përdorimit të një sondazhi të zgjedhin komunitetin më të përshtatshëm për të marrë pjesë në këtë proces.

Faza dytë: ndërtimi i raporteve dhe mirëkuptimi i komunitetit. Një marrëdhënie e ndërtuar mbi besimin do të inkurajojë komunitetin të ndajë çështjet, shqetësimet, sfidat, idetë dhe zgjidhjet e tyre. Për të kuptuar komunitetin e përzgjedhur, duhet të ndërtohet një raport me komunitetin, i cili është një komponent thelbësor i procesit të menaxhimit të fatkeqësive duke u bazuar në komunitet⁸¹.

Faza tretë: vlerësimi me pjesëmarrje i rrezikut nga fatkeqësitë. Ky është një proces diagnostikimi për të identifikuar rreziqet me të cilat përballet komuniteti dhe si njerëzit i kapërcejnë këto rreziqe. Procesi përfshin vlerësimi i rrezikut, vlerësimi i cenueshmërisë dhe vlerësimin e kapaciteteve. Në bërjen e vlerësimeve merret parasysh perceptimi i njerëzve për rrezikun. Të gjithë palët e interesuara, duke përfshirë komunitetin e përzgjedhur, duhet të marrin pjesë aktive në këtë fazë të procesit për të mbledhur dhe analizuar informacionin e rrezikut nga fatkeqësitë⁸².

Faza e katërt: planifikimi i menaxhimit me pjesëmarrje të rrezikut nga fatkeqësitë i bazuar në komunitet. Kjo vijon pas analizës së rezultateve të vlerësimit me pjesëmarrje i rrezikut nga fatkeqësitë. Vetë njerëzit identifikojnë masat për reduktimin e rrezikut që do të zvogëlojë dobësitë dhe do të rrisin kapacitetet. Këto masa të reduktimit të rrezikut përkthehen më pas në një plan të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në komunitet. Planifikimi fillon me dëshirën për të ndryshuar kushtet ekzistuese të padëshirueshme. Planifikimi i veprimit për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë fillon me një aspiratë për sigurinë për veten, familjen dhe komunitetin⁸³.

Faza 5: ndërtimi dhe trajnimi i një organizate komunitare për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive. Rreziqet e fatkeqësive menaxhohen më mirë nga organizata komunitare që do të sigurojë reduktimin e rreziqeve përmes zbatimit të planit. Prandaj është e

⁸¹ Autorët Dewald Van Niekerk, Livhuwani Nemakonde, Leandri Kruger and Kylah Genade: Community-based Disaster Risk Management, p. 8 shprehen se, pasi të zgjidhet komuniteti, faza e dytë do të jetë ndërtimi i një marrëdhënieje me komunitetin e përzgjedhur dhe krijimi i besimit. Të kuptuarit e zhvillimit dhe kontekstit të një komuniteti përfshin elementët bazë të mëposhtëm: karakteristikat hapësinore (vendndodhja e shtëpive, objekteve dhe burimeve si spitalet, sallat e komunitetit dhe stacionet e zjarrfikësve); cenueshmëria e familjeve dhe mjetet e tyre të jetesës; grupet sociale (duke përfshirë racën, gjininë, klasën, gjuhën dhe përkatësinë etnike); rregullimet kulturore si hierarkitë; dhe aktivitetet ekonomike që ndikojnë në jetesën e komunitetit. Mund të kryhen veprime të ndryshme për të krijuar besim me komunitetin e zgjedhur. Këto veprime mund të përfshijnë: jetesën mes anëtarëve të komunitetit dhe pjesëmarrjen në detyrat e përditshme të komunitetit; ji një dëgjues i mirë që është i hapur ndaj ndryshimeve; dhe për të mësuar nga komuniteti lokal. Në kryerjen e këtyre veprimeve studiuesi duhet të ketë parasysh gjithashtu se duhet të tregohet gjithmonë përulësi, respekt, durim, interes, besim dhe të mos jetë gjykyes. Këto karakteristika të sjelljes do të sigurojnë dhe krijojnë marrëdhënie të besueshme me komunitetin e përzgjedhur, gjë që është çelësi i suksesit të këtij procesi.

⁸² Për këtë fazë, autorët Dewald Van Niekerk, Livhuwani Nemakonde, Leandri Kruger and Kylah Genade: Community-based Disaster Risk Management, p.9 shprehen se kjo fazë do t'i mundësojë komunitetit dhe autoriteteve vendore të planifikojnë dhe të përgatiten më mirë për ngjarjet negative që mund të ndikojnë në komunitetin e cenueshëm. Kjo përbën bazën e fazës së planifikimit (Faza 4). Prandaj, kjo fazë përfshin kryerjen e vlerësimeve të rrezikut, cenueshmërisë dhe kapacitetit. Për shkak të aftësive të specializuara të kërkuara, individë me njohuri do të kryejnë kryesisht këto vlerësime, megjithatë përfshirja dhe pjesëmarrja aktive e komunitetit lokal është çelësi i suksesit të kësaj faze. Kjo fazë në vetvete përfshin shtatë hapa të ngjashëm me një proces vlerësimi të rrezikut nga fatkeqësitë. Këta hapa përfshijnë: përshkrimin e rreziqeve; harta e rreziqeve; vlerësimi i cenueshmërisë; vlerësimi i rrezikut; priorizimi i rreziqeve; përcaktimi i niveleve të rrezikut; dhe të vendosë për strategjitë/skenarët për veprime të mëtejshme. Kështu, kjo bazohet në besimin se komunitetet lokale mund dhe do të ndihmojnë veten dhe njëri-tjetrin në reduktimin dhe parandalimin e rreziqeve për të ndërtuar elasticitetin e tyre dhe për të siguruar qëndrueshmëri.

⁸³ Autorët Dewald Van Niekerk, Livhuwani Nemakonde, Leandri Kruger and Kylah Genade: Community-based Disaster Risk Management, p.8 shprehen se si qeveria (në formën e autoriteteve vendore) ashtu edhe komuniteti i përzgjedhur janë të përfshirë në këtë fazë, duke identifikuar në mënyrë aktive masat e reduktimit të rrezikut për të rritur aftësitë dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve dhe për të zvogëluar dobësitë e tyre. Autoritetet vendore dhe komuniteti do të përfshihen në përkthimin e masave për reduktimin e rrezikut në një plan të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Planit do të përfshijë masa për reduktimin dhe transferimin e rrezikut, masat zbutëse, kërkesat për burime, objektivat që duhet të arrihen, asistencën teknike dhe ndërtimin e aftësive të komuniteteve.

domosdoshme që, nëse nuk ekziston, të ndërtohet një strukturë e tillë komunitare, dhe nëse ka një të tillë, të forcohet ajo. Trajnimi i drejtuesve dhe anëtarëve e organizatës për të ndërtuar kapacitetin e tyre është e rëndësishme. Objektivi i kësaj strukture është që t'u mundësojë komuniteteve të përgatiten më mirë për ngjarje të rrezikshme dhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë së komunitetit. Krijimi dhe trajnimi i një strukture të tillë do të ndihmojë dhe mundësojë zbatimin e aktiviteteve sipas planit të menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive dhe do të sigurojë që të arrihet objektivi për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet⁸⁴.

Faza e gjashtë: zbatimi i planit të menaxhimit nga komuniteti. Kjo fazë përfshin zbatimin e planit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë që u zhvillua në fazën e katërt të procesit. Kjo fazë drejtohet nga organizata (strukture) komunitare për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive me ndihmën e autoriteteve vendore. Kështu, kjo strukturë do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm të aktiviteteve për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, ndërkohë që autoritetet lokale marrin rolin e një lehtësuesi, duke ndihmuar strukturën e ngritur në zbatimin e planit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Disa detyra të rrezikut nga fatkeqësitë kërkojnë aftësi dhe njohuri teknike të cilat mund të mos jenë të pranishme në komunitete dhe kështu kërkon përfshirjen e autoriteteve lokale⁸⁵.

Faza 7: monitorimi dhe vlerësimi, është faza e fundit dhe sfiduese në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet. Ecuria e planit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duhet të monitorohet pasi mund të shfaqen konflikte. Për këtë arsye, palët e interesuara në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktive në proces, të jenë të hapur për të mësuar nga të tjerët, të mësojnë të negociojnë për të adresuar nevojat e të gjitha palëve të interesuara dhe të jenë fleksibël ndaj rrethanave në ndryshim. Kjo fazë do të vlerësojë ecurinë e aktiviteteve, mënyrën në të cilën është kryer (monitorimi) dhe sa mirë këto aktivitete kanë arritur objektivat e planit të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë (vlerësimi). Për një monitorim dhe vlerësim të suksesshëm pjesëmarrës, nevojitet harmoni midis të gjithë aktorëve pjesëmarrës⁸⁶.

Në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet përfshihen shumë aktorë. Këta aktorë mund t'i ndajmë në dy kategori. Aktorë të brendshëm dhe aktorë të jashtëm.

Aktorët e brendshëm janë individët, organizatat dhe palët e interesuara që ndodhen brenda komunitetit. Përveç strukturës apo organizatës komunitare, e cila luan rol kryesor për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive, çdo individ, familje, organizatë, biznes dhe shërbimi publik brenda një komuniteti ka një rol për të luajtur në reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, pasi të gjitha ata do të prekeshin nga këto fatkeqësi. Struktura apo organizata komunitare, e cila luan rolin kryesor për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive duhet të mobilizojë burrat, gratë, fermerët, peshkatarët, punëtorët, të rinjtë dhe njerëz të tjerë me nevoja të veçanta për të zbatuar një mori veprimesh.

Në aktorët e jashtëm përfshihen struktura, sektorë dhe agjenci, departamente qeveritare, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare, sektori privat dhe të tjera jashtë agjencive, të cilat ndodhen jashtë komunitetit, por që duan të reduktohet cenueshmëria

⁸⁴ Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p.66.

⁸⁵ Dewald Van Niekerk, Livhuwani Nemaconde, Leandri Kruger and Kylah Genade: Community-based Disaster Risk Management, p. 10-11.

⁸⁶ Po aty, f. 11.

e komunitetit dhe të rriten kapacitetet e tij për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive. Roli i tyre është të mbështesin përpjekjet e komunitetit duke reduktuar dobësitë e tyre dhe duke rritur kapacitetet për një periudhë afatgjatë. Ata mund ta bëjnë këtë duke ofruar teknike, mbështetje materiale, financiare dhe politike. Agjencitë e jashtme mund të iniciojnë procesin si pjesë e agjendës së tyre ose komuniteti mund t'i kontaktojë ata për të marrë mbështetje. Burimet e bollshme financiare, ekspertiza teknike dhe ndikimi politik i agjencive të jashtme mund t'i vendosë ato në një pozitë dominuese⁸⁷.

Me qëllim të vendosjes së marrëdhënieve të punës, struktura apo organizata komunitare, e cila luan rol kryesor për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive, duhet të njohë perceptimet, interesat e ndryshme, metodologjitë dhe për të lehtësuar një konsensus të gjerë mbi objektivat, strategjitë dhe metodologjitë ndërmjet aktorëve të shumtë në komunitet.

Në përfundim mund të konkludojmë se siguria e komunitetit është e lidhur me menaxhimin sa më të mirë të emergjencave dhe përfshirja e komunitetit në këtë menaxhim ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë së tij. Procesi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet çon në përmirësime progresive në sigurinë publike dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj fatkeqësive.

7. Perceptimet e qytetarëve për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive duke u bazuar në komunitet

Por, çfarë mendojnë qytetarët për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive duke u bazuar në komunitet dhe shkallën e përgatitjes së tyre për t'u përballur me këto fatkeqësi. Në funksion të këtij procesi, fillimisht është e nevojshme matja dhe vlerësimi i perceptimit të tyre për nivelin e rrezikut e të kërcënimit nga fenomenet ekstreme të natyrës, për nivelin e njohurive që ata kanë për këto fenomene, për përgjegjësitë tyre në situata të tilla, nevojën për edukimin dhe ndërgjegjësimin e tyre si dhe nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin që ata kanë për strukturat që menaxhojnë rrezikun nga fatkeqësitë natyrore. Këto matje të perceptimit të komunitetit janë siguruar nëpërmjet një anketimi të gjerë, të zhvilluar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë, në 12 qarqe të vendit, gjatë muajve janar-mars 2022, realizuar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë. Procesi i anketimit u zhvillua në platformën "google forms". Gjetjet dhe përfundimet rreth këtyre perceptimeve janë si më poshtë:

7.1. Të dhëna të përgjithshme të anketimit

Të ndarë sipas gjinisë, në paraqitje tabelore dhe grafike, pjesëmarrësit në anketim janë si më poshtë.

1. Ndarja gjinore e pjesëmarrësve në anketim.


Nga analiza e të dhënave të mësipërme, tabelore dhe grafike gjejmë se:

- meshkujt përbëjnë 55% të anketuarve,
- femrat përbëjnë 45% të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme mund të konkludojmë se pjesa më e madhe e të anketuarve

⁸⁷ Imelda Abarquez and Zubair Murshed: Community-Based Disaster Risk Management, Asian Disaster Preparedness Center (ADPC), P.O. Box 4, ADPC 2004, p. 18.

(55%) janë të gjinisë mashkullore.




2. Moshë e të anketuarve

Të ndarë sipas grup moshave, në paraqitje tabelore dhe grafike, pjesëmarrësit në anketim janë si më poshtë.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, lidhur me moshën e pjesëmarrësve në anketim, gjejmë se pjesëmarrësit sipas grupmoshave, në raport me totalin e pjesëmarrësve, në përqindje, janë si më poshtë:

- 18-23 vjeç përbëjnë 11.3%,
- 24-27 vjeç përbëjnë 9.3%,
- 28-30 vjeç përbëjnë 9.4%,
- 31-35 vjeç përbëjnë 11.3%,
- 36-40 vjeç përbëjnë 10.7%,
- 41-45 vjeç përbëjnë 9.3%,
- 46-50 vjeç përbëjnë 8.4%,
- 51-55 vjeç përbëjnë 8%,
- 56-60 vjeç përbëjnë 10.1%,
- 61-65 vjeç përbëjnë 5.2%,
- mbi 65 vjeç përbëjnë 7%.

Nga gjetjet e mësipërme mund të konkludojmë se numri më i madh i pjesëmarrësve në këtë anketim i përket grup moshave të reja 18-23 vjeç (11.3%) dhe 31-35 vjeç (11.3%). Kjo tregon për një interesim më të madh të grupmoshave të reja për çështjet e fatkeqësive natyrore.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


3. Niveli arsimor i të anketuarve

Niveli arsimor i pjesëmarrësve në anketim, në paraqitje tabelore dhe grafike është si më poshtë.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, lidhur me nivelin arsimor të pjesëmarrësve në anketim, gjejmë se pjesëmarrësit sipas nivelit arsimor, në raport me totalin e pjesëmarrësve, në përqindje, janë si më poshtë:

- me arsim 8/9 vjeçar janë 18.7%;
- me arsim të mesëm janë 27.7% të totalit të anketuarve;
- me arsim të lartë janë 33.3% të totalit të anketuarve;
- me arsim të mesëm profesional janë 11.4% të totalit të anketuarve;
- pa arsim janë 3.5% të totalit të anketuarve;
- me arsim pasuniversitar janë 5.3% të totalit të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me nivelin arsimor të pjesëmarrësve në anketim, mund të konkludojmë për një pjesëmarrje aktive të personave me të gjithë nivelet e shkollimit. Kjo flet për një ndjeshmëri të tyre rreth fenomeneve ekstreme të natyrës dhe pasojave që vijnë prej tyre, por ata që dominojnë më shumë janë të anketuarit me arsim të mesëm (39.1%) dhe më pas ata me arsim të lartë (33.3%).



4. Sektori i punësimit i të anketuarve

Sipas profesioneve, pjesëmarrësit në anketim, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga analiza e të dhënave të mësipërme lidhur me profesionin e pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:


- në anketim kanë marrë pjesë qytetarë që përfaqësojnë një larmi sektorësh punësimi si i/e vetëpunësuar; sektori privat; sektori publik; të papunësuar;
- të papunësuarit përbëjnë 34.2% të totalit të anketuarve;
- të vetëpunësuar përbëjnë 19.8% të totalit të anketuarëve;
- të punësuarit në sektorin privat përbëjnë 24.3% të totalit të anketuarve;
- të punësuarit në sektorin publik përbëjnë 21.7% të totalit të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me sektorin e punësimit të pjesëmarrësve në anketim mund të arrijmë në përfundimin se pjesëmarrësit përfaqësojnë një

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

shumëllojshmëri sektorësh punësimi si dhe të papunësuarit, por kategoria që dominon janë të vetëpunësuarit dhe ata të punësuar në sektorin privat me gjithsej 54% (34.2%+ 19.8%). Kjo flet për një ndjeshmëri më të madhe të kësaj kategorie rreth fenomeneve ekstreme të natyrës dhe pasojave që vijnë prej tyre.




5. Shtrirja gjeografike e pjesëmarrësve në anketim

Sipas shtrirjes gjeografike, pjesëmarrësit në anketim, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Lidhur me shtrirjen gjeografike, nga analiza e të dhënave të mësipërme, të pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:

- numri më i madh i pjesëmarrësve në anketim ose 30.9% e totalit të pjesëmarrësve është nga qyteti i Tiranës;
- pas Tiranës, numri më i madh i pjesëmarrësve është nga qyteti i Durrësit dhe Elbasanit, me nga 9.8 % e totalit të pjesëmarrësve;
- numri më i vogël i pjesëmarrësve (1.8%) është nga Gjirokastra.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me shtrirjen gjeografike të pjesëmarrësve në anketim, mund të arrijmë në përfundimin se kjo pjesëmarrje është pothuajse nga i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë. Të anketuarit nga Tirana, Durrësi dhe Elbasani, përbëjnë numrin më të madh në totalin e të anketuarve përkatësisht 30.9% dhe me nga 6.3%. Kjo mund të shpjegohet me problematikën dhe për pasojë dhe me ndjeshmërinë që ka në trekëndëshin Tiranë-Durrës-Elbasan për çështjet e fenomeneve ekstreme të natyrës si pandemitë, tërmetet, etj., si dhe faktin që në këto qytete janë qendrat me të mëdha universitare në vend.




6. Shtrirja urbane/rurale e pjesëmarrësve në anketim

Sipas shtrirjes gjeografike, pjesëmarrësit në anketim, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Lidhur me shtrirjen gjeografike, nga analiza e të dhënave të mësipërme, të pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:

- pjesëmarrësit nga fshati përbëjnë 20.8% të totalit të anketuarve;
- nga qyteti përbëjnë 76.8% të totalit;
- pa përgjigje përbëjnë 2.4% të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me shtrirjen gjeografike të pjesëmarrësve në anketim mund të arrijmë në përfundimin se pjesa më e madhe e të anketuarve (76.8%) janë nga qyteti dhe 20.8% janë nga fshati.



7.2. Pyetjet dhe përgjigjet e të anketuarve në paraqitje tabelore e grafike si dhe gjetjet e analizuara.

Në vijim, po paraqesim një vështrim analitik të zgjeruar të pyetjeve dhe përgjigjeve të anketuarve në paraqitje tabelore dhe grafike, me gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e detajuara:

Perceptimet e rrezikut nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore.

1. Perceptimi i rrezikut nga tërmetet.

Sa ndiheni të rrezikuar nga tërmetet në Shqipëri?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga tërmetet në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen: $\frac{1}{2}$ Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga tërmetet $\frac{1}{2}$, gjejmë se:

- 4.4% e totalit të anketuarve nuk ndihen aspak të rrezikuar;
- 22.5% ndihen pak të rrezikuar;
- 46.8% ndihen të rrezikuar;
- 19.7% ndihen shumë të rrezikuar;


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 6.6% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar;

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 73.1% e të anketuarve ndihen të rrezikuar, shumë dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga tërmetet në Shqipëri. Ndërkohë që 26.9% e të anketuarve ndihen pak dhe aspak të rrezikuar. Pra, tërmeti perceptohet si rrezik për sigurinë e rreth $\frac{3}{4}$ të anketuarve.

Krahasuar me një anketim të tillë, të zhvilluar në vitin 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen aspak dhe pak të rrezikuar nga tërmetet ka rënë nga 50.4% në 26.9%. Pra vetëm dy vite është ulur me 23.5% numri i atyre që ndihen pak apo aspak të rrezikuar nga tërmetet.



2. Perceptimi i rrezikut nga përmbytjet.


Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga përmbytjet?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga përmbytjet në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga përmbytjet, gjejmë se:

- 23.8% e totalit të anketuarve ndihen aspak të rrezikuar;
- 23.6% ndihen pak të rrezikuar;
- 35.7% ndihen të rrezikuar;
- 9.7% ndihen shumë të rrezikuar;
- 7.2% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (52.6%), ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga përmbytjet në Shqipëri, ndërkohë që 47.4% ndihen pak dhe aspak të rrezikuar. Pra, përmbytjet përbëjnë rrezik për sigurinë e më shumë se gjysmës të anketuarve.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen aspak dhe pak të rrezikuar ka rënë nga 78% e të anketuarve në 47.4%. Pra, në vetëm 2 vjet, është rritur me 30.6% ndjeshmëria ndaj rrezikut të përmbytjeve.




3. Perceptimi i rrezikut nga thatësitat e tej zgjatura.

Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga thatësitat e tej zgjatura?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga thatësitat e tej zgjatura në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen: Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga thatësitat e tej zgjatura?” rezultojnë se:

- 30.9% e totalit të anketuarve ndihen aspak të rrezikuar;
- 32.6% ndihen pak të rrezikuar;
- 27.3% ndihen të rrezikuar;
- 7.3% ndihen shumë të rrezikuar;
- 1.8% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (63.5%), ndihen pak dhe aspak të rrezikuar nga thatësitat e tej zgjatura në Shqipëri, ndërkohë që vetëm 36.4% ndihen shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Pra, thatësitat e tej zgjatura përbëjnë rrezik për sigurinë e 36.4% të të anketuarve. Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezultojnë se numri i të anketuarve që ndihen aspak dhe pak të rrezikuar ka rënë nga 80.4% e të anketuarve në 63.5%. Ndërkohë që numri i atyre që ndihen të rrezikuar është rritur nga 19.6% në 36.4%.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


4. Perceptimi i rrezikut nga uraganet/stuhitë.

Sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga uraganet/stuhitë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga uraganet/stuhitë në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri, nga uraganet/stuhitë, rezulton se:

- 58.6% e totalit të anketuarve ndihen aspak të rrezikuar;
- 19% ndihen pak të rrezikuar;
- 16.2 % ndihen të rrezikuar;
- 3.4% ndihen shumë të rrezikuar;
- 2.8% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 77.6% e tyre, ndihen pak dhe aspak të rrezikuar nga uraganet/stuhitë në Shqipëri, ndërkohë që 22.4% ndihen, të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Pra, uraganet/stuhitë përbëjnë rrezik për sigurinë e 22.4% të anketuarve. Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar nga uraganet/stuhitë në Shqipëri është dyfishuar, nga 11.3% në 22.4%. Pra, është rritur perceptimi edhe për uraganet e stuhitë si rrezik për sigurinë, ndonëse jo me përmasat e kërcënimeve të tjera.



5. Perceptimi i rrezikut nga zjarret.

Sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga zjarret?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga zjarret në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga zjarret, gjejmë se:

- 14.1% e totalit të anketuarve ndihen aspak të rrezikuar;

- 32.1% ndihen pak të rrezikuar;
- 35.2 % ndihen të rrezikuar;
- 14.2% ndihen shumë të rrezikuar;
- 4.5% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikua.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 53.9% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Ndërkohë 46.2% e tyre, ndihen pak dhe aspak të rrezikuar nga zjarret në Shqipëri. Pra, zjarret përbëjnë rrezik për sigurinë e 53.9% e të anketuarve.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar nga zjarret në Shqipëri nga 27.3% është rritur në 53.9% e të anketuarve. Pra, në dy vite është rritur dyfish perceptimi i rrezikut nga zjarret.



Perceptimi i rrezikut nga incidentet radioaktive.

6. Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga incidentet radioaktive?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga incidentet radioaktive, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga incidentet radioaktive, gjejmë se:

- 55.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndihen aspak të rrezikuar;
- 24.8% ndihen pak të rrezikuar;
- 15.8% ndihen të rrezikuar;
- 3.2% ndihen shumë të rrezikuar;
- 1.1% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (55.1) ndihen aspak të rrezikuar nga incidentet radioaktive, ndërkohë që 20.1% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se ka një rënie (4.6%) të numri i të anketuarve që ndihen aspak të rrezikuar nga incidentet radioaktive. Ndërkohë që ka

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

një rritje me 8.7% të atyre që ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar.




Perceptimi i rrezikut nga sulmet terroriste.

7. Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga sulmet terroriste?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga sulmet terroriste, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri, nga sulmet terroriste, gjejmë se:

- 47.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndihen aspak të rrezikuar;
- 22.5% ndihen pak të rrezikuar;
- 22.6% ndihen të rrezikuar;
- 5.5% ndihen shumë të rrezikuar;
- 1.8% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 47.5%, ndihen aspak të rrezikuar nga sulmet terroriste, ndërkohë që 29.9% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se ka një rritje të atyre që ndihen të rrezikuar (nga 13.6% në 29.9%) nga sulmet terroriste.



Perceptimi i rrezikut nga pandemitë/epidemitë.


8. Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga pandemitë/epidemitë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga pandemitë/epidemitë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri, nga pandemitë/epidemitë, na rezulton se:

- 4.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndihen aspak të rrezikuar;
- 12.9% ndihen pak të rrezikuar;
- 44.4% ndihen të rrezikuar;
- 23.3% ndihen shumë të rrezikuar;
- 15.2% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 82.9%, ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga pandemitë/epidemitë. Ndërkohë që vetëm 17% ndihen pak dhe aspak të rrezikuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020 ka një rënie nga 40.9% në 17% të tyre ndihen aspak dhe pak të rrezikuar dhe një rritje me 23.8% të atyre që perceptojnë një rritje rreziku nga pandemitë/epidemitë. Pra, në vetëm 2 vite ka një rritje me 23.8 % të perceptimit se pandemitë/epidemitë përbëjnë rrezik për sigurinë.



Perceptimi i rrezikut nga krimi mjedisor.

9. Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga krimi mjedisor?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga krimi mjedisor, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga krimi mjedisor, gjejmë se:

- 17.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndihen aspak të rrezikuar;

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 27% ndihen pak të rrezikuar;
- 38.5% ndihen të rrezikuar;
- 11.8% ndihen shumë të rrezikuar;
- 5.1% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 55.4%, janë përgjigjur se ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga krimi mjedisor. Ndërkohë që 17.6% nuk ndihen aspak të rrezikuar. Krahasuar me anketimin e vitit 2020 kemi një rritje prej rreth 5% (nga 50.1% në 55.4%) e të anketuarve që ndihen të rrezikuar nga krimi mjedisor. Pra, ka një rritje të perceptimit për krimin mjedisor si rrezik për sigurinë.



Perceptimi i rrezikut nga krimi i organizuar.


10. Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga krimi i organizuar?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga krimi i organizuar, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga krimi i organizuar, gjejmë se:

- 19.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndihen aspak të rrezikuar;
- 25.2% ndihen pak të rrezikuar;
- 36.1% ndihen të rrezikuar;
- 14.6% ndihen shumë të rrezikuar;
- 4.4% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 55.1% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga krimi i organizuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një ulje me 10% në kategorinë e të anketuarve që ndihen aspak apo pak të rrezikuar nga krimi i organizuar dhe një rritje me 10% në kategorinë e të anketuarve që ndihen të rrezikuar (të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar) nga krimi i organizuar. Pra, ka një rritje të perceptimit për rrezikun nga krimi i organizuar.




Perceptimi i rrezikut nga aksidentet automobilistike.

11. Sa ndiheni të rrezikuar në Shqipëri nga aksidentet automobilistike.

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa ndihen të rrezikuar nga aksidentet automobilistike, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndihen të rrezikuar në Shqipëri nga aksidentet automobilistike, gjejmë se:

- 4.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndihen aspak të rrezikuar;
- 11.1% ndihen pak të rrezikuar;
- 42.8% ndihen të rrezikuar;
- 24.3% ndihen shumë të rrezikuar;
- 17% ndihen jashtëzakonisht shumë të rrezikuar.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 84.1%, ndihen të rrezikuar (të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar) nga aksidentet automobilistike.


Krahasuar me anketimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një rënie me 23.2% në kategorinë e të anketuarve që ndihen pak dhe aspak të rrezikuar si dhe një rritje po me 23.2% në kategorinë e të anketuarve që ndihen të rrezikuar (të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar) nga aksidentet automobilistike. Pra, në dy vite ka një rritje me 23.3% të perceptimit të rrezikut për sigurinë nga aksidentet automobilistike.

7.2.1. Analizë krahasuese lidhur me perceptimin e nivelit të rrezikut për sigurinë nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë, në raport dhe me rreziqet e tjera.

Në mënyrë të përmblëdhur, lidhur me perceptimin e nivelit të rrezikut për sigurinë nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë, në raport dhe me rreziqet e tjera mund të konkludojmë se të anketuarit perceptojnë si rreziqe kryesore për sigurinë e jetën e tyre sipas renditjes së më poshtme me rend zbritës:


- aksidentet automobilistike në masën 84.1%;
- pandemitë/epidemitë, (82.9%);
- tërmetet (73.1%);
- krimi mjedisor (55.4%);
- krimi i organizuar (55.1%);
- zjarret (53.9%);
- përmytjet (52.6%);
- thatësirat e tejzgjatura (36.4%);
- sulmet terroriste (29.9%);
- uraganet/stuhitë (22.4%).

Në paraqitje grafike perceptimet e nivelit të rrezikut për sigurinë nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë, në raport dhe me rreziqet e tjera janë si më poshtë:



Nga gjetjet e mësipërme mund të konkludojmë se të anketuarit vlerësojnë si më të rrezikshme për sigurinë e tyre me rend zbritës pandemitë, tërmetet, zjarret, përmytjet, thatësitat e tejzgjatura, uraganet/stuhitë. Krahasuar me rreziqet e tjera, vetëm aksidentet automobilistike perceptohen si më të rrezikshme për sigurinë e të anketuarve se sa fatkeqësitë natyrore.

Në anketimin e kryer dy vite më parë, të dhënat në paraqitje grafike kanë qenë si më poshtë:



Krahasuar me anketimin e kryer dy vite më parë, mund të konkludojmë se, ndonëse është ruajtur renditja, ka një rritje të perceptimit të rrezikut për sigurinë pothuajse në të gjithë treguesit e mësipërm.

Kjo mund të shpjegohet me rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj rreziqeve që vijnë për sigurinë e tyre nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore; shtrirjen e anketimit në vitin 2022 “derë me derë” dhe në të 12 qarqet e vendit (anketimi i mëparshëm është bërë *online* ku 85.4% ishin nga qyteti dhe 80% në zonën Tiranë-Durrës); nivelin më të ulët arsimor të të anketuarve në vitin 2022, për pasojë më pak njohuri në këtë fushë (në vitin 2020 mbizotëronte arsimi i lartë, kurse në vitin 2022 shumica e të anketuarve janë me arsim të mesëm).

Perceptimi për dukuritë e fatkeqësive natyrore/emergjencat civile.

12. Vlerësoni pohimin e mëposhtëm: $\frac{1}{2}$ Sa dakord jeni, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje.

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa dakord janë që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë dukuri në rritje, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve se sa dakord janë, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje, gjejmë se:

- 2.4% e totalit të anketuarve janë aspak dakord;
- 20.1% janë pak dakord;
- 50.5% janë dakord;
- 25.5% janë shumë dakord;
- 0.6% nuk e dinë;
- 1% e totalit të anketuarve janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa dakord janë që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë dukuri në rritje, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (76%) janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje. Krahasuar me anketimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një rritje me 4.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë dakord me pohimin që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje.




Perceptimi mbi përgjegjësinë e menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjencat civile dhe nivelin e përgatitjeve për përballimin e tyre.

13. Vlerësoni pohimin e mëposhtëm: Fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë fenomene menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit.

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa dakord janë që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa dakord jeni, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit, gjejmë se:

- 5.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak dakord;
- 44.3% janë dakord;
- 2% nuk e dinë;
- 1% janë pa përgjigje;
- 23.5% janë pak dakord;
- 23.6% janë shumë dakord.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa dakord janë që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 67.9%, janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencave civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit. Krahësuar me anketimin e vitit 2020, edhe në vitin 2022, 67.9% janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencave civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit.



14. Vlerësoni pohimin e mëposhtëm: Jam i/e përgatitur, për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë.

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se a ndihen të përgatitur për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile që mund të ndodhë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa dakord jeni, me pohimin se jam i/e përgatitur, për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë, na rezulton se:


- 33.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak dakord;
- 35% janë pak dakord;
- 19.3% janë dakord;
- 6.8% janë shumë dakord;
- 3.7% nuk e dinë;
- 1.8% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa dakord jeni, me pohimin se jam i/e përgatitur, për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 35% janë pak dakord me pohimin, pra ndihen pjesërisht të përgatitur, ndërkohë që 33.5% nuk janë dakord me pohimin pra nuk janë përgatitur, për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë. Gjithashtu, vetëm 26.1% e të anketuarve janë dakord dhe shumë dakord me pohimin, pra vetëm 26.1% ndihen se janë të përgatitur për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Sa dakord jeni, me pohimet e mëposhtëme ; Jam i/e përgatitur, për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë.



Perceptimi mbi sa e ku duhet investuar për parandalimin/menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjencat civile.

15. Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në edukim në arsimin para universitar dhe universitar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa duhet investuar në fushën e edukimit në arsimin para universitar dhe universitar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa duhet investuar në fushën e edukimit në arsimin para universitar dhe universitar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile, gjejmë se:

- 3% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk duhet investuar
- për 28% duhet investuar deri diku;
- për 40.4 % duhet investuar mjaftueshëm;
- për 27.4% duhet investuar shumë;
- 1.3% e totalit nuk kanë dijeni.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa duhet investuar në fushën e edukimit në arsimin para universitar dhe universitar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile, mund të konkludojmë se për shumicën e të anketuarve me një përfaqësim prej 67.8%, duhet investuar mjaftueshëm dhe shumë në edukimin në arsimin para universitar dhe universitar për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile. Në anketimin e vitit 2020, në këto dy kategori janë përfshirë vetëm 20.9% e të anketuarve. Pra, për dy vite, ka një trefishim të numrit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar në fushën e edukimit në arsimin para universitar dhe universitar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile .


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »



16. Sipas mendimit tuaj për të përmirësuar sigurinë, sa duhet investuar në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e fatkeqësive natyrore/menaxhimin e emergjencave?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se për të përmirësuar sigurinë, sa duhet investuar në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e fatkeqësive natyrore/menaxhimin e emergjencave civile në komunitetet më shumë rrezikshmëri përfshirjeje nga një fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa duhet investuar në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e fatkeqësive natyrore/menaxhimin e emergjencave civile në komunitetet më shumë rrezikshmëri përfshirjeje nga një fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, për të përmirësuar sigurinë në raste të tilla, gjejmë se:



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 3% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se nuk duhet investuar;
- për 28% duhet investuar deri diku;
- për 32 % duhet investuar mjaftueshëm;
- për 35% duhet investuar shumë;
- 2% nuk kam dijeni.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të konkludojmë se për shumicën e të anketuarve (67.8%), mendojnë se për të përmirësuar sigurinë, duhet investuar mjaftueshëm dhe shumë në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e fatkeqësive natyrore/menaxhimin e emergjencave civile. Në anketimin e vitit 2020, në këto dy kategori janë përfshirë 72.3% e të anketuarve.

17. Sipas mendimit tuaj sa duhet investuar në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut të gjerë, për parandalimin e fatkeqësive natyrore/ menaxhimin e emergjencave?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa duhet investuar në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut të gjerë, për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa duhet investuar në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut të gjerë, për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 14.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se duhet investuar deri diku;
- për 50.6% duhet investuar mjaftueshëm;
- për 31.2% duhet investuar shumë;
- për 1.4% nuk duhet investuar;
- 2.3% nuk kanë dijeni.



Nga kjo e dhënë, gjetja kryesore na rezulton të jetë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 81.8% e të anketuarve, janë përgjigjur se duhet investuar mjaftueshëm dhe shumë në fushatat dhe takimet ndërgjegjëse të publikut të gjerë për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore.


Në anketimin e vitit 2020, në këto dy kategori janë përfshirë 67.9% e të anketuarve. Pra, ka një rritje me 13.9% të vlerësimit se për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore, duhet investuar në fushatat dhe takimet ndërgjegjëse të publikut.

18. Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, me qëllim parandalimin e tyre?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa duhet investuar në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, me qëllim parandalimin e tyre, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa duhet investuar në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla, gjejmë se:

- 6.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur duhet investuar deri diku;
- 47.5% duhet investuar mjaftueshëm;
- 41.4% duhet investuar shumë;
- 1.5% nuk duhet investuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa duhet investuar në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, me qëllim parandalimin e tyre, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve 95.4% mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në këtë fushë. Krahasuar me dy vite më parë, ka një rritje me 3.5% në grupit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, me qëllim parandalimin e tyre.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

19. Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile ?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa duhet investuar në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa duhet investuar në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 7.3% e totalit të anketuarve janë përgjigjur duhet investuar deri diku;
- për 45.4% duhet investuar mjaftueshëm;
- për 42.6% duhet investuar shumë;
- për 2.8% nuk duhet investuar;
- 1.8% nuk kam dijeni.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa duhet investuar në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve 95.3% mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në këtë fushë.

Krahasuar me dy vite me parë, ka një rritje me 3.5% në grupit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla.

Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile ?




20. Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile me qëllim për të përmirësuar sigurinë në raste të tilla.

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa duhet investuar në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa duhet investuar në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla, gjejmë se:

- 5.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur duhet investuar deri diku;
- për 36.8% duhet investuar mjaftueshëm;
- për 52.5% duhet investuar shumë;
- për 3.2% nuk duhet investuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjet se sa duhet investuar në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve 94.8% mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në këtë fushë.

Krahasuar me dy vite më parë, ka një rritje me 1.7% në grupit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për të përmirësuar sigurinë në raste të tilla.




AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

7.2.2. Analizë krahasuese lidhur me perceptimin se sa e ku duhet investuar për parandalimin/menaxhimin të fatkeqësive natyrore/emergjencat civile.

Në mënyrë të përmblodhur, perceptimet e të anketuarve për pyetjen se sa e ku duhet investuar për parandalimin/menaxhimin të fatkeqësive natyrore/emergjencat civile, në paraqitje tabelore e grafike janë si më poshtë:

Në ligjet dhe politikat mbi përpalljen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile	95,40%
Në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile	95,30%
Në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur	94,80%
Në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut të gjerë	81,80%
Në edukimin në arsimin para universitar dhe universitar	67,80%
Në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e tyre	67%



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


Nga studimi i të dhënave të mësipërme gjejmë se të anketuarit mendojnë se për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile duhet investuar:

- në ligjet dhe politikat mbi përpalljen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile (95.4%);
- në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile (95.3%);
- në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me to (94.8%);
- në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut të gjerë (81.8%);
- në edukimin në arsimin para universitar dhe universitar (67.8%);
- në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e tyre (67%).

Nga gjetjet e mësipërme mund të konkludojmë se të anketuarit vlerësojnë se për të

përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile duhet investuar më shumë në ligjet dhe politikat mbi përpalljen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile dhe në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur to.

Në anketimin e kryer dy vite më parë, vlerat e fushave ku duhet investuar më shumë për përmirësimin e sigurisë në paraqitje grafike kanë qenë si më poshtë:



Krahasuar me anketimin e kryer dy vite më parë, mund të konkludojmë se, ndonëse është ruajtur renditja, ka një rritje të ndjeshme treguesve për drejtimitet e mësipërme të investimeve për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Matja e nivelit të informimit mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile si dhe përgjegjësitë individuale në raste të tilla.

21. Jepni vlerësimin tuaj për pohimet e mëposhtme: Kam informacion të plotë dhe të hollësishëm mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile.

Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se kanë informacion të plotë dhe të hollësishëm mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pohimin se kanë informacion të plotë dhe të hollësishëm mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 35.3% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk jam aspak dakord me pohimin;
- 21.2% janë deri diku dakord me pohimin;
- 37.3% janë pak dakord me pohimin;
- 4.2% janë dakord me pohimin;
- 2% janë shumë dakord me pohimin.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pohimin se kanë informacion të plotë dhe të hollësishëm mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 37.3%, janë pak dakord me pohimin, pra nuk janë të sigurt për këtë. Ndërkohë 35.3 nuk janë aspak dakord me pohimin, që do të thotë se nuk kanë informacion të plotë për këtë çështje. Kjo shifër është 24.5% më e lartë se dy vite më parë. Ndërkohë, vetëm 6.2%, janë dakord dhe shumë dakord me pohimin, pra që kanë informacion të plotë çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në këtë fushë. Në anketimin e dy viteve më parë kjo kategori përfaqësonte 36.2% të të anketuarve, pra ka një rënie prej 30%.



22. Jepni vlerësimin tuaj për pohimet e mëposhtme: Jam i/e mirëinformuar për çdo mekanizëm të sigurisë publike, që duhet të aktivizohet në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se janë të mirë informuar për çdo mekanizëm të sigurisë publike, që duhet të aktivizohen në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pohimin se janë të mirë informuar për çdo mekanizëm të sigurisë publike, që duhet të aktivizohet në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, gjejmë se:

- 37.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk jam aspak dakord me pohimin;
- 18.8% janë deri diku dakord me pohimin;

- 35.7% janë pak dakord me pohimin;
- 6% janë dakord me pohimin;
- 2% janë shumë dakord me pohimin.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pohimin se janë të mirë informuar për çdo mekanizëm të sigurisë publike, që duhet të aktivizohet në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve 37.4% nuk janë aspak dakord me pohimin, që do të thotë se nuk kanë aspak informacion për mekanizmat e sigurisë publike, që duhet të aktivizohen në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, shifër kjo me 22.5% më e lartë se dy vite më parë për këtë kategori të anketuarish. Dakord dhe shumë dakord me pohimin janë 8 % e të anketuarve, shifër kjo 23.9% më e vogël se dy vite më parë.

Pra, ka një rritje të ndjeshme të shifrave të atyre që nuk janë të informuar për mekanizmat e sigurisë publike, që duhet të aktivizohet në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.



23. Jepni vlerësimin tuaj për pohimet e mëposhtme: Në rast të fatkeqësive natyrore, mendoj se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi, më tej nga shteti.


Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se në rast të fatkeqësive natyrore, mendojnë se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus, kryesisht, nga vetë individi e, më tej, nga shteti, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pohimin se në rast të fatkeqësive natyrore, mendojnë se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi, më tej nga shteti, gjejmë se:

- 18.3% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk janë aspak dakord me pohimin;
- 28% janë deri diku dakord me pohimin;
- 34.2% janë pak dakord me pohimin;
- 12.8% janë dakord me pohimin;
- 6.8% janë shumë dakord me pohimin.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pohimin se në rast të fatkeqësive natyrore, mendojnë se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi, më tej nga shteti, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (34.2%) janë pak dakord me pohimin, shifër kjo 27.1% më e madhe se dy vite më parë. Ndërsa 18.3% nuk janë aspak dakord me pohimin, shifër kjo dy herë më e madhe se dy vite më parë. Dakord dhe shumë dakord me pohimin kanë qenë 19.6% e të anketuarve ose 38.1% më pak se dy vite më parë. Pra, shumica e të anketuarve nuk mendojnë se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi e më tej nga shteti. Pra, edhe sigurinë e tyre individuale e presin nga shteti.




24. Jepni vlerësimin tuaj për pohimet e mëposhtme: Shteti, duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikasë të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Përgjigjet e të anketuarve për pohimin se shteti, duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikasë të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pohimin se shteti duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikasë të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 5.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk janë aspak dakord me pohimin;
- 35.2% janë deri diku dakord me pohimin;
- 21.4% janë pak dakord me pohimin;
- 20.8% janë dakord me pohimin;
- 16.9% janë shumë dakord me pohimin.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pohimin se shteti duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikasë të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve 37.7% janë dakord dhe shumë dakord me pohimin e mësipërm, ndonëse krahasuar me dy vite më parë kjo kategori e të anketuarve ka shënuar një rënie me 41.8%. Vetëm 5.8% nuk

janë aspak apo janë pak dakord me pohimin. Pra, pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë dhe pohojnë se shteti duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikasë të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.



25. Sipas jush, cili është burimi më i mirë për informim në komunitetin tuaj, lidhur me një katastrofë dhe/ose situatë emergjente?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se cili është burimi më i mirë për informim në komunitetin e tyre, lidhur me një katastrofë dhe/ose situatë emergjente, në paraqitje grafike është si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është burimi më i mirë për informim në komunitetin e tyre, lidhur me një katastrofë dhe/ose situatë emergjente, gjejmë se:

- për 26.2% burimi më i mirë për informim është familja;
- për 8.6% janë gazetatat;
- për 34.8% janë mediet elektronike/*online*;
- për 3.8% janë njoftimet zyrtare;
- për 10.9% janë rrjetet sociale;
- për 13.2% janë televizionet.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjen se cili është burimi më i mirë për informim në komunitetin e tyre, lidhur me një katastrofë dhe/ose situatë emergjente, mund të konkludojmë se për 34.8% ky burim është media elektronike *online* ndërsa për 26.2% është familja. Më pak, për 3.8% janë njoftimet zyrtare.

Krahasuar me anketimin e bërë dy vite më parë, shohim se njoftimet zyrtare nga vendi i parë si burim njoftimi me (45.7%), në vitin 2022 është në vend të fundit me 3.8%. Media elektronike/*online* nga 8.8% është rritur në 34.8%, ndërsa familja si burim është rritur nga 3.3% në 26.2%. Televizionet si burim informimi kanë shënuar një ulje nga 25.4% në 13.2%.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »




26. Cilën nga strukturat e mëposhtme shtetërore, keni kontaktuar të parën në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se cilën nga strukturat e mëposhtme shtetërore, keni kontaktuar të parën në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile, në paraqitje grafike është si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cilën nga strukturat e mëposhtme shtetërore, keni kontaktuar të parën në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile, gjejmë se:

- 10.1% kanë kontaktuar bashkinë;
- 14.8% zjarrfikëset;
- 1.4% Forcat e Armatosura;
- 4.2% Institutin e Shëndetit Publik;
- 3.3% Ministrinë e Shëndetësisë;
- 36.1% Policinë e Shtetit;
- 30.1% strukturat vendore dhe qendrore përgjegjëse për përballjen dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me pyetjen se cilën nga strukturat e

Cilën nga strukturat e mëposhtme shtetërore, keni kontaktuar të parën në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile:



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

mëposhtme shtetërore, kanë kontaktuar të parën në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve në të tilla raste kanë kontaktuar Policinë e Shtetit (36.1% e rasteve) si dhe strukturat vendore dhe qendrore përgjegjëse për përballjen dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile në 30.1% të rasteve.


Matja e shkallës së përgatitjeve për menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

27. Kush mendoni se duhet t'ju ndihmojë ju dhe komunitetin tuaj, në përgatitjen e një plani të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se kush duhet t'i ndihmojë ata dhe komunitetin e tyre, në përgatitjen e një plani të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se kush mendojnë se duhet t'i ndihmojë ata dhe komunitetin e tyre, në përgatitjen e një plani të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile, gjejmë se:

- për 13.9% të totalit të anketuarve janë grupet vullnetare që duhet t'i ndihmojnë;
- për 69.6% janë institucionet shtetërore;
- 4.6% nuk e dinë;
- 7.2% janë organizatat jo fitimprurëse;
- 4.6% mendojnë për të tjera mekanizma.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se kush duhet t'i ndihmojë ata dhe komunitetin e tyre, në përgatitjen e një plani të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (69.6%) mendojnë se për këtë duhet t'i ndihmojnë institucionet shtetërore, ndonëse krahasuar me anketimin e dy viteve më parë kjo shifër ka shënuar një rënie 13.4%. Ka shënuar një rritje me 6.6% kategoria e të anketuarve që besojnë se këtë punë mund të bëjnë grupet vullnetare dhe 2.3% kategoria që beson se këtë punë mund të bëjnë organizatat jofitimprurëse. Pra, shumica mendojnë se për përgatitjen e planit të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile duhet t'i ndihmojnë institucionet shtetërore, ndonëse ka një rritje të besimit në grupet vullnetare dhe OJF-të.



AKADEMIA E SIGURISË


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

28. A keni njohuri për aktet ligjore apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a kanë njohuri për ligjet apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se nëse kanë njohuri për ligjet apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri, gjejmë se:

- 68.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk kanë njohuri;
- 14.9% nuk e dinë;
- 16.6% janë përgjigjur po, pra kanë njohuri në këtë fushë.

Nga kjo e dhënë, gjetja kryesore na rezulton të jetë se shumica e të anketuarve (68.5%) e të anketuarve, janë përgjigjur se nuk kanë njohuri për aktet ligjore apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, shohim që ka një rritje me 29.7% në kategorinë e të anketuarve që nuk kanë njohuri për ligjet apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri. Gjithashtu ka një rënie me 23.6% në kategorinë e të anketuarve që nuk kanë njohuri në këtë fushë.



29. A jeni prekur ju apo familja juaj ndonjëherë nga një katastrofë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a janë prekur ata apo familja e tyre ndonjëherë nga një katastrofë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se a janë prekur ata apo familja e tyre ndonjëherë nga një katastrofë, gjejmë se:

- 61.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 38.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur po.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se a janë prekur ata apo familja e tyre nga një katastrofë, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (65.3%) nuk janë prekur nga ndonjë katastrofë. Ndërkohë që 28.2% e tyre janë prekur nga katastrofa.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se a janë prekur ata apo familja e tyre nga një katastrofë, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (61.6%) nuk janë prekur nga ndonjë katastrofë. Ndërkohë që 38.4% e tyre janë prekur nga katastrofa.

Pra, është relativisht e lartë shifra e të anketuarve që janë prekur nga një katastrofë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rënie me rreth 4% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë prekur ata ose familja e tyre nga një katastrofë si dhe rritje prej 10.2% në kategorinë e të anketuarve që janë prekur nga një katastrofë.




30. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur në rast urgjence ose fatkeqësie për një minimum prej 72 orësh furnizimi me ujë?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ujë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ujë, gjejmë se:

- 55.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk janë përgatitur;
- 8.3% janë përgjigjur në proces;
- 6.6% nuk e dinë;
- 29.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur po, janë përgatitur.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ujë, mund të konkludojmë se, shumica e të anketuarve (55.4%) pohojnë se nuk kanë siguruar furnizimin me ujë në një situatë të tillë, përkundrajt 29.7% të tyre të cilët deklarojnë se e kanë siguruar një furnizim të tillë. Ndërkohë që 8.3% janë në proces të sigurimit të këtij furnizimi. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 18.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për një situatë të tillë si dhe një rënie me 16.4% në kategorinë e atyre që pohojnë se kanë siguruar furnizimin me ujë në një situatë të tillë.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


31. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të keni një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqime?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqime, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqim, gjejmë se:

- 28% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 11.8% janë në proces;
- 6.3% nuk e dinë;
- 53.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur po, pra janë përgatitur të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqim.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqime, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (53.9%) pohojnë se kanë siguruar furnizimin me ushqim në një situatë të tillë, përkundrajt 28% të tyre të cilët deklarojnë se nuk kanë siguruar një furnizim të tillë. Ndërkohë, 6.3% të tyre nuk e dinë dhe 11.8% janë në proces të sigurimit të këtij furnizimi.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rënie me 7.1% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë përgatitur për një situatë të tillë emergjente, ndërkohë që ka një rritje me 4.5% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqim.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

32. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike?


Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike, në paraqitje tabelore dhe grafike

janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike, gjejmë se:

- 66.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 7.9% janë në proces;
- 7.6% nuk e dinë;
- 17.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur po, pra janë përgatitur për alternativën.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (66.7%) pranojnë se nuk janë përgatitur për një mënyrë të tillë komunikimi përkundërt 17.9% të anketuarve të cilët pohojnë se janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike. Ndërkohë, 7.9% janë në proces të kësaj përgatitje.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 14.1% në kategorinë e të anketuarve të cilët nuk janë përgatitur për një situatë të tillë emergjente, ndërkohë që ka një rënie 12% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike.



33. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie, gjejmë se:


- 54% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 11.4% janë në proces;
- 6.3% nuk e dinë;

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 28.3% janë përgjigjur po, pra janë përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (54%) pohojnë se nuk janë përgatitur për diçka të tillë ndërkohë që, 28.3% janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie. Gjithashtu, 11.4% e të anketuarve janë në proces të përgatitjes për të pasur të tillë mjete ndriçimi. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 13.7 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 12.9% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.



34. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur me mjete evakuimi në rast urgjence ose fatkeqësie?


Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur me mjete evakuimi në rast urgjence ose fatkeqësie, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur me mjete evakuimi në rast urgjence ose fatkeqësie, gjejmë se:

- 80.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 6.3% se janë përgjigjur në proces;
- 5.6% nuk e dinë;
- 7.2% janë përgjigjur po, pra janë përgatitur për këtë alternative.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur me mjete evakuimi në rast urgjence ose fatkeqësie, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (80.9%) pohojnë se nuk janë përgatitur me mjete evakuimi në rastet emergjente, ndërkohë që 7.2 % janë përgatitur me mjete të tilla. Gjithashtu 14.4% janë

në proces përgatitje.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje me 16.3 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur me mjete evakuimi në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 8.8% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.



35. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie, gjejmë se:

- 56.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 13.5% janë përgjigjur se janë në proces;
- 4.8% nuk e dinë;
- 25.3% janë përgjigjur po, që do të thotë janë të përgatitur.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (56.4%) pohojnë se nuk janë përgatitur mjaftueshëm me kuti të ndihmës së parë në rastet emergjente, ndërkohë që 25.3% janë përgatitur për këtë. Gjithashtu, 13.5% janë në proces përgatitje.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje me 18.1 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 17.1% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie?




36. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të keni një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie, gjejmë se:

- 85.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 5.3% janë në proces;
- 3.7% nuk e dinë;
- 5.6% janë përgjigjur po, pra janë përgatitur për këtë alternativë.

A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të keni një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie?



Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (85.4%) pohojnë se nuk janë përgatitur për këtë, përkundërt vetëm 5.6% që janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie. Ndërkohë që, 5.3 % janë në proces përgatitje.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 11.1 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 4.8 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.


37. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur me produkte të nevojshme higjieno-sanitare në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë produkte të nevojshme higjienosanitare në rast urgjence ose fatkeqësie, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë produkte të nevojshme higjienosanitare në rast urgjence ose fatkeqësie, gjejmë se:

- 41.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 12.7% janë në proces;
- 7.5% nuk e dinë;
- 38.3% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur të kenë produkte të nevojshme higjienosanitare në rast urgjence ose fatkeqësie, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (41.6%) pohojnë se nuk janë përgatitur t'i kenë këto produkte, përkundërt 38.3% që janë përgatitur. Ndërkohë që 12.7% janë në proces përgatitje.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 19.6 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë produkte të nevojshme higjienosanitare në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 25.3 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


38. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të kenë kuti në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore, gjejmë se:

- 78.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 8.9% janë në proces;
- 3.8% nuk e dinë;
- 8.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (78.8%) pohojnë se nuk janë përgatitur t'i kenë këto kuti, përkundrajt 8.6% të cilët janë përgatitur të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore. Ndërkohë që 8.9% prej tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 19.6% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore si dhe një ulje me 16.2% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

39. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë?


Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë, gjejmë se:

- 57.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 8% e janë në proces;

- 4.4% nuk e dinë;
- 30.5% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (57.1 %) pohojnë se nuk janë përgatitur të kenë telefona të tillë, përkundrajt 30.5% të cilët janë përgatitur të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë për raste fatkeqësish natyrore. Ndërkohë që 8% e tyre janë në proces të përgatitjes për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 6.1 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 5.9 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë.



40. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një sasi të hollash?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një sasi të hollash, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një sasi të hollash, gjejmë se:


- 37.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 16% janë në proces;
- 11.5% nuk e dinë;
- 34.9% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një sasi të hollash, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (37.6 %) pohojnë se nuk janë përgatitur të kenë një sasi të hollash për raste të tilla, përkundrajt 34.9% të cilët janë përgatitur të kenë një sasi të hollash në raste urgjencash apo raste fatkeqësish natyrore. Ndërkohë që 16% e tyre janë në proces përgatitjes për këtë alternativë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ata që janë të papërgatitur përbëjnë shumicën dhe ka një rritje me 5.1 %. Gjithashtu, ka një

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


ulje me 15.3 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një sasi të hollash.



41. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur për mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia, në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia, gjejmë se:

- 77.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 8.2% janë në proces;
- 4.9% nuk e dinë;
- 9% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.



Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (77.9%) pohojnë se nuk janë përgatitur për një alternative të tillë, përkundrajt 9% të cilët janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia. Ndërkohë që 8.2% e tyre janë në proces përgatitjeje për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 21 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternative si dhe një ulje me 19 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia.


42. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të keni pajisje për fëmijët, në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët, gjejmë se:

- 83% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 5.6% janë në proces;
- 4.1% nuk e dinë;
- 7.3% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (83%) pohojnë se nuk janë përgatitur për një alternative të tillë, përkundrajt 7.3 % të cilët janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët. Ndërkohë që 5.6% e tyre janë në proces të përgatitjes për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 22 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 16.4 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


43. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të keni pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta, në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta, gjejmë se:

- 85.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo,
- 4.2% janë në proces,
- 2.8% nuk e dinë,
- 7.3% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (85.7%) pohojnë se nuk janë përgatitur për një alternative të tillë, përkundrajt 7.3% të cilët janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta. Ndërkohë që 4.2% e tyre janë në proces përgatitjes për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 16.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternative si dhe një ulje me 8.7% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta.



44. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të keni një plan evakuimi, në rast urgjence ose fatkeqësie?


Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi, gjejmë se:

- 83% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 6% janë në proces;

- 5.9% nuk e dinë;
- 5.1% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (83%) pohojnë se nuk janë përgatitur për një alternativë të tillë, përkundrajt 5.1% të cilët janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi. Ndërkohë që 6% e tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 21.8 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 16 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi.



45. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur të keni një plan operacional të urgjencës, në rast urgjence ose fatkeqësie?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plani operacional të urgjencës, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan operacional të urgjencës, gjejmë se:

- 84.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 5.1% janë në proces;
- 5.9% nuk e dinë;
- 4.9% janë përgjigjur po, pra janë të përgatitur për këtë alternativë.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë të kenë një plani operacional të urgjencës, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (84.1%) pohojnë se nuk janë përgatitur për një alternativë të tillë, përkundrajt 4.9% të cilët janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan operacional të urgjencës. Ndërkohë që 5.1% e tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 15.3 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 9.1 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan operacional të urgjencës.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur tw keni njw plan opercional tw urgjencws, në rast urgjence ose fatkeqësie?




46. A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jeni të pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës?

Përgjigjet e të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës, gjejmë se:

- 75.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 8% janë në proces;
- 4.1% nuk e dinë;
- 12% e totalit të anketuarve janë përgjigjur po, pra janë mbuluar me siguracion.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për alternativën nëse janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (75.9%) pohojnë se nuk janë përgatitur për një alternativë të tillë, përkundrajt 12% të cilët janë përgatitur që në rast urgjence

A jeni ju dhe familja juaj të përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jeni tw pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës?



ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës. Ndërkohë që, 8% e tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 14.7 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 8.3 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës.

7.2.3. Analiza e gjetjeve lidhur me shkallën e përgatitjeve për menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Në mënyrë të përmblodhur, nga analiza e gjetjeve lidhur me shkallën e përgatitjeve për menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (55.4%) pohojnë se nuk kanë siguruar furnizimin me ujë (55.4%) dhe ushqim (53.9%) në një në rast urgjence ose fatkeqësie, për një minimum prej 72 orësh dhe në rastet emergjente nuk janë përgatitur: për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike (66.7%); për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite (54%); me mjete evakuimi (80.9%); më kuti të ndihmës së parë (56.4%); që të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin (85.4%); të kenë produkte të nevojshme higjienosantare (41.6%); të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore (78.8%); të kenë një sasi të hollash në raste urgjencash (37.6 %); të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia (77.9 %); të kenë pajisje për fëmijët (83%); të kenë pajisjet për të moshuarit (85.7%); të kenë një plan evakuimi (83%); të kenë një plan operacional të urgjencës (84.1%); të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës (75.9%).

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje në % të të anketuarve që në rastet emergjente, nuk janë përgatitur për alternativat e mësipërme.


Në paraqitje tabelore dhe grafike, janë si më poshtë:

Shumica e të anketuarve, në rastet emergjente nuk janë përgatitur:	
Furnizimin me ujë për një minimum prej 72 orësh	55,40%
Ushqim për një minimum prej 72 orësh	53,90%
Për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike	66,70%
Për të pasur mjaftueshëm elektrik dore ose burime drite	54%
Me mjete evakuimi	80,90%
Më kuti të ndihmës së parë;	56,40%
Që të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin	85,40%
Të kenë produkte të nevojshme higjeno-sanitare	41,60%
Të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore	78,80%
Të kenë një sasi të hollash në raste urgjencash	37,60%
Të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia	77,90%
Të kenë pajisje për fëmijët	83%
Të kenë pajisjet për të moshuarit	85,70%
Të kenë një plan evakuimi	83%
Të kenë një plan operacional të urgjencës	84,10%
Të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës	75,90%


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Në anketimin e dy viteve më parë këto të dhëna, në paraqitje grafike kanë qenë si më poshtë:



Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje në % të të anketuarve që në rastet emergjente, nuk janë përgatitur për alternativat e mësipërme.



Perceptimi lidhur me shkaqet, pasojat dhe masat për reduktimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

47. Sa dakord jeni, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa dakord janë, që fatkeqësitë natyrore/

emergjencat civile reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa dakord janë, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave, gjejmë se:

- 6.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak dakord;
- 43.2% janë dakord;
- 0.6% nuk e dinë;
- 0.4% janë pa përgjigje;
- 17.2% janë pak dakord;
- 31.8% janë shumë dakord.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa dakord janë, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave, mund të konkludojmë se, shumica e të anketuarve (75%) janë dakord dhe shumë dakord me këtë, përkundrajt 24.1%, të cilët nuk janë aspak apo janë pak dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, shifrat janë përafërsisht të njëjta, ndërkohë që ka një rritje me 5% të kategorisë që nuk janë aspak apo janë pak dakord me pohimin.



48. Sa dakord jeni, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa dakord janë ata, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa dakord janë, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën, gjejmë se:


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 3.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak dakord;
- 51.2 janë dakord;
- 1.7% nuk e dinë;
- 0.6% janë pa përgjigje;
- 17.3% pak dakord;
- 25.9% janë shumë dakord.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa dakord janë, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 77.1%(51.2 %+25.9%) janë dakord dhe shumë dakord me këtë, përkundrajt 20.7% , të cilët nuk janë aspak apo janë pak dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën. Pra, shumica e të anketuarve kanë sensibilitetin për ndryshimet drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social që vijnë në mbarë botën nga fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, janë thujtse të barabarta shifrat për kategorinë e atyre që janë dakord dhe shumë dakord me pohimin që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën. Ndërkohë ka një rritje me 7.6% në kategorinë e të anketuarve të cilët nuk janë aspak apo janë pak dakord me këtë pohim.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

49. Sa ndikon urbanizimi i shpejtë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon urbanizimi i shpejtë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon urbanizimi i shpejtë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 46.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndikon;
- për 25.7% ndikon pak;

- për 19.8% ndikon shumë;
- 1.8% nuk e dinë;
- për 6.2% nuk ndikon.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikon urbanizimi i shpejtë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 66.2% janë dakord dhe shumë dakord me këtë, përkundrajt 31.9% , të cilët mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak urbanizimi i shpejtë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ritje me 3.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se urbanizimi i shpejtë ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave si dhe një ulje prej 2.4% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak.



50. Sa ndikon mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 41.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndikon;
- për 19.5% ndikon pak;
- për 36% ndikon shumë;
- për 2% nuk ndikon;
- 1.4% nuk e dinë.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikon mosndëshkimi i

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 77.1% janë përgjigjur si ndikon dhe ndikon shumë, përkundrajt 21.5%, të cilët mendojnë se nuk ndikon apo ndikon pak.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 7.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore si dhe një ulje më 6.5% në kategorinë e atyre që mendojnë nuk ndikon.



51. Sa ndikon mbipopullimi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore / emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon mbipopullimi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon mbipopullimi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 41.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur ndikon;
- për 24.6% ndikon pak;
- për 21.4% ndikon shumë;
- 2.5% nuk e dinë;
- për 9.8% nuk ndikon.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikon mbipopullimi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 63% janë përgjigjur se ndikon dhe ndikon shumë, përkundrajt 34.4%, të cilët mendojnë se mbipopullimi nuk ndikon ose ndikon pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 6.5% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë mbipopullimi është faktor që ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 5.9% në kategorinë e atyre që mendojnë nuk ndikon ose ndikon pak.




52. Sa ndikon djegia e lëndëve të rrezikshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon djegia e lëndëve të rrezikshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon djegia lëndëve të rrezikshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 36.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndikon;
- për 22.8% ndikon pak;
- për 32.3% ndikon shumë;
- 3.2% nuk e dinë;
- për 5.1% nuk ndikon.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikon djegia e fosileve si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, (68.9%) janë përgjigjur se ndikon dhe ndikon shumë,



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

përkundrejt 27.9% , të cilët mendojnë se djegia lëndëve të rrezikshme nuk ndikon ose ndikon pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 27.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se djegia lëndëve të rrezikshme është faktor që ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 6% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak.

53. Sa ndikojnë zjarret e qëllimshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë zjarret e qëllimshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë zjarret e qëllimshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 37% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndikojnë;
- Për 15.3% ndikojnë pak;
- për 44.4% ndikojnë shumë;
- 1.3% nuk e dinë;
- për 2% nuk ndikojnë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikojnë zjarret e qëllimshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 81.4% janë përgjigjur se ndikojnë dhe ndikojnë shumë, përkundrejt 17.3% të cilët mendojnë se zjarret e qëllimshme nuk ndikojnë ose ndikojnë pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 7.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se zjarret e qëllimshme janë faktor që ndikojnë dhe ndikojnë shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 6.2% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikojnë ose ndikojnë pak.

Sa ndikojnë zjarret e qëllimshme, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?



AKADEMIA E SIGURISË


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

54. Sa ndikon bioterrorizmi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon bioterrorizmi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon bioterrorizmi, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 32.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur ndikon;
- për 21.4% ndikon pak;
- për 13.8% ndikon shumë;
- 11.7% nuk e dinë;
- për 20.7% nuk ndikon.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikon bioterrorizmi si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (46.3%) janë përgjigjur se ndikon dhe ndikon shumë, përkundrajt 42.1%, të cilët mendojnë se bioterrorizmi nuk ndikon ose ndikon pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile. Ndërkohë që 11.7% janë përgjigjur se nuk e dinë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rënie me 12.3% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se bioterrorizmi është faktor që ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një rritje me 10.6% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak.



55. Sa ndikojnë mbeturinat bujqësore si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë mbeturinat bujqësore si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike

**AKADEMIA
E SIGURISË**


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë mbeturinat bujqësore si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 33.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur ndikojnë;
- për 29.7% ndikojnë pak;
- për 15.5% ndikojnë shumë;
- 6.6% nuk e dinë;
- për 15.2% nuk ndikojnë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikojnë mbeturinat bujqësore, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (46.6%) janë përgjigjur se ndikojnë dhe ndikojnë shumë, përkundrajt 44.9%, të cilët mendojnë se mbeturinat bujqësore nuk ndikojnë ose ndikojnë pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 7% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se mbeturinat bujqësore janë faktor që ndikojnë dhe ndikojnë shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një rritje me 5.2% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikojnë ose ndikojnë pak.




56. Sa ndikon shpyllëzimi si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon shpyllëzimi si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon shpyllëzimi si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

- 36.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndikon;
- për 13.8% të anketuarve ndikon pak;
- për 43.6% ndikon shumë;
- 1.8% nuk e dinë;
- për 4.4% nuk ndikon.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikon shpyllëzimi si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, 80% janë përgjigjur se ndikon dhe ndikon shumë, përkundërt 18.2%, të cilët mendojnë se shpyllëzimi nuk ndikon ose ndikon pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ngritje me 4.6% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se shpyllëzimi ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 3.6% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon apo ndikon pak.



57. Sa ndikojnë ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit, në ndodhinë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit, si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore, gjejmë se:

- 32.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se ndikojnë;
- për 17.2% ndikojnë pak;
- për 41.1% ndikojnë shumë;
- 4.6% nuk e dinë;
- për 4.6% nuk ndikojnë.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, për pyetjen se sa ndikojnë ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, (73.6%) janë përgjigjur se ndikon dhe ndikon shumë, përkundërt 21.8%, të cilët mendojnë se ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit nuk ndikojnë ose ndikojnë pak si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, janë në të njëjtat shifra (73.6%)

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

kategorinë e të anketuarve që mendojnë se ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit ndikojnë dhe ndikojnë shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 1.17% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon apo ndikon pak.



7.2.4. Analiza krahasuese e treguesve lidhur me perceptimin e të anketuarve për shkaqet, pasojat dhe masat për reduktimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Në mënyrë të përmblodhur, nga analiza e treguesve lidhur me perceptimin e të anketuarve për shkaqet, pasojat dhe masat për reduktimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve mendojnë se në fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile si faktorë ndikojnë dhe ndikojnë shumë: zjarret e qëllimshme (81.4%); shpyllëzimi (80%); mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore (77.1%); ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit (73.6%); djegia lëndëve të rrezikshme (68.9%); mbipopullimi (63%); mbeturinat bujqësore (46.6%); bioterrorizmi (46.3%).

Në paraqitje tabelore dhe grafike kjo është si më poshtë:

zjarret e qëllimshme	81,40%
shpyllëzimi	80%
mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore	77,10%
ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit	73,60%
djegia lëndëve të rrezikshme	68,90%
mbipopullimi	63%
mbeturinat bujqësore	46,60%
bioterrorizmi	46,30%

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »




Krahasuar me anketimin e kryer dy viteve më parë ka një rritje në kategorinë e të anketuarve që vlerësojnë si faktorë që ndikojnë dhe ndikojnë shumë djegjen e lëndëve të rrezikshme, mbipopullimin; zjarret e qëllimshme dhe shpyllëzimin.

Matje e nivelin e njohurive për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore

58. Cili është niveli i njohurive tuaja për menaxhimin e tërmetit si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurive tuaja për menaxhimin e tërmetit si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e tërmetit si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 13.2% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë asnjë njohuri;
- 47.8% kanë pak njohuri;
- 34.3% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 4.6% kanë shumë njohuri.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë 60% e të anketuarve kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si tërmetet, ndërkohë që 38.9% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e katastrofave të tilla si tërmetet.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 20% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si tërmetet si dhe një ulje me 21.1% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.


59. Cili është niveli i njohurive tuaja për menaxhimin e përmbytjeve si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e përmbytjeve si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e përmbytjeve si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 28.3% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë asnjë njohuri;
- 42.6% kanë pak njohuri;
- 22.5% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 6.6% kanë shumë njohuri.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 70.9% e të anketuarve, nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si përmbytjet, ndërkohë që 29.1% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (70.9%) nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e katastrofave të tilla si përmbytjet.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 17.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si përmbytjet si dhe një ulje me 17.9% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.




60. Cili është niveli i njohurive tuaja, për menaxhimin e thatësirave të tejzgjatura si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurisë të tyre për menaxhimin e një thatësire të tej zgjatur si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 42.2% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë asnjë njohuri;
- 40.9% kanë pak njohuri;
- 14.2% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 2.7% kanë shumë njohuri.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 83.1% e të anketuarve, nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si thatësirat e tej zgjatura, ndërkohë që 16.9% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (83.1%) nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e katastrofave të tilla si thatësirat e tej zgjatura.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 19.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si thatësirat e tej zgjatura si dhe një ulje me 18.9% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.



61. Cili është niveli i njohurive tuaja, për menaxhimin e katastrofave natyrore të tilla si uraganet/stuhitë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave nga uraganet/stuhitë si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore

**AKADEMIA
E SIGURISË**


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave nga uraganet/stuhitë si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 64.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk kanë asnjë njohuri;
- 22.1% kanë pak njohuri;
- 11% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 2.1% kanë shumë njohuri.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 86.9% e të anketuarve, nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të katastrofave të tilla si uraganet/stuhitë, ndërkohë që 13.1% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (86.9%) nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e pasojave të katastrofave të tilla si uraganet/stuhitë.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 11.7% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si uraganet/stuhitë si dhe një ulje me 18.6% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.




62. Cili është niveli i njohurive tuaja, për menaxhimin e katastrofave natyrore të tilla si zjarret?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave nga zjarret si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave nga zjarret si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 21.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk kanë asnjë njohuri;
- 45.6% kanë pak njohuri;
- 26% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 6.6% kanë shumë njohuri

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 67.4% e të anketuarve, nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të zjarreve si katastrofave natyrore, ndërkohë që 30.6% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (67.4%) nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të zjarreve si katastrofë natyrore.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 18.8% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si zjarret si dhe një ulje me 20.8% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.



63. Cili është niveli i njohurive tuaja, për menaxhimin e katastrofave të tilla si incidentet radioaktive?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave nga incidentet radioaktive si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave nga incidentet radioaktive si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 67.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk kanë asnjë njohuri;
- 22.2% kanë pak njohuri;
- 9.8% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 0.6% kanë shumë njohuri.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 89.6% e të anketuarve, nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të incidenteve radioaktive, ndërkohë që 10.4% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se është relativisht i lartë numri i të anketuarve (89.6%) që nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të incidenteve radioaktive. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 15% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si zjarret si dhe një ulje me 15% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »




64. Cili është niveli i njohurive tuaja, për menaxhimin e katastrofave të tilla si pandemitë/epidemitë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave të pandemive/epidemive si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se cili është niveli i njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave të pandemive/epidemive si katastrofë natyrore, gjejmë se:

- 11.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë asnjë njohuri;
- 27.4% kanë pak njohuri;
- 44% kanë njohuri të mjaftueshme;
- 16.7% kanë shumë njohuri.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (60.7%) e tyre kanë mjaftueshëm apo shumë njohuri për menaxhimin e pasojave të pandemive/epidemive si katastrofë natyrore, ndërkohë që 39.2% e tyre,



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se është relativisht i lartë numri i të anketuarve (39.2%) që nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të pandemive/epidemive.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 1.6% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si zjarret si dhe një rritje me 1.5% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.


7.2.5. Analiza krahasuese e treguesve lidhur me matjet e nivelit të njohurive për menaxhimin e rrezikut të katastrofave.

Në mënyrë të përmblëdhur, nga analiza e treguesve lidhur me matjet e nivelit të njohurive për menaxhimin e rrezikut të katastrofave mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si: të incidenteve radioaktive (89.6%); uraganet/stuhitë (86.9%); thatësirat e tej zgjatura (83.1%); përmytjet (70.9%); të zjarreve (67.4%); tërmetet (60%); të pandemive/epidemive (39.2%). Në paraqitje tabelore dhe grafike kjo është si më poshtë:

Të anketuarit kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si:

të incidenteve radioaktive	89,60%
uraganet/stuhitë	86,90%
thatësirat e tej zgjatura	83,10%
përmytjet	70,90%
të zjarreve	67,40%
tërmetet	60%
të pandemive/epidemive	39,20%

Në anketimin e kryer dy vite më parë, në paraqitje grafike të dhënat e mësipërme kanë qenë si më poshtë:



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Krahasuar me të dhënat e anketimit të kryer dy vite më parë, në vitin 2022, ka një rritje të konsiderueshme në kategorinë e të anketuarve që kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të mësipërme.


Matje e nivelit të shqetësimit në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore.

65. Sa dakord jeni, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri për të cilën janë hartuar akte ligjore të forta në Shqipëri.

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa dakord janë që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë dukuri për të cilën janë hartuar ligje të forta në Shqipëri, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa dakord jeni, që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri për të cilën janë hartuar akte ligjore të forta në Shqipëri, gjejmë se:

- 20.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak dakord;
- 30.7% janë pak dakord;
- 22.8% janë dakord;
- 8.7% janë shumë dakord;
- 14.8% nuk e dinë;
- 2.3% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme rezulton se shumica e të anketuarve (51.5%), janë përgjigjur se janë aspak apo pak dakord me pohimin se fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri për të cilën janë hartuar akte ligjore të forta në Shqipëri. Ndërkohë 31.5% janë dakord dhe shumë dakord me pohimin.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

66. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për tërmetet si katastrofë natyrore?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individ për menaxhimin e pasojave të tërmeteve si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve

të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individ për menaxhimin e pasojave të tërmeteve si katastrofë natyrore gjejmë se:

- 10.4% janë aspak të shqetësuar;
- 28.8% janë pak të shqetësuar;
- 46.8% janë të shqetësuar;
- 13.9% janë shumë të shqetësuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve (60.8%) janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e tërmeteve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre, ndërkohë që 39.2% e tyre, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar për këtë. Pra, është e lartë (60.8%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e tërmeteve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 16% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e tërmeteve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 16% të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.



67. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për përmbajtjet si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbajtjeve dhe pasojat e tyre si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individë për menaxhimin e pasojave të përmbajtjeve si katastrofë natyrore gjejmë se:

- 21% janë aspak të shqetësuar;
- 31.8% janë pak të shqetësuar;
- 35.9% janë të shqetësuar;


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 11.4% janë shumë të shqetësuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 52.8% e të anketuarve, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që 47.3% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (47.3%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 13.1% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 13.1% të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.



68. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për thatësitrat e tejzgjatura si katastrofë natyrore?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura dhe pasojat e tyre si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individ për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura dhe pasojat e tyre si katastrofë natyrore gjejmë se:

- 27.7% janë aspak të shqetësuar,
- 37.3% janë pak të shqetësuar,
- 27.4% janë të shqetësuar,
- 7.6% janë shumë të shqetësuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 65% e të anketuarve nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë

si individ për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që 35% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (35%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 6.5% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 6.5% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.



69. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për uraganet/furtunat si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individ për menaxhimin e uraganeve/furtunave dhe pasojat e tyre si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individ për menaxhimin e uraganeve/furtunave dhe pasojat e tyre si katastrofë natyrore gjejmë se:

- 48.8% janë aspak të shqetësuar;
- 24.9% janë pak të shqetësuar;
- 19.7% janë të shqetësuar;
- 6.6% janë shumë të shqetësuar.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 73.7% e të anketuarve nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e uraganeve/furtunave si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 26.3% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (26.3%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e uraganeve/furtunave e si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 2.1% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e uraganeve/furtunave si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 2.1% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.



70. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për zjarret si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve dhe pasojave të tyre si katastrofë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve dhe pasojave të tyre si katastrofë natyrore gjejmë se:

- 12.5% janë aspak të shqetësuar;
- 37.4% janë pak të shqetësuar;
- 37.3% janë të shqetësuar;
- 12.8% janë shumë të shqetësuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 49.9% e të anketuarve, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 50.1% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, shumica e të anketuarve (50.1%) janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 9.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë

menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 9.8% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.



71. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për incidentet radioaktive si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive dhe pasojave të tyre, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive dhe pasojave të tyre gjejmë se:

- 47.4% janë aspak të shqetësuar;
- 25.3% janë pak të shqetësuar;
- 19.8% janë të shqetësuar;
- 7.5% janë shumë të shqetësuar.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 72.7% e të anketuarve, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 27.3% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (27.3%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 2% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një ulje me 2% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për incidentet radiokative si katastrofë natyrore?




72. Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për pandemitë/epidemitë si katastrofë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjet se sa të shqetësuar janë në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive dhe pasojave të tyre si katastrofa natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa të shqetësuar janë, në raport me njohuritë menaxhuese, që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive dhe pasojave të tyre si katastrofa natyrore, gjejmë se:

- 4.4% janë aspak të shqetësuar;
- 21% janë pak të shqetësuar;
- 49.2% janë të shqetësuar;
- 25.5% janë shumë të shqetësuar.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se 25.4% e të anketuarve, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 74.7% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, shumica e të anketuarve (74.7%) janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për

Sa i/e shqetësuar jeni për njohuritë menaxhuese, që keni ju si individ për pandemitë/epidemitë si katastrofë natyrore?



nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive dhe të pasojave të tyre.


Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 22% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 22% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

7.2.6. Analiza krahasuese e treguesve lidhur me matjen e nivelin të shqetësimit në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore

Në mënyrë të përmblodhur, nga analiza e treguesve lidhur me matjen e nivelin të shqetësimit në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e: pandemive/epidemive dhe të pasojave të tyre (74.7%); tërmete (60.8%); zjarreve (50.1%); përmbytjeve (47.3%); thatësirave të tej zgjatura (35%); incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre (27.3%); uraganeve/furtunave (22.6%).

Në paraqitje tabelore dhe grafike të dhënat e mësipërme janë si më poshtë:

Shumica e të anketuarve janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e:	
pandemive/epidemive dhe të pasojave të tyre	74,70%
uraganeve/furtunave	26.3%
incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre	27.3%
thatësirave të tej zgjatura	35%
tërmete	60,80%
e përmbytjeve	47.3%
e zjarreve	50,10%



Krahasuar me të dhënat e anketimit të kryer dy vite më parë, në përgjithësi ka një rritje në kategorinë e të anketuarve që janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e katastrofave natyrore.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


Perceptimet për strategjinë e menaxhimit të rrezikut të katastrofave/ fatkeqësive natyrore.

73. A ka zhvilluar dhe zbatuar vendi ynë një strategji gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar të menaxhimit të rrezikut të katastrofave natyrore për të përballuar rreziqet natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse vendi ynë ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar të menaxhimit të rrezikut të katastrofave natyrore për të përballuar rreziqet natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen nëse vendi ynë ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar të menaxhimit të rrezikut të katastrofave natyrore për të përballuar rreziqet natyrore gjejmë se:

- 40.9% janë përgjigjur jo, pra nuk ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të tillë;
- 37.7% nuk e dinë;
- 2.8% janë pa përgjigje;
- 18.6% janë përgjigjur po.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se për shumicën e të anketuarve, me një përfaqësim prej 40.9%, vendi jonë nuk ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar, të menaxhimit të rrezikut të katastrofave natyrore për të përballuar rreziqet natyrore. Vetëm 18.6% mendojnë se vendi ynë ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të tillë.



AKADEMIA E SIGURISË


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

74. A merr pjesë vendi ynë në ndonjë strategji të menaxhimit të katastrofave natyrore në nivel rajonal apo ndërkombëtar?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse vendi ynë merr pjesë në ndonjë strategji të menaxhimit të katastrofave natyrore në nivel rajonal apo ndërkombëtar, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse vendi ynë merr pjesë në ndonjë strategji të menaxhimit të katastrofave natyrore në nivel rajonal apo ndërkombëtar, gjejmë se:

- 34.3% janë përgjigjur jo, pra nuk merr pjesë;
- 43.3% nuk e dinë;
- 3.9% janë përgjigjur nuk më intereson;
- 18.4% janë përgjigjur po, vendi ynë merr pjesë në këto strategji.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 43.3% nuk e dinë, nëse merr pjesë vendi jonë në ndonjë strategji të menaxhimit të katastrofave natyrore në nivel rajonal apo ndërkombëtar. Për 34.3% të anketuarve vendi ynë nuk merr pjesë në ndonjë strategji të tillë, ndërsa për 18.4% vendi ynë merr pjesë.



75. Nëse je përgjigjur po më sipër: A është ndërgjegjësimi/edukimi për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore një komponent i kësaj strategjie?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse është ndërgjegjësimi/edukimi për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore një komponent i kësaj strategjie, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen nëse është ndërgjegjësimi/edukimi për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore një komponent i kësaj strategjie, gjejmë se:


- 29.7% janë përgjigjur në alternativën “tjetër”;
- 26.9% janë përgjigjur jo;
- 22.9% nuk e dinë;
- 20.3% janë përgjigjur po;
- 0.10% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk është investuar shumë tek ndërgjegjësimi i popullatës, për vetëmenaxhimin e situatës.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se vetëm 20.3% e të anketuarve mendojnë ndërgjegjësimi/edukimi për rreziqet natyrore dhe reduktimin e

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

rrezikut nga fatkeqësitë natyrore së është një komponent i strategjisë së menaxhimit të katastrofave natyrore.




76. Sipas mendimit tuaj, sa për qind e burimeve publike të ndara çdo vit për zbatimin e kësaj strategjie i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe përpjekjeve arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa për qind e burimeve publike të ndara çdo vit për zbatimin e kësaj strategjie i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe përpjekjeve arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në paraqitje tabelorë dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa % e burimeve publike të ndara çdo vit për zbatimin e kësaj strategjie i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe përpjekjeve arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, gjejmë se:

- 32.2% janë përgjigjur për 0-25 % të burimeve;
- 13.9% janë për 30-50%;
- 5.5% janë për mbi 50%;
- 38% nuk e dinë;
- 10.4% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 38% nuk e dinë se sa për qind e burimeve publike janë ndarë çdo vit për zbatimin e kësaj strategjie, i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe përpjekjeve arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.




77. Sipas jush, sa herë shpërndahen burimet publike që mbështesin ndërgjegjësimin për rreziqet natyrore dhe nismat arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sipas tyre sa herë shpërndahen burimet publike që mbështesin ndërgjegjësimin për rreziqet natyrore dhe nismat arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se sipas tyre sa herë shpërndahen burimet publike që mbështesin ndërgjegjësimin për rreziqet natyrore dhe nismat arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, gjejmë se:

- për 42.8% e totalit të anketuarve këto burime shpërndahen çdo vit;
- për 7.9% shpërndahen me mandate pesëvjeçar;
- për 9% shpërndahen me mandate trevjeçar;
- 31.5% nuk e dinë;
- 8.9% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se për shumicën e të anketuarve, me një përfaqësim prej 42.8%, shpërndahen çdo vit burimet publike që mbështesin ndërgjegjësimin për rreziqet natyrore dhe nismat arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, ndërkohë që 31.5% e tyre nuk e dinë.



Vlerësimi i nevojave, burimet si përparësi, monitorimi dhe vlerësimi i përpjekjeve

78. A keni informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimin të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a kanë informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimin të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se a kanë informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimin të rrezikut nga


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore, gjejmë se:

- 33.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk kanë informacion;
- 31.5% nuk e dinë;
- 4.6% janë pa përgjigje;
- 30% janë përgjigjur po, pra kanë informacion.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 65.4%, nuk kanë informacion dhe nuk e dinë nëse vendi jonë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore. Ndërsa 30% kanë informacion për kryerjen e një vlerësimi të tillë.




79. A keni informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për pasojat e tyre financiare?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a kanë informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për pasojat e tyre financiare, në paraqitje tabelorë dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se a kanë informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për pasojat e tyre financiare, gjejmë se:

- 32.6% janë përgjigjur jo, pra nuk kanë informacion;
- 31.1% nuk e dinë;
- 4.1% janë pa përgjigje;
- 32.2% janë përgjigjur po, pra kanë informacion.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 63.7 %, nuk kanë informacion dhe nuk e dinë nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për pasojat e tyre financiare. Ndërkohë, 32.2% janë përgjigjur se kanë informacion që vendi ynë ka kryer një vlerësim të tillë të perceptimit të rrezikut.




80. Nëse jeni përgjigjur po alternativave më sipër, a keni ndonjë shembull konkret?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse jeni përgjigjur po alternativave më sipër, a keni ndonjë shembull konkret, në paraqitje tabelorë dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen nëse janë përgjigjur po alternativave më sipër, a keni ndonjë shembull konkret, gjejmë se:

- 75.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 24.5% janë përgjigjur po.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 75.5 % janë përgjigjur se nuk kanë ndonjë shembull konkret, që vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore, ndërkohë që 24.5% kanë shembuj konkret për këtë.



AKADEMIA E SIGURISË


« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

81. A mendoni se ndaj nismave ekzistuese të edukimit për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut është bërë një vlerësim i efektivitetit të zbatimit të tyre?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a mendojnë se ndaj nismave ekzistuese të edukimit për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut është bërë një vlerësim i efektivitetit të zbatimit të tyre, në paraqitje tabelorë dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen nëse mendojnë se ndaj nismave ekzistuese të edukimit për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut është bërë një vlerësim i efektivitetit të zbatimit të tyre, gjejmë se:

- 46.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk mendojnë se është bërë një vlerësim i tillë;
- Për 14.1% është bërë një vlerësim i tillë;
- 34.7% nuk e dinë;
- 4.5% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 46.7%, nuk mendojnë që është bërë një vlerësim ndaj nismave ekzistuese të edukimit për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut, përkundrajt 14.2%, të cilët mendojnë se është bërë një vlerësim i tillë.




82. A janë prioritet programet ekzistuese arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a janë prioritet programet ekzistuese arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se a janë prioritet programet ekzistuese arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, gjejmë se:

- 52.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk janë prioritet;
- 26.4% janë përgjigjur po, pra janë prioritet;
- 16.7% nuk e dinë;
- 4.1% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 52.7%, janë përgjigjur se nuk mendojnë, që janë


prioritet programet ekzistuese arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë. Ndërkohë që për 26.4% mendojnë se janë prioritet.



83. A janë kryer vlerësime periodike të përpjekjeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vendin tuaj?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a janë kryer vlerësime periodike të përpjekjeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vendin tuaj, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se a janë kryer vlerësime periodike të përpjekjeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vendin tuaj, gjejmë se:

- 49.2% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk janë kryer vlerësime periodike;
- 19.4% janë përgjigjur po, pra janë kryer vlerësime të tilla;
- 29.8% nuk e dinë;
- 1.5% janë për tjetër alternative.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 49.2%, mendojnë që nuk janë kryer vlerësime periodike të përpjekjeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vendin tonë, ndërkohë që, 19.4% mendojnë që janë kryer vlerësime periodike.

84. Sipas jush, a ka në vendin tonë mënyra nëpërmjet të cilave, monitorohen efektet e përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe edukim për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a ka në vendin tonë mënyra nëpërmjet të cilave, monitorohen efektet e përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe edukim për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se a ka në vendin tonë mënyra nëpërmjet të cilave, monitorohen efektet e përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe edukim për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile, gjejmë se:

- 43.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur jo, pra nuk ka mënyra monitorimi.
- 26.7% nuk e dinë;
- 4.1% janë pa përgjigje;
- 25.7% janë përgjigjur po, pra ka mënyra monitorimi.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 43.5% mendojnë që, në vendin tonë, nuk ka mënyra nëpërmjet të cilave monitorohen efektet e përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe edukim për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile. Ndërkohë, 25.7% mendojnë se ka mënyra të tilla monitorimi.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

Matja e nivelit të informim mbi efektet ekonomike të fatkeqësive, mbulimi i sigurimit dhe mjete të tjera të menaxhimit financiar


85. A synojnë përpjekjet për edukimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë të informojnë dhe për pasojat ekonomike të rreziqeve natyrore dhe kostot që lidhen me ngjarjet e fatkeqësive?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a synojnë përpjekjet për edukimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë të informojnë dhe për pasojat ekonomike të rreziqeve natyrore dhe kostot që lidhen me ngjarjet e fatkeqësive, në paraqitje tabelore dhe

grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se a synojnë përpjekjet për edukimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, të informojnë dhe për pasojat ekonomike të rreziqeve natyrore dhe kostot që lidhen me ngjarjet e fatkeqësive, gjejmë se:

- 12% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak;
- 37.4% e totalit të anketuarve janë përgjigjur deri diku;
- 27.7% e totalit të anketuarve janë përgjigjur pak;
- 9.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur mjaftueshëm;
- 5.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur shumë;
- 6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk e di;
- 1.1% e totalit të anketuarve janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se vetëm 15.7% e të anketuarve mendojnë, që përpjekjet për edukimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, synojnë mjaftueshëm dhe shumë të informojnë dhe për pasojat ekonomike të rreziqeve natyrore dhe kostot që lidhen me ngjarjet e fatkeqësive.



86. A keni informacion se cilat kosto mbulohen nga shteti nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore ose fondeve e rezervave të dedikuara dhe çfarë humbesh në vend të kësaj do të përballohen drejtpërdrejt nga individët, familjet dhe bizneset, në rastet e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile?


Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a keni informacion se cilat kosto mbulohen nga shteti nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore ose fondeve e rezervave të dedikuara dhe çfarë humbesh në vend të kësaj do të përballohen drejtpërdrejt nga individët, familjet dhe bizneset, në rastet e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se a keni informacion se cilat kosto mbulohen nga shteti nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore ose fondeve ose rezervave të dedikuara dhe çfarë humbesh në vend të kësaj do të përballohen drejtpërdrejt nga individët, familjet dhe bizneset, në rastet e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, gjejmë se:

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 33.9% janë përgjigjur aspak, pra nuk kanë fare informacion;
- 30.5% janë përgjigjur se kanë pak informacion;
- 25.2% se kanë deri diku informacion;
- 8.9% se kanë mjaftueshëm informacion;
- 1.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur shumë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 64.4%, nuk kanë asnjë informacion ose kanë pak informacion se cilat kosto mbulohen nga shteti nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore ose fondeve ose rezervave të dedikuara dhe çfarë humbjesh në vend të kësaj do të përballohen drejtpërdrejt nga individët, familjet dhe bizneset, në rastet e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile. Ndërkohë që vetëm 10.4% e tyre kanë mjaftueshëm dhe shumë informacion për këtë çështje.




87. Programet për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore në vendin tonë, a i kanë përmirësuar informacionet për sigurimet, mikrosigurimet, ndarjen e rrezikut, financimin e rrezikut dhe mjete të tjera të mbrojtjes financiare?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen nëse programet për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore në vendin tonë, i kanë përmirësuar informacionet për sigurimet, mikrosigurimet, ndarjen e rrezikut, financimin e rrezikut dhe mjete të tjera të mbrojtjes financiare, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen nëse programet për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore në vendin tonë, i kanë përmirësuar informacionet për sigurimet, mikrosigurimet, ndarjen e rrezikut, financimin e rrezikut dhe mjete të tjera të mbrojtjes financiare, gjejmë se:

- 21% e totalit të anketuarve janë përgjigjur aspak;
- 31.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur pak;
- 24.9% e totalit të anketuarve janë përgjigjur deri diku;
- 11.1% e totalit të anketuarve janë përgjigjur mjaftueshëm;
- 2.8% e totalit të anketuarve janë përgjigjur shumë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 52.8% të tyre, janë përgjigjur se programet për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore në vendin tonë, nuk e kanë përmirësuar aspak apo e


kanë përmirësuar pak informacionet për sigurimet, mikrosigurimet, ndarjen e rrezikut, financimin e rrezikut dhe mjete të tjera të mbrojtjes financiare. Ndërkohë për 13.9% këto programe kanë përmirësuar mjaftueshëm dhe shumë informacionet për këtë çështje.



Perceptimet mbi rolet dhe përgjegjësitë në edukimin e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

88. Sa ndikon sektori publik në vendin tonë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon sektori publik në vendin tonë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon sektori publik në vendin tonë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, gjejmë se:



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

- 16.5% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk ndikon aspak;
- 28.7% janë përgjigjur ndikon disi;
- 21.1% janë përgjigjur ndikon;
- 25% janë përgjigjur ndikon shumë;
- 4.9% janë përgjigjur se ndikon jashtëzakonisht shumë;
- 3.2% nuk e dinë;
- 0.6% janë pa përgjigje.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 51%, janë përgjigjur se sektori publik në vendin tonë ndikon, ndikon shumë e jashtëzakonisht shumë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

89. Sa ndikon sektori privat, duke përfshirë industrinë e sigurimeve, në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon sektori privat, duke përfshirë industrinë e sigurimeve, në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon sektori privat, duke përfshirë industrinë e sigurimeve, në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, gjejmë se:

- 16.6% e totalit të anketuarve janë përgjigjur nuk ndikon aspak;
- 36.6% janë përgjigjur ndikon disi;
- 27.6% janë përgjigjur ndikon;
- 13.1% janë përgjigjur ndikon shumë;
- 1.4% janë përgjigjur ndikon jashtëzakonisht shumë;
- 3.9% nuk e dinë;
- 0.7% janë pa përgjigje.

Sa ndikon sektori privat, duke përfshirë industrinë e sigurimeve, në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore



Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 42.1% e të anketuarve, janë përgjigjur se sektori privat në vendin tonë ndikon, ndikon shumë apo jashtëzakonisht shumë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

90. Sa ndikon roli i qytetarit në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon roli i qytetarit në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sa ndikon roli i qytetarit në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, gjejmë se:

- për 11.3% të totalit të anketuarve nuk ndikon aspak;
- për 22.6% ndikon disi;
- për 23.1% ndikon;
- për 29% ndikon shumë;
- për 11.5% ndikon jashtëzakonisht shumë;
- 1.8% nuk e dinë;
- 0.7% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 63.6% janë përgjigjur se roli i qytetarit ndikon, ndikon shumë e jashtëzakonisht shumë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore. Pra, të anketuarit, me shumicë vlerësojnë rolin e qytetarit në rritjen e ndërgjegjësimit për këtë çështje.



91. Sa ndikon roli i arsimit në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon roli i arsimit në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

fatkeqësitë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se sa ndikon roli i arsimit në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, gjejmë se:

- për 4.4% të anketuarve nuk ndikon aspak;
- për 18.8% ndikon disi;
- për 27.6% ndikon;
- për 31.5% ndikon shumë;
- për 14.1% ndikon jashtëzakonisht shumë;
- 2.7% nuk e dinë;
- 1% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 73.2% të tyre, janë përgjigjur se roli i arsimit ndikon, ndikon shumë dhe jashtëzakonisht shumë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.




92. Sa ndikojnë organizatat ndërkombëtare në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë organizatat ndërkombëtare në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se sa ndikojnë organizatat ndërkombëtare në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, gjejmë se:

- për 6.5% të totalit nuk ndikon aspak;
- për 34% ndikojnë;
- për 31.6% ndikojnë disi;
- për 19.3% ndikon shumë;
- për 4.4% ndikon jashtëzakonisht shumë;
- 3.8% nuk e dinë;
- 0.4% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 57.7% e të anketuarve, janë përgjigjur se roli i organizatave ndërkombëtare ndikon, ndikon shumë dhe jashtëzakonisht shumë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.



Perceptimet mbi iniciativat arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe teknikat dhe metodat e komunikimit përkatës.

93. Sipas dijenisë tuaj, çfarë lloj iniciativash arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut janë ndërmarrë më shpesh në vendin tonë në pesë vitet e fundit (në alternativat e mëposhtme)?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se sipas dijenisë së tyre çfarë lloj iniciativash arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut janë ndërmarrë më shpesh në vendin tonë në pesë vitet e fundit (në alternativat e mëposhtme), në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se sipas dijenisë së tyre çfarë lloj iniciativash arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut janë ndërmarrë më shpesh në vendin tonë në pesë vitet e fundit (në alternativat e mëposhtme), gjejmë se:


- 14.1% janë për faqet informative të internetit;
- 33.6% janë për fushatat e ndërgjegjësimit;
- 16.2% nuk e dinë;
- 2.4% janë pa përgjigje;
- 24.9% janë për shpërndarje të materialit të printuar;
- 4.5% janë për simulimet;
- 3.7% janë për stërvitjet.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 33.6%, mendojnë se fushatat e ndërgjegjësimit janë nga llojet e iniciativave arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut që janë

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


ndërmarrë më shpesh në vendin tonë në pesë vitet e fundit ndërkohë që 24.9% mendojnë për shpërndarje të materialit të printuar.



94. Kujt i janë drejtuar kryesisht nismat arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se kujt i janë drejtuar kryesisht nismat arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se kujt i janë drejtuar kryesisht nismat arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut, gjejmë se:

- për fëmijët janë 24.8% e të anketuarve;
- për popullsinë në përgjithësi janë 48.2% e të anketuarve.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 48.2% mendojnë se nismat arsimore për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut i janë drejtuar kryesisht popullsisë në përgjithësi.

95. Në kuadër të nismave të tilla arsimore, a është shoqëruar komunikimi i informacionit mbi ekspozimet ndaj rreziqeve natyrore me ilustrime praktike të veprimeve që mund të ndërmerren për të reduktuar rrezikun dhe të përfitimeve të pritshme nga këto veprime?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se në kuadër të nismave të tilla arsimore, a është shoqëruar komunikimi i informacionit mbi ekspozimet ndaj rreziqeve natyrore me ilustrime praktike të veprimeve që mund të ndërmerren për të reduktuar rrezikun dhe të përfitimeve të pritshme nga këto veprime, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se në kuadër të nismave të tilla arsimore, a është shoqëruar komunikimi i informacionit mbi ekspozimet ndaj rreziqeve natyrore me ilustrime praktike të veprimeve që mund të ndërmerren për të reduktuar rrezikun dhe të përfitimeve të pritshme nga këto veprime, gjejmë se:

- 35% e të anketuarve janë përgjigjur jo;
- 19.4% nuk e dinë;
- 35.7% janë përgjigjur po;
- 9.8% janë pa përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të konkludojmë se të anketuarit ndahen në mënyrë të barabartë në pro dhe kundër që nismat arsimore, janë shoqëruar me komunikimin e informacionit mbi ekspozimet ndaj rreziqeve natyrore me ilustrime praktike të veprimeve që mund të ndërmerren për të reduktuar rrezikun dhe të përfitimeve të pritshme nga këto veprime.



96. A është e mundur të arrijmë në disa përfundime mbi mësimet e nxjerra se cilat qasje dhe praktika funksionojnë më mirë dhe cilat jo?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se a është e mundur të arrijmë në disa përfundime mbi mësimet e nxjerra se cilat qasje dhe praktika funksionojnë më mirë dhe cilat jo, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve të


AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

anketuarve për pyetjen se në kuadër të nismave të tilla arsimore, a është e mundur të arrijmë në disa përfundime mbi mësimet e nxjerra se cilat qasje dhe praktika funksionojnë më mirë dhe cilat jo, gjejmë se:

- për 18.6% jo, nuk mund të arrijmë në përfundime;
- për 60.3% po, mund të arrijmë në përfundime;
- 12.2 nuk e dinë;
- 8.9% nuk kanë përgjigje.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 60.3% mendojnë se është e mundur të arrijmë në disa përfundime mbi mësimet e nxjerra se cilat qasje dhe praktika funksionojnë më mirë dhe cilat jo.




97. Deri në çfarë mase mendoni se mesazhet e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe edukimit në vendin tonë, janë në përputhje me “mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit”?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se deri në çfarë mase mendojnë se mesazhet e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe edukimit në vendin tonë, janë në përputhje me “mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit”, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se deri në çfarë mase mendojnë se mesazhet e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe edukimit në vendin tonë, janë në përputhje me “mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit”, gjejmë se:

- për 11% të anketuarve nuk janë aspak në përputhje me mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit;
- për 40.2% janë deri diku;
- për 11.8% janë mjaftueshëm;
- për 35.9% janë pak;
- për 1.1% janë shumë në përputhje me mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se vetëm 12.9% e të anketuarve mendojnë se mesazhet e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe edukimit në vendin tonë, janë mjaftueshëm dhe në përputhje me “mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit”. Ndërkohë që 46.9% janë aspak apo pak dakord me këtë.




98. Krijimi i programeve arsimore me fokus në simulimet dhe stërvitjet për reagim ndaj fenomeneve natyrore dhe emergjencave civile, a duhet të jenë prioritet nga programet e edukimit/ndërgjegjësimit mbi këto çështje?

Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen se nëse krijimi i programeve arsimore me fokus në simulimet dhe stërvitjet për reagim ndaj fenomeneve natyrore dhe emergjencave civile, a duhet të jenë prioritet nga programet e edukimit/ndërgjegjësimit mbi këto çështje, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë. Nga studimi i përgjigjeve e të anketuarve për pyetjen se nëse krijimi i programeve arsimore me fokus në simulimet dhe stërvitjet për reagim ndaj fenomeneve natyrore dhe emergjencave civile, a duhet të jenë prioritet nga programet e edukimit/ndërgjegjësimit mbi këto çështje, gjejmë se:

- 79.7% e të anketuarve përgjigjen po, duhet të jetë prioritet;
- për 10.2%, jo.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 79.7% mendojnë se krijimi i programeve arsimore me fokus në simulimet dhe stërvitjet për reagim ndaj fenomeneve natyrore dhe emergjencave civile, duhet të jenë prioritet nga programet e edukimit/ndërgjegjësimit mbi këto çështje.



AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

8. Gjetjet dhe përfundimet kryesore

Bazuar në analizën e gjetjeve, në përmbyllje të këtij punimi mund të arrihet në këto përfundime kryesore:

a. Nga përdorimi i metodës kërkimore cilësore, hulumtim literature, strukturim, informacioni, analizë, sintezë e studim rasti.

- Elementet kryesorë të konceptit *komunitet* janë të qenit një bashkësi njerëzish që jetojnë në një hapësirë gjeografike, që kanë elementë të kulturës dhe institucione të përbashkëta dhe bashkëveprojnë me aktorë e grupe të tjera brenda këtij territori si organizatat e shoqërisë civile, policinë dhe autoritetet lokale, të cilët janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të sigurisë dhe të tjera në atë zonë.

- Siguria në komunitet apo sigurinë e komunitetit mund ta përcaktojmë si gjendja në të cilën arrihen nevojat e përbëra të sigurisë dhe mirëqenies kolektive të një komuniteti. Në një farë mënyrë është funksionalizimi i sigurisë njerëzore apo sigurisë dhe rendit publik në nivelin e një komuniteti lokal.

- Konceptet kryesore që ndërthuren me sigurinë në komunitet dhe mirëqenien janë rreziku, cenueshmëria dhe dëmi (dëmtimi). Nevojat për sigurinë dhe mirëqenien e një komuniteti plotësohen kur kushtet e rrezikut zbuten, cenueshmëria zvogëlohet dhe shfaqja e dëmit është zero.

- Fenomenet ekstreme të natyrës përbëjnë rrezik e kërcënim jo vetëm për sigurinë e komunitetit, por dhe më gjerë për sigurinë kombëtare, rajonale e ndërkombëtare.

- Në Shqipëri është evidentuar aftësia e dobët institucionale dhe niveli i ulët i burimeve për t'u përballur me kërkesat e fatkeqësive masive si dhe pjesëmarrja e pamjaftueshme

e bashkësive vendore në menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe emergjencat.

- Forcimi i sigurisë në komunitet arrihet nëpërmjet një qasje proaktive dhe jo reaktive në trajtimin e fatkeqësive natyrore.

- Siguria e komunitetit është e lidhur me menaxhimin sa më të mirë të emergjencave dhe përfshirja e komunitetit në këtë menaxhim ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë së tij. Procesi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet çon në përmirësime progresive në sigurinë publike dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj fatkeqësive.

b. Nga përdorimi i metodës kërkimore sasiore, duke përdorur si instrument kërkimor pyetësorin e standardizuar.

Perceptimet e rrezikut nga fenomenet ekstreme të natyrës:

- Në analizën krahasuese lidhur me perceptimin e nivelit të rrezikut për sigurinë nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë, në raport dhe me rreziqet e tjera, mund të konkludojmë se të anketuarit vlerësojnë si më të rrezikshme për sigurinë e tyre me rend zbritës: aksidentet automobilistike në masën 84.1%; pandemitë/epidemitë, (82.9%); tërmetet (73.1%); krimi mjedisor (55.4%); krimi i organizuar (55.1%); zjarret (53.9%); përmblyet (52.6%); thatësitat e tejzgjatura (36.4%); sulmet terroriste (29.9%); uraganet/stuhitë (22.4%); incidentet radioaktive (20.1%).

Në raport me rreziqet e tjera, vetëm aksidentet automobilistike perceptohen si më të rrezikshme për sigurinë e të anketuarve se sa fatkeqësitë natyrore.

Krahasuar me anketimin e kryer dy vite më pare, mund të konkludojmë se ndonëse është ruajtur renditja, ka një rritje të perceptimit të rrezikut për sigurinë pothuajse në të gjithë treguesit e mësipërm.

Kjo mund të shpjegohet me rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj rreziqeve që vijnë për sigurinë e tyre nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore; shtrirjen e anketimit në vitin 2022 “derë me derë” dhe në të 12 qarqet e vendit (anketimi i mëparshëm është bërë *online* ku 85.4% ishin nga qyteti dhe 80% në zonën Tiranë-Durrës); nivelin arsimor me të ulët të anketuarve në vitin 2022, për pasojë me më pak njohuri në këtë fushë (në vitin 2020 mbizotëronte arsimi i lartë kurse në vitin 2022 shumica e të anketuarve janë me arsim të mesëm).

Perceptimi mbi përgjegjësinë e menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjencat civile dhe nivelin e përgatitjeve për përballimin e tyre:

- Shumica e të anketuarve mendojnë që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje (76%); menaxhimi i tyre është kryesisht detyrë e shtetit (67.9%) nuk janë përgatitur për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë (33.5%); nuk mendojnë (34.2%) se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi e më tej nga shteti. Pra, edhe sigurinë e tyre individuale, në rast të fatkeqësive natyrore, e presin nga shteti.

Perceptimi mbi sa e ku duhet investuar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencat civile:

- Në analizë krahasuese lidhur me perceptimin se sa e ku duhet investuar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencat civile mund të konkludojmë se për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile shumica e të anketuarve mendojnë se duhet investuar më shumë në ligjet dhe

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile (95.4%); në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile (95.3%); në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me to (94.8%); në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuere të publikut të gjerë (81.8%); në edukimin në arsimin para universitar dhe universitar (67.8%); në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e tyre (67%).

Krahasuar me anketimin e kryer dy vite më parë, mund të konkludojmë se, ndonëse është ruajtur renditja, ka një rritje të ndjeshme treguesve për drejtimit e mësipërme të investimeve për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Matja e nivelit të informimit mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile si dhe përgjegjësitë individuale në raste të tilla:

- Shumica e të anketuarve nuk kanë informacion të plotë dhe të hollësishëm mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile (35.3%) si dhe për mekanizmat e sigurisë publike, që duhet të aktivizohen në raste të tilla (37.4%).

- Për shumicën e të anketuarve (34.8%) burimi më i mirë për informim në komunitetin e tyre, lidhur me një katastrofë dhe/ose situatë emergjente është media elektronike *online* ndërsa, për 26.2% është familja. Më pak, për 3.8% janë njoftimet zyrtare. Krahasuar me anketimin e bërë dy vite më parë, gjejmë se njoftimet zyrtare nga vendi i parë si burim njoftimi me (45.7%), në vitin 2022 është në vend të fundit me 3.8%. Media elektronike/*online* nga 8.8% është rritur në 34.8%, ndërsa familja si burim është rritur nga 3.3% në 26.2%. Televizionet si burim informimi kanë shënuar një ulje nga 25.4% në 13.2%.

- Shumica e të anketuarve kanë kontaktuar të parën Policinë e Shtetit (36.1% e rasteve) si dhe strukturat vendore dhe qendrore përgjegjëse për përballjen dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile në 30.1% të rasteve, në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile.

Matja e shkallës së përgatitjeve për menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile:

- Shumica e të anketuarve (69.6%) mendojnë se në përgatitjen e një plani të menaxhimi në raste të tilla duhet t'i ndihmojnë institucionet shtetërore; nuk kanë njohuri për aktet ligjore apo politikë që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri (68.5%); janë prekur nga katastrofa natyrore (38.4%). Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje në treguesit e mësipërm.

- Shumica e të anketuarve (55.4%) pohojnë se nuk kanë siguruar furnizimin me ujë (55.4%) dhe ushqim (53.9%) në një në rast urgjence ose fatkeqësie, për një minimum prej 72 orësh.

- Shumica e të anketuarve, në rastet emergjente nuk janë përgatitur: për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike (66.7%); për të pasur mjaftueshëm elektrikë dore ose burime drite (54%); me mjete evakuimi (80.9%); më kuti të ndihmës së parë (56.4%); që të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin (85.4%); të kenë produkte të nevojshme higjienosanitare (41.6%); të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore (78.8%); të kenë një sasi të hollash në raste urgjencash (37.6%); të

kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia (77.9 %); të kenë pajisje për fëmijët (83%); të kenë pajisjet për të moshuarit (85.7%); të kenë një plan evakuimi (83%); të kenë një plan operacional të urgjencës (84.1%); të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës (75.9%). Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje në përqindje të të anketuarve që, për rastet emergjente, nuk janë përgatitur për alternativat e mësipërme.

Perceptimi lidhur me shkaqet, pasojat dhe masat për reduktimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile:

- Shumica e të anketuarve janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile: reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave (75%) dhe që po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën (77.1%); që urbanizimi i shpejtë është faktor në ndodhitë e tilla (66.2%).

- Nga analiza e treguesve lidhur me perceptimin e të anketuarve për shkaqet, e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, mund të konkludojmë se shumica e tyre mendojnë se në fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile si faktorë ndikojnë dhe ndikojnë shumë: zjarret e qëllimshme (81.4%); shpyllëzimi (80%); mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore (77.1%); ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit (73.6%); djegia lëndëve të rrezikshme (68.9%); mbipopullimi (63%); mbeturinat bujqësore (46.6%); bioterrorizmi (46.3%). Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje në kategorinë e të anketuarve që vlerësojnë si faktorë që ndikojnë dhe ndikojnë shumë djegien e lëndëve të rrezikshme, mbipopullimin; zjarret e qëllimshme dhe shpyllëzimi.

Matja e nivelin të njohurive dhe të shqetësimit për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore:

- Nga analiza e treguesve lidhur me matjet e nivelit të njohurive për menaxhimin e rrezikut të katastrofave mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si: të incidenteve radioaktive (89.6%); uraganet/stuhitë (86.9%); thatësirat e tej zgjatura (83.1%); përmbytjet (70.9%); të zjarreve (67.4%); tërmetet (60%); të pandemive/epidemive (39.2%). Krahastuar me anketimin e kryer dy vite më parë, në vitin 2022, ka një rritje të konsiderueshme në kategorinë e të anketuarve që kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të mësipërme.

- Nga analiza e treguesve lidhur me matjen e nivelin e shqetësimit në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore, mund të konkludojmë se shumica e të anketuarve janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e: pandemive/epidemive dhe të pasojave të tyre (74.7%); uraganeve/furtunave 73.7%); incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre (72.7%); thatësirave të tejzgjatura (65%); tërmeteve (60.8%); e përmbytjeve (52.8%); e zjarreve (50.1%). Krahastuar me të dhënat e anketimit të kryer dy vite më parë, në përgjithësi ka një rritje në kategorinë e të anketuarve që janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e katastrofave natyrore.

- Shumica e të anketuarve: nuk e dinë nëse merr pjesë vendi ynë në ndonjë strategji të menaxhimit të katastrofave natyrore në nivel rajonal apo ndërkombëtar (43.3%);

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

nuk mendojnë se ndërgjegjësimi/edukimi për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore është një komponent i strategjisë së menaxhimit të katastrofave natyrore (29.7%); nuk e dinë se sa për qind e burimeve publike janë ndarë çdo vit për zbatimin e kësaj strategjie, i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe përpjekjeve arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (38%), ndonëse, e dinë se çdo vit shpërndahen burime publike për zbatimin e kësaj strategjie (42.8%).

Vlerësimi i nevojave, priorizimi i burimeve, monitorimi dhe vlerësimi i përpjekjeve:

- Shumica e të anketuarve: nuk kanë informacion nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore (33.9%); nuk kanë ndonjë shembull konkret, që vendi ynë ka kryer një vlerësim të tillë (75.5 %); nuk mendojnë që është bërë një vlerësim ndaj nismave ekzistuese të edukimit për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut (46.7%); nuk mendojnë, që janë prioritet programet ekzistuese arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë (52.7%); mendojnë që nuk janë kryer vlerësime periodike të përpjekjeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vendin tonë (49.2%); mendojnë se nuk ka mënyra përmes të cilave, monitorohen efektet e përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe edukim për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile (43.5%).

Matja e nivelit të informim mbi efektet ekonomike të fatkeqësive, mbulimi i sigurimit dhe mjete të tjera të menaxhimit financiar:

- Të anketuarit: vetëm 15.7% mendojnë që përpjekjet për edukimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, synojnë mjaftueshëm dhe shumë të informojnë dhe për pasojat ekonomike të rreziqeve natyrore dhe kostot që lidhen me ngjarjet e fatkeqësive; shumica (64.4%) nuk kanë asnjë informacion ose kanë pak informacion se cilat kosto mbulohen nga shteti nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore ose fondeve, ose rezervave të dedikuara dhe çfarë humbjesh në vend të kësaj do të përballohen drejtpërdrejt nga individët, familjet dhe bizneset, në rastet e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile; shumica (52.8%) mendojnë se programet për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore në vendin tonë, nuk e kanë përmirësuar aspak apo e kanë përmirësuar pak informacionet për sigurimet, mikrosigurimet, ndarjen e rrezikut, financimin e rrezikut dhe mjete të tjera të mbrojtjes financiare.

Perceptimet mbi rolet dhe përgjegjësitë në edukimin e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë:

- Shumica e të anketuarve, mendojnë se ndikon, ndikon shumë e jashtëzakonisht shumë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe edukimin për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore: roli i arsimit (73.2%); roli i qytetarit (63.6%); roli i organizatave ndërkombëtare (57.7%); sektori publik (51%); sektori privat (42.1%).

Perceptimet mbi iniciativat arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe teknikat dhe metodat e komunikimit përkatës:

- Shumica e të anketuarve mendojnë se nismat arsimore: në vendin tonë në pesë vitet e fundit më të shpeshta janë fushatat e ndërgjegjësimit për reduktimin e rrezikut

(33.6%); i janë drejtuar kryesisht popullsisë në përgjithësi (48.2%); janë shoqëruar me komunikimin e informacionit mbi ekspozimet ndaj rreziqeve natyrore me ilustrime praktike të veprimeve që mund të ndërmerren për të reduktuar rrezikun dhe të përfitimeve të pritshme nga këto veprime (35%).

- Shumica e të anketuarve, mendojnë se: është e mundur të arrijmë në disa përfundime mbi mësimet e nxjerra se cilat qasje dhe praktika funksionojnë më mirë dhe cilat jo (60.3%); mesazhet e ndërgjegjësimit për rrezikun dhe edukimin në vendin tonë, janë deri diku dhe mjaftueshëm në përputhje me “mjetet efektive të komunikimit dhe edukimit” (52%); krijimi i programeve arsimore me fokus në simulimet dhe stërvitjet për reagim ndaj fenomeneve natyrore dhe emergjencave civile, duhet të jenë prioritet nga programet e edukimit/ndërgjegjësimit mbi këto çështje (79.7%).

9. Rekomandimet kryesore dhe politikat

Bazuar në analizën e përfundimeve të projektit kërkimor “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile”, në përmbyllje të këtij studimi mund të jepen këto rekomandime kryesore:

- Rritja e sigurisë së komunitetit përballë fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile të jetë pjesë e rëndësishme e politikave që synojnë krijimin e komuniteteve të sigurta.

- Procesi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë duke u bazuar në komunitet të konceptohet si një filozofi veprimi që çon në përmirësime progresive të sigurisë publike dhe qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile.

- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie efikase të komunikimit për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe edukimin e tij me njohuritë e duhura, në nivel grupi dhe individ, për menaxhimin e katastrofave natyrore e teknologjike.

- Mbështetja e politikave për rritjen e shkallës së informimit të publikut mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile, për mekanizmat e sigurisë publike, që duhet të aktivizohen në rast të tilla si dhe për përgjegjësitë që qytetarët duhet të marrin për sigurinë e tyre individuale.

- Mbështetja e programeve për trajnimet në komunitet për t’u përballur me çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile që mund të ndodhë, përfshirë dhe hartimin e një plani emergjence familjare dhe nxitjen e sigurimit të jetës e pronës në raste të fatkeqësive natyrore.

- Vlerësimi periodik i kapacitetit rezistues të popullsisë në rast ndodhje të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

- Simulimet dhe stërvitjet për reagim ndaj fenomeneve natyrore dhe emergjencave civile të jenë prioritare në programet e edukimit/ndërgjegjësimit mbi këto çështje.

- Gjetja e formave dhe metodave për nxitjen e përgatitjeve materiale të komunitetit për t’u përballur me një situatë urgjence/fatkeqësie duke siguruar furnizimin në të tilla situata me: minimumin 72 orë me ujë dhe me ushqime; një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike; mjaftueshëm elektrikë dore ose burime drite; mjete evakuimi në rastet emergjence ose fatkeqësie; kuti të ndihmës së parë; një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin; produkte të nevojshme higjienosanitare; kuti për raste

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

fatkeqësish natyrore; telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë; sasi të hollash në rast urgjence ose fatkeqësie; mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia; pajisje për fëmijët; pajisjet për të moshuarit; një plan evakuimi e një plan operacional të urgjencës; me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës.

- Fuqizimin e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse të emergjencave civile nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe mbështetjes logjistike për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile në rastet e fenomeneve ekstreme të natyrës.

- Shqyrtimi i mundësisë që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), për të përmbushur sa më mirë misionin e saj si autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në shkallë kombëtare, të mos jetë në vartësi të një ministrie, por në varësi të Këshillit të Ministrave.

- Forcimi dhe përmirësimi i legjislacionit për fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile në Shqipëri, nxjerrja në kohë e akteve nënligjore si dhe hartimi i protokolleve përkatëse për strukturat përgjegjëse, duke përcaktuar qartë kush bën çfarë.

- Rritja dhe konsolidimi i bashkëpunimit mes sektorit publik, privat dhe individit për çështjet e reagimit kundrejt fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile dhe përballimit të pasojave të tyre.

- Hartimi i kurrikulave në arsimin para universitar dhe universitar dhe përmirësimi e pasurimi i tyre me njohuritë e nevojshme për përballimin dhe menaxhimin e situatave në raste të fenomeneve ekstreme të natyrës.

- Mbështetja e politikave afatgjata për reduktimin e faktorëve që ndikojnë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, si shpyllëzimi; ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit; zjarret e qëllimshme; mosndëshkimin e individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore; niveli në ulje i biodiversitetit; urbanizimin e shpejtë; bioterrorizmin; mbipopullimin; mbeturinat bujqësore e djegien e fosileve.

- Miratimi i një Strategjie Kombëtare për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore e teknologjike, si dokumenti kryesor i politikave për të parandaluar dhe zvogëluar rrezikun nga këto fatkeqësi, nëpërmjet përfshirjes së tërë shoqërisë e të institucioneve shtetërore në këtë proces.

10. Gjetje dhe përfundime të detajuara

Perceptimet e rrezikut nga fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore:

1. Nga tërmetet në Shqipëri 73.1% e të anketuarve ndihen të rrezikuar, shumë dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar. Ndërkohë që, 26.9% e të anketuarve ndihen pak dhe aspak të rrezikuar. Pra, tërmeti perceptohet si rrezik për sigurinë e rreth $\frac{3}{4}$ të anketuarve.

Krahasuar me një anketim të tillë të zhvilluar në vitin 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen aspak dhe pak të rrezikuar nga tërmetet ka rënë nga 50.4% në 26.9%. Pra, vetëm në dy vite është ulur me 23.5% numri i atyre që ndihen pak apo aspak të rrezikuar nga tërmetet.

2. Nga përmbytjet në Shqipëri shumica e të anketuarve (52.6%), ndihen të rrezikuar,

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar, ndërkohë që 47.4% ndihen pak dhe aspak të rrezikuar. Pra, përmbytjet përbëjnë rrezik për sigurinë e më shumë se gjysmës të anketuarve.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen aspak dhe pak të rrezikuar ka rënë nga 78% e të anketuarve në 47.4%. Pra, në vetëm 2 vjet, është rritur me 30.6% ndjeshmëria ndaj rrezikut të përmbytjeve.

3. Nga thatësirat e tejzgjatura në Shqipëri e shumica e të anketuarve, 63.5% e tyre, ndihen pak dhe aspak të rrezikuar, ndërkohë që vetëm 36.4% ndihen shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Pra, thatësirat e tej zgjatura përbëjnë rrezik për sigurinë e 36.4% të të anketuarve.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen aspak dhe pak të rrezikuar nga thatësirat e tejzgjatura ka rënë nga 80.4% e të anketuarve në 63.5%. Ndërkohë që numri i atyre që ndihen të rrezikuar është rritur nga 19.6% në 36.4%.

4. Nga uraganet/stuhitë në Shqipëri shumica e të anketuarve, (77.6%), ndihen pak dhe aspak të rrezikuar nga uraganet/stuhitë në Shqipëri, ndërkohë që 22.4% ndihen, te rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Pra, uraganet/stuhitë përbëjnë rrezik për sigurinë e 22.4% të anketuarve.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar nga uraganet/stuhitë në Shqipëri është dyfishuar, nga 11.3% në 22.4%. Pra, është rritur perceptimi edhe për uraganet e stuhitë si rrezik për sigurinë, ndonëse jo me përmasat e kërcënimeve të tjera.

5. Nga zjarret në Shqipëri shumica e të anketuarve, 53.9% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar. Ndërkohë 46.2% e tyre, ndihen pak dhe aspak të rrezikuar nga zjarret në Shqipëri. Pra, zjarret përbëjnë rrezik për sigurinë e 53.9% e të anketuarve.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se numri i të anketuarve që ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar nga zjarret në Shqipëri nga 27.3% në 53.9% e të anketuarve. Pra, në dy vite është rritur dyfish perceptimi i rrezikut nga zjarret.

6. Nga incidentet radioaktive shumica e të anketuarve (55.1%) ndihen aspak të rrezikuar nga incidentet radioaktive, ndërkohë që 20.1% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se ka një rënie (4.6%) të numrit të të anketuarve që ndihen aspak të rrezikuar nga incidentet radioaktive. Ndërkohë që, ka një rritje me 8.7% që ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar.

7. Nga sulmet terroriste shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 47.5%, ndihen aspak të rrezikuar nga sulmet terroriste, ndërkohë që 29.9% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht të rrezikuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, rezulton se ka një rritje të atyre që ndihen të rrezikuar (nga 13.6% në 29.9%).

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

8. Nga pandemitë/epidemitë shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 82.9%, ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga pandemitë/epidemitë. Ndërkohë që vetëm 17% ndihen pak dhe aspak të rrezikuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020 ka një rënie nga 40.9% në 17% të tyre ndihen aspak dhe pak të rrezikuar dhe një rritje me 23.8% të atyre që perceptojnë një rritje rreziku nga pandemitë/ epidemitë. Pra, në vetëm dy vite ka një rritje me 23.8 % të perceptimit se pandemitë/ epidemitë përbëjnë rrezik për sigurinë.

9. Nga krimi mjedisor shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 55.4%, janë përgjigjur se ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar. Ndërkohë që 17.6% nuk ndihen aspak të rrezikuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020 kemi një rritje prej rreth 5% (nga 50.1% në 55.4%) e të anketuarve që ndihen të rrezikuar nga krimi mjedisor. Pra, ka një rritje të perceptimit për krimin mjedisor si rrezik për sigurinë.

10. Nga krimi i organizuar shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 55.1% ndihen të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar nga krimi i organizuar.

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një ulje me 10% në kategorinë e të anketuarve që ndihen aspak apo pak të kërcënuar nga krimi i organizuar dhe një rritje me 10% në kategorinë e të anketuarve që ndihen të rrezikuar (të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar) nga krimi i organizuar. Pra, ka një rritje të perceptimit për rrezikun nga krimi i organizuar.

11. Nga aksidentet automobilistike shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 84.1%, ndihen të rrezikuar (të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar).

Krahasuar me anketimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një rënie me 23.2% në kategorinë e të anketuarve që ndihen pak dhe aspak të rrezikuar si dhe një rritje po me 23.2% në kategorinë e të anketuarve që ndihen të rrezikuar (të rrezikuar, shumë të rrezikuar dhe jashtëzakonisht shumë të rrezikuar) nga aksidentet automobilistike. Pra, në dy vite ka një rritje me 23.3% të perceptimit të rrezikut për sigurinë nga aksidentet automobilistike.

Perceptimi mbi përgjegjësinë e menaxhimit të fatkeqësive natyrore/ emergjencat civile dhe nivelin e përgatitjeve për përballimin e tyre:

12. Shumica e të anketuarve (76%) janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje. Krahasuar me anketimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një rritje me 4.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë dakord me pohimin që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri në rritje.

13. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 67.9%, janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit.

Edhe në anketimin e vitit 2020 po 67.9%, kanë qenë dakord dhe shumë dakord që

fatkeqësitë natyrore/emergjencave civile janë fenomene, menaxhimi i të cilave është kryesisht detyrë e shtetit.

14. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 35% ndihen pjesërisht të përgatitur, ndërkohë që 33.5% nuk janë përgatitur për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë.

Gjithashtu, vetëm 26.1% e të anketuarve janë dakord dhe shumë dakord me pohimin, pra, vetëm 26.1% ndihen se janë të përgatitur për çdo fatkeqësi natyrore/emergjencë civile, që mund të ndodhë.

Perceptimi mbi sa e ku duhet investuar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencat civile:

15. Për shumicën e të anketuarve me një përfaqësim prej 67.8%, duhet investuar mjaftueshëm dhe shumë në edukimin në arsimin para universitar dhe universitar për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile. Në anketimin e vitit 2022, në këto dy kategori janë përfshirë vetëm 20.9% e të anketuarve. Pra, në dy vite, ka një trefishim të numrit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar në fushën e edukimit në arsimin para universitar dhe universitar për parandalimin/menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe/ose emergjencave civile.

16. Pjesa më e madhe e të anketuarve (67%), mendojnë se për të përmirësuar sigurinë, duhet investuar mjaftueshëm dhe shumë në trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e fatkeqësive natyrore/menaxhimin e emergjencave civile. Në anketimin e vitit 2022, në këto dy kategori janë përfshirë 72.3% e të anketuarve.

17. Për shumicën e të anketuarve, me një përfaqësim prej 81.8%, duhet investuar mjaftueshëm dhe shumë në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut të gjerë për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore.

Në anketimin e vitit 2022, në këto dy kategori (mjaftueshëm dhe shumë) janë përfshirë 67.9% e të anketuarve. Pra, ka një rritje me 13.9% të vlerësimit se duhet investuar në fushatat dhe takimet ndërgjegjësuese të publikut, për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore.

18. Shumica e të anketuarve 95.4% mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla.

Krahasuar me dy vite me parë, ka një rritje me 3.5% në grupit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në ligjet dhe politikat mbi përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe menaxhimin e emergjencave civile, për të përmirësuar sigurinë.

19. Shumica e të anketuarve (95.3%) mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile për të përmirësuar sigurinë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

Krahasuar me dy vite me parë, ka një rritje me 3.5% në grupit të anketuarve që

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në ndikimin ekonomik të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile për të përmirësuar sigurinë në rast të tilla.

20. Shumica e të anketuarve 94.8% mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për të përmirësuar sigurinë në raste të tilla.

Krahasuar me dy vite më parë, ka një rritje me 1.7% në grupit të anketuarve që mendojnë se duhet investuar (deri diku, mjaftueshëm dhe shumë) në rritjen e nivelit të përgatitjes të strukturave përgjegjëse për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile për të përmirësuar sigurinë në raste të tilla.

Matja e nivelit të informimit mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile si dhe përgjegjësitë individuale në raste të tilla:

21. Shumica e të anketuarve (35.3%) nuk kanë informacion të plotë dhe të hollësishëm mbi çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në nivel qendror dhe lokal në rast fatkeqësish natyrore/emergjencave civile. Kjo shifër është 24.5% më e lartë se dy vite më parë. Ndërkohë, vetëm 6.2%, janë dakord dhe shumë dakord me pohimin, pra që kanë informacion të plotë çështjet e sigurisë publike, për të cilat janë përgjegjëse strukturat e shtetit në këtë fushë. Në anketimin e dy viteve më parë kjo kategori përfaqësonte 36.2% të anketuarve, pra ka një rënie prej 30%.

22. Shumica e të anketuarve (37.4%) nuk kanë aspak informacion për mekanizmat e sigurisë publike, që duhet të aktivizohen në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, shifër kjo me 22.5% më e lartë se dy vite më parë për këtë kategori të anketuarish. Dakord dhe shumë dakord me pohimin janë 8% e të anketuarve, shifër kjo 23.9% më e vogël se dy vite më parë. Pra, ka një rritje të ndjeshme të shifrave të atyre që nuk janë të informuar për mekanizmat e sigurisë publike, që duhet të aktivizohet në rast të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

23. Shumica e të anketuarve (34.2%) janë pak dakord që në rast të fatkeqësive natyrore, siguria individuale, në fazën emergjente, duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi, më tej nga shteti, shifër kjo me 27.1% më e madhe se dy vite më parë. Kështu, 18.3% nuk janë aspak dakord, shifër kjo dy herë më e madhe se dy vite më parë. Dakord dhe shumë dakord me pohimin kanë qenë 19.6% e të anketuarve ose 38.1% më pak se dy vite më parë. Pra, shumica e të anketuarve nuk mendojnë se siguria individuale, në fazën emergjente duhet të jetë në fokus kryesisht nga vetë individi e më tej nga shteti. Pra, edhe sigurinë e tyre individuale e presin nga shteti.

24. Shumica e të anketuarve 37.7% janë dakord dhe shumë dakord me pohimin se shteti duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikas të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, ndonëse, krahasuar me dy vite më parë, kjo kategori e të anketuarve ka shënuar një rënie me 41.8%. Vetëm 5.8% nuk

janë aspak apo janë pak dakord me pohimin. Pra, pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë dhe pohojnë se shteti duhet të ofrojë mekanizma më të besuar, transparentë dhe efikase të sigurisë në rast të fatkeqësive natyrore/emergjencave civile.

25. Për 34.8% të anketuarve burimi më i mirë për informim në komunitetin e tyre, lidhur me një katastrofë dhe/ose situatë emergjente është media elektronike online ndërsa, për 26.2%, është familja. Më pak, për 3.8%, janë njoftimet zyrtare.

Krahasuar me anketimin e bërë dy vite më parë, shohim se njoftimet zyrtare nga vendi i parë si burim njoftimi me (45.7%), në vitin 2022 është në vend të fundit me 3.8%. Media elektronike/online nga 8.8% është rritur në 34.8%, ndërsa familja si burim është rritur nga 3.3% në 26.2%. Televizionet si burim informimi kanë shënuar një ulje nga 25.4% në 13.2%.

26. Shumica e të anketuarve kanë kontaktuar të parën Policinë e Shtetit (36.1% e rasteve) si dhe strukturat vendore dhe qendrore përgjegjëse për përballjen dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile në 30.1% të rasteve, në rast të një fatkeqësie natyrore/emergjence civile.

Matja e shkallës së përgatitjeve për menaxhimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile:

27. Shumica e të anketuarve (69.6%) mendojnë se në përgatitjen e një plani të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile, ata dhe komuniteti i tyre duhet t'i ndihmojnë institucionet shtetërore, ndonëse krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, kjo shifër ka shënuar një rënie 13.4%. Ka shënuar një rritje me 6.6% kategoria e të anketuarve që besojnë se këtë punë mund të bëjnë grupet vullnetare dhe 2.3% kategoria që beson se këtë punë mund të bëjnë organizatat jofitimprurëse. Pra, shumica mendojnë se për përgatitjen e planit të menaxhimit të fatkeqësive natyrore/emergjence civile duhet t'i ndihmojnë institucionet shtetërore, ndonëse ka një rritje të besimit në grupet vullnetare dhe OJF-të.

28. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 68.5%, janë përgjigjur se nuk kanë njohuri për aktet ligjore apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë shohim që ka një rritje me 29.7% në kategorinë e të anketuarve që nuk kanë njohuri për ligjet apo politikat që zbatohen për menaxhimin e katastrofave në Shqipëri. Gjithashtu ka një rënie me 23.6% në kategorinë e të anketuarve që nuk kanë njohuri në këtë fushë.

29. Shumica e të anketuarve (61.6%) nuk janë prekur nga ndonjë katastrofë. Ndërkohë që, 38.4% e tyre janë prekur nga katastrofa. Pra, është relativisht e lartë shifra e të anketuarve që janë prekur nga një katastrofë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rënie me rreth 4% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë prekur ata ose familja e tyre nga një katastrofë si dhe rritje prej 10.2% në kategorinë e të anketuarve që janë prekur nga një katastrofë.

30. Shumica e të anketuarve (55.4%) pohojnë se nuk kanë siguruar furnizimin me ujë në një rast urgjence ose fatkeqësie, për një minimum prej 72 orësh, përkundëjt

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

29.7% të tyre të cilët deklarojnë se e kanë siguruar një furnizim të tillë. Ndërkohë që 8.3% janë në proces të sigurimit të këtij furnizimi. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 18.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për një situatë të tillë si dhe një rënie me 16.4% në kategorinë e atyre që pohojnë se kanë siguruar furnizimin me ujë në një situatë të tillë.

31. Shumica e të anketuarve (53.9%) pohojnë se kanë siguruar furnizimin me ushqim në një rast urgjence ose fatkeqësie, për një minimum prej 72 orësh, përkundërt 28% të tyre të cilët deklarojnë se nuk kanë siguruar një furnizim të tillë. Ndërkohë, 6.3% të tyre nuk e dinë dhe 11.8% janë në proces të sigurimit të këtij furnizimi. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rënie me 7.1% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë përgatitur për një situatë të tillë emergjente, ndërkohë që ka një rritje me 4.5% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një minimum prej 72 orësh furnizimi me ushqim.

32. Shumica e të anketuarve (66.7%) pranojnë se nuk janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike, përkundërt 17.9% të anketuarve të cilët pohojnë se janë përgatitur për një mënyrë komunikimi. Ndërkohë, 7.9 % janë në proces të kësaj përgatitje. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 14.1% në kategorinë e të anketuarve të cilët nuk janë përgatitur për një situatë të tillë emergjente, ndërkohë që ka një rënie 12% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një mënyrë komunikimi e cila nuk varet nga energjia elektrike.

33. Shumica e të anketuarve (54%) pohojnë se nuk janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrikë dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie ndërkohë që, 28.3% janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrikë dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie. Gjithashtu, 11.4% e të anketuarve janë në proces të përgatitjes për të pasur të tillë mjete ndriçimi. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje me 13.7% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për të pasur mjaftueshëm elektrikë dore ose burime drite në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 12.9% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

34. Shumica e të anketuarve (80.9%) pohojnë se nuk janë përgatitur me mjete evakuimi në rastet emergjente, ndërkohë që 7.2% janë përgatitur me mjete të tilla. Gjithashtu 14.4% janë në proces përgatitje. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë ka një rritje me 16.3 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur me mjete evakuimi në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 8.8% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

35. Shumica e të anketuarve (56.4%) pohojnë se nuk janë përgatitur mjaftueshëm me kuti të ndihmës së parë në rastet emergjente, ndërkohë që 25.3% janë përgatitur për këtë. Gjithashtu, 13.5% janë në proces përgatitje. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 18.1% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë mjaftueshëm kuti të ndihmës së parë në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 17.1% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

36. Shumica e të anketuarve (85.4%) pohojnë se nuk janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie, përkundrajt vetëm 5.6 % që janë përgatitur. Ndërkohë që, 5.3% janë në proces përgatitje. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 11.1% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë një sistem alarmi për familjen dhe komunitetin në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 4.8% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

37. Shumica e të anketuarve (41.6%) pohojnë se nuk janë përgatitur të kenë produkte të nevojshme higjeno-sanitare në rast urgjence ose fatkeqësie, përkundrajt 38.3% që janë përgatitur. Ndërkohë që 12.7% janë në proces përgatitje. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 19.6 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë produkte të nevojshme higjenosanitare në rast urgjence ose fatkeqësie si dhe një ulje me 25.3 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

38. Shumica e të anketuarve (78.8%) pohojnë se nuk janë përgatitur t'i kenë kutitë për raste fatkeqësish natyrore, përkundrajt 8.6 % të cilët janë përgatitur të kenë të tilla kuti. Ndërkohë që 8.9% prej tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 19.6% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur të kenë kuti për raste fatkeqësish natyrore si dhe një ulje me 16.2% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur për një situatë të tillë.

39. Shumica e të anketuarve (57.1%) pohojnë se nuk janë përgatitur të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë për raste fatkeqësish natyrore, përkundrajt 30.5% të cilët janë përgatitur të kenë telefona të tillë. Ndërkohë që 8% e tyre janë në proces përgatitjes për këtë alternativë. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 6.1 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 5.9 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë telefona me bateri që mbajnë për një kohë të gjatë.

40. Shumica e të anketuarve (37.6%) pohojnë se nuk janë përgatitur të kenë një sasi të hollash në raste urgjencash apo raste fatkeqësish natyrore, përkundrajt 34.9% të cilët janë përgatitur të kenë një sasi të hollash në raste të tilla. Ndërkohë që 16% e tyre janë në proces përgatitjes për këtë alternativë. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ata që janë të papërgatitur përbëjnë shumicën dhe ka një rritje me 5.1 %. Gjithashtu, ka një ulje me 15.3% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një sasi të hollash.

41. Shumica e të anketuarve (77.9%) pohojnë se nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia, përkundrajt 9% të cilët janë përgatitur. Ndërkohë që 8.2% e tyre janë në proces përgatitjes për këtë alternativë. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 21 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 19% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë mënyra alternative për të hyrë/dalë në/nga shtëpia.

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

42. Shumica e të anketuarve (83%) pohojnë se nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët, përkundrajt 7.3% të cilët janë përgatitur për një alternativë të tillë. Ndërkohë që 5.6% e tyre janë në proces të përgatitjes për këtë alternativë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 22% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 16.4 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisje për fëmijët.

43. Shumica e të anketuarve (85.7%) pohojnë se nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta, përkundrajt 7.3% të cilët janë përgatitur për një alternativë të tillë. Ndërkohë që, 4.2% e tyre janë në proces përgatitjes për këtë alternativë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 16.8 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 8.7 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur të kenë pajisjet për të moshuarit, ose njerëzit me nevoja të veçanta.

44. Shumica e të anketuarve (83%) pohojnë se nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi, përkundrajt 5.1% të cilët janë përgatitur për një alternativë të tillë. Ndërkohë që, 6% e tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 21.8 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 16 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan evakuimi.

45. Shumica e të anketuarve (84.1%) pohojnë se nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të kenë një plan operacional të urgjencës, përkundrajt 4.9% të cilët janë përgatitur për një alternativë të tillë. Ndërkohë që 5.1% e tyre janë në proces përgatitje për këtë alternativë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 15.3% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 9.1% në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që, në rast urgjence ose fatkeqësie, të kenë një plan operacional të urgjencës.

46. Shumica e të anketuarve (75.9%) pohojnë se nuk janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës, përkundrajt 12% të cilët janë përgatitur për një alternativë të tillë. Ndërkohë që, 8% e tyre janë në proces përgatitjeje për këtë alternativë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 14.7 % në kategorinë e të anketuarve që nuk janë përgatitur për këtë alternativë si dhe një ulje me 8.3 % në kategorinë e të anketuarve që janë përgatitur që në rast urgjence ose fatkeqësie të jenë pajisur me siguracionin (mbulimin e siguracionit) të jetës.

Perceptimi lidhur me shkaqet, pasojat dhe masat për reduktimin e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile:

47. Shumica e të anketuarve (75%) janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile reduktohen në qoftë se të gjithë aktorët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre lidhur me informimin dhe marrjen e masave, përkundrajt 24.1% , të

cilët nuk janë aspak apo janë pak dakord. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, shifrat janë përafërsisht të njëjta, ndërkohë që ka një rritje me 5% të kategorisë që nuk janë aspak apo janë pak dakord me pohimin.

48. Shumica e të anketuarve, 77.1% (51.2 % + 25.9%) janë dakord dhe shumë dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën, përkundrajt 20.7% , të cilët nuk janë aspak apo janë pak dakord me këtë. Pra, shumica e të anketuarve kanë sensibilitetin për ndryshimet drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social që vijnë në mbarë botën nga fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile.

Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, janë thujse të barabarta shifrat për kategorinë e atyre që janë dakord dhe shumë dakord me pohimin që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile po shkaktojnë ndryshime drastike në realitetin ekonomik, politik dhe social në mbarë botën. Ndërkohë, ka një rritje me 7.6% në kategorinë e të anketuarve të cilët nuk janë aspak apo janë pak dakord me këtë pohim.

49. Shumica e të anketuarve, 66.2%, janë dakord dhe shumë dakord që urbanizimi i shpejtë është faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrajt 31.9%, të cilët mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 3.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se urbanizimi i shpejtë ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave si dhe një ulje prej 2.4% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak.

50. Shumica e të anketuarve, (77.1%), janë përgjigjur se ndikon dhe ndikon shumë mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore, përkundrajt 21.5%, të cilët mendojnë se nuk ndikon apo ndikon pak. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 7.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile mosndëshkimi i individëve që me veprimet/mosveprimet e tyre rëndojnë pasojat e fatkeqësive natyrore si dhe një ulje me 6.5% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon.

51. Shumica e të anketuarve, (63%) janë përgjigjur se mbipopullimi ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrajt 34.4%, të cilët mendojnë se mbipopullimi nuk ndikon ose ndikon pak si faktor në këtë fushë. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 6.5% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë mbipopullimi është faktor që ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 5.9% në kategorinë e atyre që mendojnë nuk ndikon ose ndikon pak.

52. Shumica e të anketuarve, (68.9%) janë përgjigjur se djegia lëndëve të rrezikshme si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile ndikon dhe ndikon shumë, përkundrajt 27.9%, të cilët mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak. Krahasuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 27.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se djegia lëndëve të rrezikshme është

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

faktor që ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 6% në kategorinë e atyre që mendojnë nuk ndikon ose ndikon pak.

53. Shumica e të anketuarve, 81.4% janë përgjigjur se zjarret e qëllimshme ndikojnë dhe ndikojnë shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrejt 17.3% të cilët mendojnë se nuk ndikojnë ose ndikojnë pak. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 7.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se zjarret e qëllimshme janë faktor që ndikojnë dhe ndikojnë shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 6.2% në kategorinë e atyre që mendojnë nuk ndikojnë ose ndikojnë pak.

54. Shumica e të anketuarve, 46.3% janë përgjigjur se bioterrorizmi ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrejt 42.1% të cilët mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak. Ndërkohë që 11.7% janë përgjigjur se nuk e dinë. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rënie me 12.3% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se bioterrorizmi është faktor që ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një rritje me 10.6% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak.

55. Shumica e të anketuarve, 46.6% mendojnë se mbeturinat bujqësore ndikojnë dhe ndikojnë shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrejt 44.9%, të cilët mendojnë nuk ndikojnë ose ndikojnë pak. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 7% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se mbeturinat bujqësore janë faktor që ndikojnë dhe ndikojnë shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një rritje me 5.2% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikojnë ose ndikojnë pak.

56. Shumica e të anketuarve, 80%, mendojnë se shpyllëzimi ndikon dhe ndikon shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrejt 18.2%, të cilët mendojnë se nuk ndikon ose ndikon pak. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ngritje me 4.6% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se shpyllëzimi ndikon dhe ndikon shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 3.6% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon apo ndikon pak.

57. Shumica e të anketuarve, 73.6% janë përgjigjur se ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit ndikojnë dhe ndikojnë shumë si faktor në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile, përkundrejt 21.8%, të cilët mendojnë se nuk ndikojnë ose ndikojnë pak. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, janë në të njëjtat shifra (73.6%) kategoritë e të anketuarve që mendojnë se ndërtimet pa kriteret e duhura teknike të ndërtimit ndikojnë dhe ndikojnë shumë në ndodhitë e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile si dhe një ulje me 1.17% në kategorinë e atyre që mendojnë se nuk ndikon apo ndikon pak.

Matja e nivelit të njohurive dhe të shqetësimit për menaxhimin e rrezikut të katastrofave natyrore:

58. Shumica e të anketuarve (60%) kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si tërmetet, ndërkohë që, 38.9% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e katastrofave të tilla si tërmetet. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 20% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si tërmetet si dhe një ulje me 21.1% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

59. Shumica e të anketuarve (70.9%), nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si përmbytjet, ndërkohë që 29.1% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (70.9%) nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e katastrofave të tilla si përmbytjet. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 17.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si përmbytjet si dhe një ulje me 17.9% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

60. Shumica e të anketuarve (83.1%), nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si thatësitat e tejkultura, ndërkohë që 16.9% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (83.1%) nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e katastrofave të tilla si thatësitat e tejkultura. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 19.9% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si thatësitat e tejkultura si dhe një ulje me 18.9% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

61. Shumica e të anketuarve (86.9%), nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të katastrofave të tilla si uraganet/stuhitë, ndërkohë që 13.1% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (86.9%) nuk kanë njohuritë e duhura për menaxhimin e pasojave të katastrofave të tilla si uraganet/stuhitë. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 11.7% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si uraganet/stuhitë si dhe një ulje me 18.6% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

62. Shumica e të anketuarve (67.4%), nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të zjarreve si katastrofave natyrore, ndërkohë që 30.6% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se shumica e të anketuarve (67.4%) nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të zjarreve si katastrofave natyrore. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 18.8% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si zjarret si dhe një ulje me 20.8% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

63. Shumica e të anketuarve (89.6%), nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të incidenteve radioaktive, ndërkohë që 10.4% e tyre kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se është relativisht i lartë numri i të anketuarve (89.6%) që nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të incidenteve radioaktive. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 15% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si zjarret si dhe një ulje me 15% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

64. Shumica e të anketuarve (60.7%) e tyre kanë mjaftueshëm apo shumë njohuri për menaxhimin e pasojave të pandemive/epidemive si katastrofë natyrore, ndërkohë që 39.2% e tyre, nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri në këtë fushë. Kjo tregon se është relativisht i lartë numri i të anketuarve (39.2%) që nuk kanë asnjë njohuri ose kanë pak njohuri për menaxhimin e pasojave të pandemive/epidemive . Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje të lehtë me 1.6% në kategorinë e të anketuarve që mendojnë se kanë pak ose aspak njohuri për menaxhimin e katastrofave të tilla si zjarret si dhe një rritje me 1.5% në kategorinë e atyre që kanë njohuri të mjaftueshme apo shumë njohuri në këtë fushë.

65. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 51.5%, nuk janë aspak apo janë pak dakord që fatkeqësitë natyrore/emergjencat civile, janë dukuri për të cilën janë hartuar akte ligjore të forta në Shqipëri^{1/2}. Ndërkohë, 31.5% janë dakord dhe shumë dakord me pohimin.

66. Shumica e të anketuarve (60.8%) janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e tërmeteve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre, ndërkohë që 39.2% e tyre, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar për këtë. Pra, është i lartë (60.8%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e tërmeteve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Krahastuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 16% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e tërmeteve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 16% të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

67. Shumica e të anketuarve (52.8%), nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individ për menaxhimin e përmbytjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që 47.3% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht i lartë (47.3%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar

për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 13.1% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 13.1% të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

68. Shumica e të anketuarve (65%) nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individ për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që 35% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (35%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e thatësirave të tej zgjatura si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 6.5% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e përmbytyjeve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 6.5% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

69. Shumica e të anketuarve (73.7%) nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e uraganeve/furtunave si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 26.3% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (26.3%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e uraganeve/furtunave e si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 2.1% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e uraganeve/furtunave si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 2.1% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

70. Shumica e të anketuarve (50.1%) janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 49.9% e tyre, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me këtë nivel njohurish. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 9.8% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e zjarreve si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 9.8% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

71. Shumica e të anketuarve (72.7%), nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar

AKADEMIA E SIGURISË

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre. Ndërkohë që, 27.3% e tyre janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për këtë nivel njohurish. Pra, është relativisht e lartë (27.3%) përqindja e personave të anketuar të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive dhe të pasojave të tyre. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një rritje me 2% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e incidenteve radioaktive si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një ulje me 2% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

72. Shumica e të anketuarve (74.7%) janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive dhe të pasojave të tyre, ndërkohë që 25.4% e të anketuarve, nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar për këtë. Krahësuar me anketimin e dy viteve më parë, ka një ulje me 22% në kategorinë e të anketuarve që nuk janë aspak apo janë pak të shqetësuar në raport me njohuritë menaxhuese që kanë si individë për menaxhimin e pandemive/epidemive si katastrofë natyrore dhe të pasojave të tyre si dhe një rritje me 22% në kategorinë e të anketuarve të cilët janë të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për nivelin e tyre të njohurive menaxhuese që kanë si individë në këtë fushë.

73. Për shumicën e të anketuarve, me një përfaqësim prej 40.9%, vendi ynë nuk ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar të menaxhimit të rrezikut të katastrofave natyrore për të përballuar rreziqet natyrore. Vetëm 18.6% mendojnë se vendi ynë ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të tillë.

74. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 43.3% nuk e dinë, nëse merr pjesë vendi ynë në ndonjë strategji të menaxhimit të katastrofave natyrore në nivel rajonal apo ndërkombëtar. Për 34.3% të anketuarve vendi ynë nuk merr pjesë në ndonjë strategji të tillë, ndërsa për 18.4% vendi ynë merr pjesë.

75. Vetëm 20.3% e të anketuarve mendojnë se ndërgjegjësimi/edukimi për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore është një komponent i strategjisë së menaxhimit të katastrofave natyrore.

76. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 38% nuk e dinë se sa përqind e burimeve publike janë ndarë çdo vit për zbatimin e kësaj strategjie, i kushtohet ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe përpjekjeve arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

77. Për shumicën e të anketuarve, me një përfaqësim prej 42.8%, shpërndahen çdo vit burimet publike që mbështesin ndërgjegjësimin për rreziqet natyrore dhe nismat arsimore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, ndërkohë që 31.5% e tyre nuk e dinë.

Vlerësimi i nevojave, priorizimi i burimeve, monitorimi dhe vlerësimi i përpjekjeve:

78. Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të konkludojmë se shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 65.4%, nuk kanë informacion dhe nuk e dinë nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore. Ndërsa 30% kanë informacion për kryerjen e një vlerësimi të tillë.

79. Shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 63.7 %, nuk kanë informacion dhe nuk e dinë nëse vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për pasojat e tyre financiare. Ndërkohë, 32.2% janë përgjigjur se kanë informacion që vendi ynë ka kryer një vlerësim të tillë të perceptimit të rrezikut.

80. Shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 75.5% janë përgjigjur se nuk kanë ndonjë shembull konkret, që vendi ynë ka kryer një vlerësim të perceptimit dhe ndërgjegjësimit të rrezikut nga fatkeqësitë në popullatë, për rreziqe të ndryshme natyrore, ndërkohë që 24.5% kanë shembuj konkretë për këtë.

81. Shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 46.7%, nuk mendojnë që është bërë një vlerësim ndaj nismave ekzistuese të edukimit për ndërgjegjësimin dhe reduktimin e rrezikut, përkundrejt 14.2%, të cilët mendojnë se është bërë një vlerësim i tillë.

82. Shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 52.7%, janë përgjigjur se nuk mendojnë, që janë prioritet programet ekzistuese arsimore të ndërgjegjësimit për rreziqet natyrore dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tone. Ndërkohë që, për 26.4% mendojnë se janë prioritet.

83. Shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 49.2%, mendojnë që nuk janë kryer vlerësime periodike të përpjekjeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vendin tone, ndërkohë që 19.4% mendojnë që janë kryer vlerësime periodike.

84. Shumica e të anketuarave, me një përfaqësim prej 43.5% mendojnë, që në vendin tonë nuk ka mënyra përmes të cilave, monitorohen efektet e përpjekjeve për ndërgjegjësim dhe edukim për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile. Ndërkohë që 25.7% mendojnë se ka mënyra të tilla monitorimi.

Matja e nivelit të informim mbi efektet ekonomike të fatkeqësive, mbulimi i sigurimit dhe mjete të tjera të menaxhimit financiar:

85. Vetëm 15.7% e të anketuarave mendojnë, që përpjekjet për edukimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vendin tonë, synojnë mjaftueshëm dhe shumë të informojnë dhe për pasojat ekonomike të rreziqeve natyrore dhe kostot që lidhen me ngjarjet e fatkeqësive.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

« Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile »

86. Shumica e të anketuarve, me një përfaqësim prej 64.4%, nuk kanë asnjë informacion ose kanë pak informacion se cilat kosto mbulohen nga shteti nëpërmjet sistemit të sigurimeve shoqërore ose fondeve ose rezervave të dedikuara dhe çfarë humbjesh në vend të kësaj do të përballohen drejtpërdrejt nga individët, familjet dhe bizneset, në rastet e fatkeqësive natyrore/emergjencave civile. Ndërkohë që vetëm 10.4% e tyre kanë mjaftueshëm dhe shumë informacion për këtë çështje.

